

Dialogu ynë, si një moto perpetuo, e cila u bë një bazë zhvillimi e përpunimi i temave nga më të ndryshmet mbi artin e dirigjimit si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe në aspektin interpretativ. Bisedat merrnin formë dhe zhvilloheshin si intervista të vërteta. (Fragment nga libri "At' e bir", të dirigjentit të shquar Ermir Krantja, botuar këto ditë nga Onufri)

## Ermir Krantja DIALOG PËR DIRIGJIMIN ME BABAIN TIM, Mustafa Krantja



Sot edhe nesër ju ftojmë në Panairin e Librit "Tirana 2024" në Pallatin e Kongreseve

### SHËNIME MBI LIBRAT

Botohet në kinezisht romani i Ylljet Aliçkës Vështrimi dhe kundërvështrimi në romanin "Rrëfenjë me ndërkombëtarë" të Ylljet Aliçkës - një studim mbi identitetin shqiptar  
Nga MA Sai (Bora), Ph.D. (fq. 10)

Agim Vinca, Antologji e lirikës shqipe të dashurisë  
ANTOLOGJI E LIRIKËS SHQIPE TË DASHURISË  
Nga Myrvete & Begzad Baliu (fq. 6)

Mbi vëllimin poetik "Solo" të Alfred Lelës  
NJË LIBËR QË NGJALL KËRSHËRI TE LEXUESI  
Nga Luljeta Lleshanaku (fq. 15)

Qyteti si personazh qendror në romanin "Përmbytja" të Granit Zelës  
Nga Agron Tufa (fq. 21)

1001 aforizma et cetera nga Besnik Mustafaj  
LIBRI I BLETËS  
Nga Dr. Teuta Nunaj-Kortoçi (fq. 17)

Ajne Ibërhyasaj, Gravurë me ngjyrat e kohës  
SHPIRTI LIRIK I NJË POETESHE  
Nga Agim Vinca (fq. 13)




Piktor: Zaim Elezi

### FITUESJA E BOOKER PRIZE 2024

## SAMANTHA HARVERY:

Doja të shkruaja për pushtimin njerëzor të orbitës së tokës  
Përktheu: Granit Zela (fq. 23)

Për herë të parë përkthyer në shqip  
AFËRDITA DHE ADONISI  
nga Shekspiri  
Shqipëroi: Alqi Kristo



Me një hyrje nga Prof. Dr. Diana Alqi Kristo (fq. 8)

Mbi "Në kohën e të marrëve" të akademik Shaban Sinanit  
Pamjaftueshmëria e kohës për aq shumë marrëzi  
Nga Andreas Dushi

Në një tekst letrar, koha e rrëfyer dhe koha e rrëfimit krijon një dualitet për hir të të cilit mund të trazohet, qoftë edhe fare pak, raporti solid mes shenjës dhe të shenjuarit. Prandaj, koha merr një rëndësi të veçantë si procedim teknik pasi edhe falë saj, arrihet tejçimi i synimit estetik që autori ka.

(fq. 4)

### BIBLIOTEKË

- Primo Shllaku (fq. 14)  
*Se si vizita në një ishull...*
- Odise Kote (fq. 16)  
*Kjo verë e thatë, e padurueshme*
- Ndue Ukaj (fq. 19)  
*Kush je ti?*
- Aleksandër Bardhi (fq. 18)  
*Xixëllonjat flenë mbi gurët e gjakut*
- Marsela Neni (fq. 20)  
*Alkimia e natës*
- Feride Papeka (fq. 22)  
*SMS Ana Kareninës*

"Dhora Leka, kompozitorja e parë"  
Libri i ri i akademikut Vasil S. Tole (fq. 13)

### PËR PROFESOR RIDVAN DIBRËN

Nga Klevisa Bardeli (fq. 12)

### NË ROLIN E KRONIKANES

Nga Ina Kosturi (fq. 11)

## MISTERI I MAGJISHËM I TINGULLIT DHE PUSHTETI I TIJ

**E. K.** Ka qenë gjithmonë një preokupacion i vazhdueshëm nga ana ime përqendrimi për të kultivuar e për të përpunuar tingullin e orkestrës, ashtu siç e mendoja dhe e ndieja në aspektin ideal. Pra, kam synuar gjatë që të krijoj ngushtimin e distancës ndërmjet tingullit real të orkestrës dhe imagjinacionit të atij tingëllimi të brendshëm, të cilin shpirti dhe mendja ime e kërkonin në realitet.

**M. K.** Mendoj që është një domosdoshmëri për dirigjentin krijimi i një konfidence teorike dhe praktike me timbrikën e instrumenteve të veçanta dhe në të njëjtën kohë, mirëkuptimi dhe përpunimi nga ana e tij i tingullit të cilin ansambli orkestral e ofron si një mundësi shprehëse me disponibilitet të plotë për të mbështetur krijimin artistik.

Në këtë rast, është e natyrshme që një nga detyrat e dirigjentit është të kërkojë nga orkestra cilësinë e tingullit. Duke qenë i vëmendshëm në konfront me vetë tingullin e orkestrës, ai ndikon që të gjithë të kuptojnë rëndësinë dhe vlerën e një tingulli të pastër e komunikativ. Gjithçka realizohet me një përqendrim të rreptë kritik, që do të thotë se detyra e dirigjentit është komplekse dhe përbëhet nga shumë elemente që krijojnë mrekullinë e një riprodhimi krijues, i cili lind e transformohet nga një individualitet i papërsëritshëm shpirtëror e intelektual. Përveç përgatitjes dhe thellimit në kompleksitetin e shumtë të elementeve që e pasurojnë atë, e shikoj si një parim themelor për dirigjentin të jetë i ndërgjegjshëm dhe i pajisur me një ndjeshmëri të lartë e koncept të qartë të ekzekutimit ideal.

**E. K.** Për një periudhë të konsiderueshme të punës sime si dirigjent kam përdorur një sistem pune që u bë një pikësynim parimor e permanent, pra, të kërkoja nga orkestra tingullin tim personal. Kam menduar gjatë dhe jam përpjekur të krijoj gjatë provave tingullin të cilin e kam quajtur timin. Ka qenë pothuajse një ide fikse, sipas së cilës, pa arritur të nxjerr nga orkestra tingullin e personalizuar, unë nuk do të mundja të dirigjoja siç duhet. Sidoqoftë, nga mënyra e interpretimit që i bëre problemit, më jep përshtypjen se nuk je plotësisht i bindur ta pranosh këtë arsyetim.

**M. K.** Në këtë kontekst, nuk duhet harruar se çdo orkestër, pavarësisht nga niveli që demonstroi, ka një tingull të vetin që portretizon aspekte të ndryshme të momenteve muzikore. Nga eksperiencia, edhe po të hyjnë elemente të reja në orkestër, ajo ruan në përgjithësi timbrikën e saj, sepse të rinjtë ballafaqohen me prezencën timbrike tashmë të konsoliduar në kohë, si stil dhe mënyrë e të bërit muzikë. Dirigjenti duhet të jetë i mbështetur nga ky tingull i orkestrës. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë është shumë e vështirë, pothuajse e pamundur të udhëheqë. Ky është një tjetër argument interesant dhe tejet i trajtuar në diskutimet krijuese apo intervista të ndryshme mbi rolin dhe pushtetin e dirigjentit. Është e pamundur të mendohet që ky i fundit të mund të shkojë përpara pa pasur në kokë një mendim të qartë e të maturuar siç duhet mbi ekzekutimin ideal.

# Ermir Krantja

## DIALOG PËR DIRIGJIMIN ME BABAIN E TIJ, Mustafa Krantja

**E. K.** E shoh që ende nuk je plotësisht i bindur të mbështetësh idenë se dirigjenti mund të pretendojë të krijojë tingullin e tij të personalizuar. Lidhur me këtë argument, kujtoj vjeshtën e vitit të largët 1979 kur menjëherë, pas transferimit nga Shkodra në Tiranë, iu vura punës për vënie në skenë të premierës absolute të operës *Vjosa* të kompozitorit Tish Daija.

Mbas premierës, mendimi kritik për realizimin e veprës ishte me të vërtetë i ngrohtë dhe mjaft pozitiv për të evidentuar disa elemente të rëndësishme që ndikuan direkt në mbarëvajtjen dhe suksesin e spektaklit. Një nga motivet e këtij entuziazmi ishte edhe tingëllimi i veçantë dhe i ndryshëm i lojës së orkestrës, jo i dëgjuar më parë. U arrit deri në atë pikë sa ndonjë kritik arti të bënte

pyetjen: "Pse kemi thënë deri më sot se orkestra e operës bën një lojë paksa të vakët dhe me një mungesë shkëlqimi të tingullit? Kjo gjë sot nuk na rezulton e saktë."

E parë në këtë këndvështrim, duhet të sqarohet se gjatë provave unë ndiej nevojën të dëgjoj brenda meje atë tingull imagjinar që do të dëshiroja ta quaja "tingulli im". Kuptohet që, për ta realizuar këtë, duhet përdorur i gjithë arsenalin që kam në dispozicion për realizimin e qëllimit, gjithmonë duke shfrytëzuar çfarëdo burimi të mundshëm.

**M. K.** Në këtë moment, mendoj se duhet sqaruar një pikë delikate. Gjatë procedimit të provave, nuk do të thotë që ti i propozon orkestrës tingullin

tënd personal. Përkundrazi, ti kërkon të inserosh në pasurinë e saj timbrike ekzekutimin tënd ideal. Këtë gjë nuk mund ta bësh duke i ofruar orkestrës tingullin tënd. Përkundrazi, duhet të tentosh në përpunimin dhe pasurimin e tingullit të saj për ta shfrytëzuar atë në shërbim të qëllimit tënd. Në këtë rast, hyjmë në labirintin e mrekullueshëm të interpretimit dhe sekreteve të magjisë që dirigjenti vetë krijon. Kjo fazë e punës së tij krijuese është ajo më interesantja, sepse në të ai ekzalton pikërisht shpirtin e tij duke e ngritur atë në lartësira të pakufishme. Këtë rezultat e arrin edhe duke tentuar të përpunojë tingullin real të orkestrës në mbështetje të atij ideali tingëllues që ai ka në mendje, duke e vendosur atë në shërbim të mendimit muzikor.

**E. K.** Duke u thelluar në këtë argument, siç e theksove edhe ti pak më parë, duhet evidentuar se tingulli përmban edhe forcën shprehëse të pushtetit që vetë muzika e ka dhe imponon. Ai është në gjendje të ekzaltojë situata, kontraste të fuqishme, kalime të rrefeshme dhe domethënësia të një imagjinacioni të pasur që zhvillohet nëpërmjet marrëdhënies që ekziston mes hijes dhe dritës, pikënisjes dhe zhvillimit, heshtjes dhe pranisë reale të tij.

**M. K.** Nëse do të flisnim për vlerat e veçanta të tingullit, nuk do të mundnim të përjashtojmë forcën e tij shprehëse, vendosmërinë me të cilën transmeton karaktere të ndryshme të ekspresionit muzikor dhe çka është më e rëndësishme, forca e ekzistencës së tij e veshur me një pushtet të padiskutueshëm monumental, me të cilin transmeton idera e sentimente thellësisht të komplikuar e të rëndësishme, për aq kohë sa ai është i pranishëm si i tillë.

**E. K.** Më duket që jemi në një moment të veçantë të bisedës, sepse më tërhoqi menjëherë fraza e fundit që the: "...forca e tingullit, për aq kohë sa ai është i pranishëm si i tillë".

**M. K.** Përveç ndërtimit të një bashkësie tingujsh me qëllim që të shprehet një frazë muzikore, është e rëndësishme të kuptohet se tingulli në vetvete zgjon në ndërgjegje pafundësi frazash muzikore dhe kombinime pa fund të ekspresionit muzikor. Këtu gjejmë forcën e pushtetit të tij.

**E. K.** Po kthehem pak mbrapa në kohë, kur gjatë vitit të tretë të studimeve punonim me simfoninë e katërt të Brahms-it. Kujtoj një orë mësimi në të cilën demonstrove (si gjithmonë me elegancën tënde të njohur) të ishe i pakënaqur me mënyrën se si unë ndërhyja për të dhënë atakun e fillimit të veprës. Ty nuk të kënaqte mënyra vërtet korrekte e pikënisjes, teknikisht e parë, por jo e justifikuar muzikalisht.

Provuam jo pak të qartësonim situatën deri në momentin kur ti bëre një ndërhyrje e cila më ndihmoi për t'i hedhur sytë në një hapësirë të re e ende të paeksploruar nga unë.

U përpoqe të më ngacmosh fantazinë duke më thënë: përpiku të ndiesh dhe të kuptosh se muzika nuk fillon pikërisht në notën e parë të veprës (nota Si në levare, e cila në mënyrë delikate dhe si me ndrojtje zbret me kujdes në notën Sol, duke krijuar intervalin e tercës dhe duke kërkuar në të njëjtën kohë të ngjitet në intervalin e sekstës, duke krijuar një



## ERMIR KRANTJA

# At' e bir

(TË DIRIGJOSH)



valëzim i cili insiston të bëhet paksa më i ashpër e ngulmues). Në këtë mënyrë, fraza muzikore zhvillohet me përsëritjen në ngjitje e zbritje të intervaleve të ndryshme. Jam pak i dyzuar për të kuptuar siç duhet idenë tënde.

**M. K.** Nuk është kaq e komplikuar. Struktura e temës është e tillë që të jep përshtypjen se emocioni që ndihet menjëherë në fillimin e muzikës nuk është një pikënisje, por vazhdim i një mendimi muzikor tashmë në lëvizje. Pra, nga një zhvillim ndjesor që dhuron emocionin e tij, më parë se tingulli vetë, të jetë i pranishëm fizikisht.

**E. K.** Për t'u thelluar në këtë arsyetim, nuk do të mjaftonte vetëm një ndërgjegjësim në aspektin teorik të problemit. Do të bëhej gjithçka më e perceptueshme nëse ia del të ndërtohet një raport të qartë që të ketë në bazë, pikësynimin e balancës ndërmjet perceptimit dhe sensibilizimit.

**M. K.** Në qoftë se do të dëshiroje që ky arsyetim të duket më i afërt dhe më tërheqës, përpiku t'i bësh pyetjen vetes: "Nga vjen tingulli? Fillon pikërisht në momentin në të cilin e ndiejmë dhe e dëgjojmë apo vjen nga një hapësirë tjetër? Pse thamë pak më parë se tingulli ka një forcë të mbinatyrshe për të dhuruar tablo të dimensioneve të mëdha e të veshura me emocione të fuqishme? Çfarë është heshtja? A mund të jetë ajo, në njëfarë mënyre, mëma e tingullit? Kur ky i fundit mbaron, çfarë roli merr përsipër heshtja? Në këtë kontekst, a nuk do të ishte interesante të shikojmë me tjetër sy raportin ndërmjet tingullit dhe pauzës?"

**E. K.** E gjithë kjo mori pyetjesh në thelb të ndriçon mendimin qendror, pikërisht, atë të marrëdhënies tingull-pauzë. Duke iu referuar kësaj teme, kujtoj fare mirë leksionet e dirigjimit në të cilat demonstrroje këmbënguljen tënde për të më sensibilizuar me këtë ide krejt të veçantë, kur më përsëritje shpesh dhe pa u lodhur kurrë se pauza është muzikë.

**M. K.** Ky arsyetim të shtyn në thellimin e mëtejshëm në galerinë e të fshehtave profesionale. Pra, në momentin kur pauza është e pranishme, ndihet jehona e tingullit si një nënvizim emocional në vazhdim.

**E. K.** Në këtë rast ajo përgatit jo vetëm atakun për të rimarrë rrugë-timin, por influencon tërësisht në ndërhyrjen e dirigjentit në transmetimin e karakterit të atakut, gjë që përcakton vazhdimësinë emocionale të muzikës dhe në të njëjtën kohë, domethënien e vetë tingullit.

**M. K.** Kjo për disa arsye: duhet kuptuar që në muzikë krijohet një dialog i vazhdueshëm ndërmjet tingujve dhe heshtjeve. Ky dialog i jep shtytje zhvillimit muzikor deri në heshtjen e fundit.

**E. K.** Ndoshta ke parasysh tingullin e fundit të veprës?

**M. K.** Jo tamam kështu. E theksoj edhe një herë se, në raportin ndërmjet heshtjes dhe tingullit, ndodh një fenomen i vazhdimësisë së asaj që paraprin lindjen (heshtja si bazë pikënisjeje). Nga ana tjetër, në mbarim të tingullit gjejmë heshtjen si bazë mikpritjeje të tingullit i cili në momentin e dhënë mund të ketë ofruar një tension dramatik ose, pse jo, një element lirik apo narrativ.

Mustafa Krantja me orkestrën e operës (1957).



Në momentin e mbarimit të veprës, tingulli i fundit, pavarësisht nga mungesa e tij fizike, vazhdon ende të jetojë në heshtjen e fundit pa e humbur ekspresionin dhe domethënien finale të tij. Kjo është arsyeja që në ndonjë rast kur publiku ndërhyr me duartrokite menjëherë mbas mbarimit të tingullit final, krijohet një ndërprerje artificiale dhe jo e këndshme e mundësisë së të shijuarit deri në fund të jehonës, ekspresioni tingëllues i së cilës është konservuar në heshtjen finale.

**E. K.** Pra, pauza mund të konsiderohet edhe si një hapësirë në të cilën tingulli vazhdon të ndihet nga ai që e dëgjon muzikën. Në këtë rast mund të themi se gjatë pauzës, tingulli, edhe pse nuk dëgjohej fizikisht, mbijeton në shpirtin e dëgjuesit, i cili e shijon edhe për një moment të fundit mbas mbarimit të veprës.

**M. K.** Duke folur për një element të tretë, pra, për dëgjuesin i cili ndjek muzikën, i jemi afruar një tjetër

marrëdhënieje. Asaj të tingullit me subjektin që e dëgjon muzikën.

Kjo ka të bëjë me fenomenologjinë muzikore, argument ky i trajtuar me kompetencë dhe interes të veçantë nga dirigjenti Sergiu Celibidache: "...si një shkencë që kërkon të rregullojë në mënyrë objektive ligjet që sistemojnë materialet sonore." Më tej ai shton se "...muzika është një lëvizje, por kush lëviz, tingulli? Jo! Lëviz koshienca e atij që dëgjon dhe e atij që lëviz tingullin, sepse muzika është evoluimi i tingullit në funksion të atij që e dëgjon atë".<sup>1</sup>

**E. K.** Shumë dirigjentë të njohur, doemos edhe muzikologë, e trajtojnë këtë temë në mënyra të ndryshme. Edhe pse në pamjen e parë duken arsyetime të distancuara nga njëri-tjetri, takohen në një pikë të pakundërshtueshme: Lëvizja e tingullit ose tingulli që lëviz.

**M. K.** Pra, nga njëra anë, kemi arsyetimin tejet shkencor dhe filozofik të Celibidache-s dhe nga ana tjetër, argumentin paksa më të prekshëm që "...tingujt janë të lidhur mes tyre nga raporte lineare (melodia) ose vertikale (harmonia). Tingulli ekziston te ne përpara se ai të arrijë materializimin e tij të ndjeshëm. Ai mund të ekzistojë edhe pa arritur në muzikë".<sup>2</sup>

**E. K.** Dirigjenti punon dhe realizon gjithçka me instrumentin e tij kompleks (orkestrën), si një bashkësi e gjallë dhe aktive në ndërtimin e një raporti krijues. Ky i fundit është i lidhur me një seri elementesh muzikore, ndër të cilat tingulli në veçanti ushtron pushtetin e tij të magjishëm.

**M. K.** Për këtë arsye, themi që dirigjenti punon me tingullin e orkestrës duke e afruar atë me idenë dhe ndjeshmërinë e tij të brendshme. Kjo edhe për një motiv tjetër: "...nuk duhet harruar se dirigjenti është i vetmi muzikant që krijon një tingull pa asnjë kontakt fizik".<sup>3</sup>



<sup>1</sup> Sergiu Celibidache, *Leksione të hapura me studentë të kompozicionit dhe muzikologjisë, të zhvilluara në RTSI, Zvicër*, 1974.

<sup>2</sup> Vittorio Gui, *L'arte di dirigere l'orchestra*, Milano, 1940, f. 199; cituar edhe nga Michelangelo Zurletti në "Grandi direttori di ieri e di oggi", Giunti Martello, 1985, f. 27.

<sup>3</sup> Carlo Maria Giulini në bisedë me Adriano Bassi, 1993.

### Koha e lexuesit

Në një tekst letrar, koha e rrëfyer dhe koha e rrëfimit krijon një dualitet për hir të të cilit mund të trazohet, qoftë edhe fare pak, raporti solid mes shenjës dhe të shenjuarit. Prandaj, *koha* merr një rëndësi të veçantë si procedim teknik pasi *edhe* falë saj, arrihet tejçimi i synimit estetik që autori ka. Novela “Në kohën e të marrëve”, sikurse sugjeron titulli paraprak i saj “Ditët e sotme të vëzhguara pas tri dekadash” botuar në fillimin e tranzicionit, e vendos narratorin në një të ardhme të supozuar prej ku rrëfen të tashmen. Kjo kohë letrare e narratorit, e krijuar nga autori rastis të përkojë me kohën reale të jetuar nga lexuesi, në këtë rast nga unë. Kështu, pika letrare e vështrimit e ofruar në vepër njësohet me pikën time reale të vështrimit për ngjarjet e asaj kohe të pajtuar prej meje. Pra, koha ime e përnjëmendte është e njëjtë me atë kohë të trilluar ose e thënë ndryshe, koha ime reale është koha artistike e Sinanit. Ky fakt më shtyu ta lexoja librin, bashkë me kureshtjen e pashmangshme se si një akademik, studiues i letërsisë, këtu e tridhjetë vjet më parë, ka krijuar vetë letërsi.

Për brezin tim, atë që në anglisht quhet Gen Z, periudha e kalimit nga njëri sistem në tjetrin ka ardhur bashkë me togfjalëshin *tranzicion i tejzgjatur*, duke na lënë të kuptojmë se jemi akoma në atë fazë kapërcyelli, mbetur në majë çka do të thotë në rrezik për të rënë sërish në anën e gabuar. Ka shumë arsye pse ka ndodhur kjo, por besoj se kryesorja është mungesa kolektive e aftësisë për të krijuar një ftohje të domosdoshme me ato vite që të mund t’u qasemi mandej me skrupulozitetin e nevojshëm historik. Kjo ka bërë që për ne, e vetmja mundësi njohjeje me to të mbetet memuaristika dhe letërsia. Trillimi në memuaristikë është pabesi e ligë, ndërsa memuaristika në trillim është befasi e mirëpritur. *Koha* e të marrëve në veprën e përmendur është një e tashme që vështrohet si kujtim dhe trajtohet si memuaristikë. Kjo e bën tekstin “një mjet” më të këndshëm për ta kuptuar më mirë atë të djeshme, të jetuar si e sotshme prej autorit dhe të treguar objektivisht prej narratorit nga pikëpamja letrare e një të nesërmeje. Në këtë të nesërme, parashikohet mungesa e një interesi të jashtëzakonshëm për çështjen e trajtuar, prandaj mungojnë detaje të tepërta e të panevojshme dhe marrëdhënia e kohës së rrëfimit dhe kohës së rrëfyer është e përsheptuar<sup>1</sup>. Këtu fillon edhe proftezi i shkrimtarit për të ardhmen, temë që do të trajtojmë në vijim.

Krejt ndryshe nga proza e deriatëhershme, boshti kryesor i novelës së botuar pjesë – pjesë në periodikë të ndryshëm, fillimisht *Hosteni* e mandej *Albanopol*, nuk

<sup>1</sup> Për marrëdhëniet mes kohës së rrëfimit dhe kohës së rrëfyer, shih. M. Bal, “Narratology-Introduction to the theory of narrative”, University of Toronto Press, Toronto 1977.

Mbi “Në kohën e të marrëve” të akademik Shaban Sinanit

## PAMJAFTUESHMËRIA E KOHËS PËR AQ SHUMË MARRËZI

Nga Andreas Dushi



zhvillohet përreth një personazhi të caktuar. Vendin ia kanë zënë dy përbërës të tjerë të strukturës së një vepre letrare, *koha* dhe *hapësira*; mbi to naltohen themelet e ngrehinës së tekstit. Brenda saj, autori krijon një kapsulë kohe ku marrëzia pret e paprekur lexuesin – vizitor të ardhshëm.

Ky shkrim mund të shihet edhe si një reportazh i qendrimit tim në brendinë e kësaj kapsule.

### Novelë humoristike?

Pasi lexova në parathënie se ky libër ishte vlerësuar me çmimin e dytë si novelë humoristike, prisja që të gjeja *humorin* në konceptin letrar të termit<sup>2</sup>. Teksa e kërkoja, vura re se

<sup>2</sup> Në Leka, F., “Fjalor i termave të letërsisë”, “Infobotues”, Tiranë 2013, fq. 176-177: Humor-i. *Një nga format e komikës që pasqyron anët qesharake të sendeve, të dukurive, të njerëzve ose të një shoqërie. Ndryshe nga satira, me anën e së cilës autori sulmon dukuritë negative në jetën e individit dhe të shoqërisë, në veprat*

vendin ia zinte një “*distancimin pa emocion*” nga ana e shkrimtarit, një *ftohtësi në shprehje në një kohë kur emocionet e shkrimtarit duket se janë vërtetë të ndezura*<sup>3</sup>. Fakti që në këtë shpjegim të dhënë për zërin ironi gjeta të përshkruar një tipar të rëndësishëm të librit, më bëri të kuptoj se në fakt, kemi të bëjmë me më shumë sesa thjesht humor. Autori kap thelbin e absurdit të shoqërisë shqiptare të asaj kohe dhe duke mbajtur parasysht thënien e Adornos se *arti është “esenca dhe imazhi” i realitetit më shumë se sa riprodhimi i tij*<sup>4</sup>, pa harruar atë çfarë thonë Warren dhe Wallek se *letërsia*

*humoristike përqeshen disa nga të metat e veçanta të një njeriu ose të një shoqërie, por pa shprehur mllëfa zemërim. Ndonjëherë autori vë në tallje pa të keq edhe ndonjë veçori të karakterit të njerëzve, por toni i humorit në këtë rast është i lehtë.*

<sup>3</sup> Thrall, W.F. & Hibbard, A., “Handbook to Literature”, “Bobbs-Merrill Educational Publishing”, Indianapolis 1980, fq. 236

<sup>4</sup> Citim i marrë nga Jeferson, A., & Robery, D., “Teoria letrare moderne”, përkth. Dado, F., “Albas”, Tiranë 2016, fq. 271.

“*pasqyron*” jetën, kurse “*jeta*”, në kuptimin e gjerë të fjalës, është realiteti shoqëror<sup>5</sup>, ai, autori pra, tregon se e ka zotësinë për ta kapur ironinë duke kaluar kështu një prej testeve më të besueshme të inteligjencës dhe të sofistikimit<sup>6</sup> çka sjell për rrjedhojë një tekst dinamik që patjetër, ta nxit buzëqeshjen, por pa rënë në grackën e të qenurit parodi.

Është serioze çdo gjë që është gjithpërfshirëse, ajo çka inskenon një numër të madh të dhënash dhe vlerash hierarkike në një kuadër përgjithësisht të njohur [dhe] është ironike, në të kundërt, gjithçka që është e izoluar, fragmentare dhe që është e pozicionuar në një prespektive të pazakontë.<sup>7</sup> Në kontekstin kur u shkrua vepra, **absurdi** ishte gjithpërfshirës etj., pra **serioz**. Por pavarësisht kësaj, prej absurdit buron e kundërta në vepër, **ironia** e cila, në teksturën e saj ka edhe komiken. Kjo vjen ngase autori e ka kuptuar, sikurse sqaron vetë në parathënie, se *në fund të fundit, kur të jemi të kthjellët, do të qeshim gjithësesë*<sup>8</sup>. Ai është i vetëdijshëm se po jetojmë *realitet paralel të përkohshëm*<sup>9</sup>, pra komik. Prandaj situata nxitëse për debate të gjata në gazetata e kohës apo beteja të ashpra e të papërfunduara, në fund të fundit janë krejt të parëndësishme për fatin e kombit. Kjo vetëdije e një grupi të vogël sjell këtë vepër dhe kjo vepër formëson këtë vetëdije te një grup më e i madh.

Herë pas here ndodh që autorët frymëzohen nga subjekte veprash të mëdha dhe i rikrijojnë në kontekste krejt të reja, fjala bie Murakami me “1q84” apo Coetze me “Foe”. “Në kohën e të marrëve” ndërkohë nuk është një rimarrje tematike sikundër zakonisht ndodh, por ashtu si thotë autori vetë, *vepra u nis [...] si një variacion stilistikor i “Viti i mbrapshtë” të Kadaresë*. Është një kaos i përgjithshëm që, me thujajse njëshekull ndërmjet, rijetohet. Struktura narrative për rrëfimin e të parit është e njëjtë me vetë kaosin<sup>10</sup>, ndërsa në të dytin merr formën e

<sup>5</sup> Wellek, R., & Warren, A., “Teoria e letërsisë”, përkth. Myftiu, A., “Onufri”, Tiranë 2015, fq.94


<sup>6</sup> Thrall, W.F. & Hibbard, vep. cit., fq. 236

<sup>7</sup> Schoentjes, P., “Poetika e ironisë”, përkth. Fasho, V., “2 lindje, 2 perëndim”, Elbasan, 2017, fq. 190.

<sup>8</sup> Në Sinani Sh., vep. cit., fq. 6-7: *Në thelb, synimi ishte të qeshim tani, pa pritur të kalojë gjithë kjo kohë, sepse në fund të fundit, kur të jemi më të kthjellët, do të qeshim doemos.*

<sup>9</sup> Krh. Attardo, S., “The Linguistics of Humor”, “Oxford Linguistics”, Oxford 2020, fq. 316.

<sup>10</sup> Shih. Qose, B., “Heterogjeniteti i rrëfimit dhe interpretimet e romanit ‘Viti i mbrapshtë’”, ExLibris nr. 269, fq. 4-6.



qetë të dhënë nga një vështrues i cili falë njohjes së të parit, ka sigurinë e përkohshmërisë së të dytit.

### Narratori si vëzhgues

Kur tranzicioni shqiptar ishte akoma një dëshirë dhe realizimi i tij nuk kishte filluar, demokracia ofrohej si një situatë e gjerë ku zinin vend të gjitha ideologjitë, pikëpamjet dhe mendimet. Pa qenë tamam i vetëdijshëm, populli priste të bëhej pjesë e asaj *shoqërie perëndimore të fundit të shekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI* [që] karakterizohet me bashkëjetesën pak a shumë paqësore e ideologjive të ndryshme dhe gjithashtu pra e pikëvështrimeve konkurrenente të artit.<sup>11</sup> Kjo do të sillte indiferentizmin e masës e për rrjedhojë, turmat do ta ruanin qetësinë, të painteresuara për ndonjë shkak pse duhet të krijonin zënka. Kjo jo vetëm nuk ndodh, por si çdo gjë tjetër, ndarjen historike që tani shpresonte kushdo të sheshohej, shqiptarët e çojnë në eskremitete. Kthjelltësia për ta kuptuar situatën është tipari më në mungesë, kurse gjaknxehtësia për t'u bërë pjesë e saj është karakteristika më dominuese. Aftësia për të fituar njëfarë largësie të shëndetshme prej ku vështron gjithë rrëmujën dhe dëgjon gjithë zhurmajnën bën të mundur ta kuptosh tërë ndodhinë. Pikërisht në këtë "katedër" rri narratori në "Në kohën e të marrëve", andaj vepra letrare kap horizonte krejt të paarrtshme për kohën, çka për t'u bërë të besueshme, duhen treguar vetëm nga një distancë prej tridhjetë vjetësh.

Rrëmuja e një kohe të marrë nuk të lejon ta kuptosh *marrinë*; si fugë, ajo të përfshin dhe gjithçka përreth teje, sado e panatyrshme të jetë, duket krejt normale. Prandaj, për t'i veçuar gjërat, autori detyrohet të krijojë një kohë të re, të ardhme e të qetë jashtë atij absurdi, pikërisht për ta kuptuar atë.

Prej aty, ai e vështron i qetë andaj e rrëfen pa emocion besimin e popullit se mjaft të arrinte buzë ujit në portin e Durrësit dhe vaborrët do t'i prisnin për t'i marrë me vete drejt tokës së premtuar; se partitë me karakter fetar shpresonin në njohje prej kryeqendrave religjioze; se si mashtroheshin njerëzit fare kollaj nga iluzione shpresash të pamundshme (dhe të imagjinosh, atëherë akoma nuk kishin lulëzuar *Piramidat*); se si lexohej kanuni së prapthi; se si rilindën këngët e harruara të gurbetit e sa e sa të tjera.

Nëpërmjet zgjedhjes për ta formësuar veprën si variacion stilistik të "Vitet të mbrapshtë", autori tregon se historia a një element i saj, në rastin tonë mbrapshtia, po nuk qemë të kujdesshëm, e përsërit vetveten. Narratori kështu, pa dashje, i vendosur në një të ardhme, sa herë flet në kohën e tashme mban të veshur rrobën e një profetit që sigurisht nuk pranohet në vendin e vet për një dhe vetëm një arsye: njerëzit kanë frikë se ai ka të drejtë dhe profecitë do t'i realizohen.

<sup>11</sup> Todorov, T., "Letërsia në rrezik", përkth. Halimi, M., "Buzuku", Prishtinë 2007, fq. 60.



Piktor: Zaim Elezi

### Më në fund, një lexim i tekstit

E kam shumë përzemër pasi e çmoj si tejet të drejtë dhe jo vetëm franceze "ankesën" e Todorovit për sistemin arsimor francez kur thotë se *çështjet që nxënësit duhet të trajtojnë në provime, si gjatë vitit, ashtu edhe në maturë, janë, në shumicën e rasteve, të një tipi. Ato kanë të bëjnë me funksionin e një elementi të librit në raport me strukturën e tij të tërësishme, e jo mbi kuptimin e këtij elementi e as të librit në raport me kohën e tij ose tonën*.<sup>12</sup> Parashtrimi i mëspierm teorik synon të qartësojë këtë të dytën, lidhjen mes veprës dhe kohës, jo si raport vetëm brenda letërsisë por si domosdoshmëri që të kuptohet brenda vetë shoqërisë.

Tani, meqë ky shkrim nuk ka kurrëfarë pretendimi për të qenë shkencor, kjo pjesë e mbrame e tij mund të ketë edhe titullin ***Disa përsiatje nga një lexues i Gen Z mbi tekstin e novelës "Në kohën e të marrëve"***.

\*

Në faqet e para të novelës, parulla e fillimit të '90-ës *E duam Shqipërinë në Europë* nga sot, tre dekada më pas, vështrohet si *arkaike*. Por ja që edhe tash së voni, në protesta e tubime, kjo thirrje del nga turma, çan ajrin, dëgjohej ngado dhe kthehet sërish në turmë, deri sa të vijë tubimi i radhës për t'u përsëritur e gjitha sërish. Në këtë rikthim qesharak të një kohe të marrësh që autori asnjëherë nuk e ka marrë seriozisht gjendet një çelës leximi i novelës, çelësi nëpërmjet të

<sup>12</sup> Po aty, fq. 21

cilit unë e kam lexuar atë.

Besimi i verbër në gjëra të pamundshme për të qenë ashtu sikurse thuhet është një karakteristikë po ashtu e përhershme, me formë të ndryshuar për hir të dinamikave shoqërore. Për shembull, rasti i përshkruar te novela: *Befasisht i shfaqën në qarkullim një mori letrash me përmbajtje misterioze: Puth një njeri, rishkruaje këtë letër në njëzet kopje dhe shpërndaje në miqtë e tu, që të kesh fat. Mos harro ta bësh këtë, sepse përndryshe fati do të të ndëshkojë. Kosta grekut, që harroi ta shpërndante letrën dhe këputi zinxhirin, pas katër ditësh i vdiq gruaja*, ofrohet prap, tani nëpërmjet internetit ku rëndomë gjen shkrime të tilla që po të mos i ndash me kaq apo aq nejrëz, do të kesh një fat të mbrapshtë për shtatë vjet.

Emrat, motivet dhe programet e partive e mandej shoqatave janë ngjyrat më të sakta për ta pikturuar kasoën e përgjithshëm kur absurdja merret seriozisht dhe kushdo mendon se jo vetëm mund të kontribuojë për përmirësimin e situatës, por se ai vetë, personalisht, ka përgjegjësinë e ndryshimit të të gjithë sistemit.

Askush nuk është dakord me askënd. Nëse arrihet një farë besimi në më shumë se dy persona për një çështje, është e pamundur t'i bësh bashkë sërish ata të dy për çfarëdolloj gjëje të lidhur me atë çështje.

Pranvera (e lirisë) vendoset përballë një shtrengate të fortë dimërore të shkatërrimit të përgjithshëm. Dyqane, fabrika e objekte të tjera

shtetëore në dobi të popullit hidhen poshtë si të mos kishin asnjë vlerë, pa kuptuar se në fakt, janë aty për t'u shërbyer shkatërruesve. Mes tyre edhe biblioteka ku djegia e veprave të diktatorit kthehet në një manifest nazist me zjarre bubulake plot libra, titullin dhe përmbajtjen e të cilëve nuk e di askush. Virtyti dhe vesi njësohen, pa u kuptuar qartë kush zë vendin e kujt dhe as cili prej tyre nderohet e vlerësohet më tepër. Idhujtaria që ka sjellë kultin e individit nuk rrëzohet, por zëvendësohet me një të ngjashme me të, veçse individi mbi pedestal ndryshon herë pas here. *Idhujtaria e re*, shkruan autori, *është kret e denjë për të zëvendësuar atë që u shemb*.<sup>13</sup>

Zhbërja e përgjithshme si të mos kishte ekzistuar ndonjëherë e dyzetepesë viteve kthehet në qëllim të verbër, çka nxit dëshira të fantaksura, si për shembull strehimin në një tjetër kohë. Kjo më kujtoi motivin bazë të *Kohëstrehim* shkruar nga George Gospodinoc, fitues i *Booker Prize* për vitin 2023. Te libri i Sinanit, e tashmja rrënohet për të krijuar një strehë më të qëndrueshme në të shkuarën, çfarë është aq e pamundur, kështu dalim sërish te fjalitë e para se një iniciativë e tillë mund të përcillet vetëm me të qeshur.

*Siç duket, po aq sa vullneti i njerëzve për t'u marrë me të kaluarën vepronte edhe instikti i mbijetesës historike. Veçse pak kush e kuptoi se më së shumti historia përsëritet në trajtë komike*.<sup>14</sup> Ky është, për mendimin tim, thelbi i këtij teksti. Autori përmend çaste historike që i sheh si profetike, të vazhdueshme në një cikël të pambarimtë, për të parën herë tragjik a realist së paku e mandej, përherë e më qesharakë. Momenti, në një vëzhgim nga e ardhmja, letrarizohet e në të njëjtën kohë, ruan gjithë karakterin e tij për të qenë pjesë e përshkrimit antropologjik të përballjes së një kombi me një situatë krejt të pazakontë, paçka se asgjë e re nuk ndodh më nën këtë diell.

Çështje për të cilat askush nuk e vret mendjen ndonjëherë, si për shembull arsyeja pse u themelua një Ministri Drejtësie për herë të parë aty në vitet '90 apo rilidhja e fillit të shkëputur për thujtë pesë dekada të këngëve për gurbetlitë marrin përgjigje dhe nxisin pyetjet të tjera, mbi tematika të marra përgjithësisht si të njohura, të mirëqena, por që në të vërtetë nuk janë të tilla dhe njerëzve u mungon vetëdija për ta kuptuar këtë.

Të dalë nga një sistem ateist, i pari dhe i vetmi në llojin e tij, diskutimet e personazheve mbi besimin tregojnë mosnjohjen as në sipërfaqe të kësaj përmase shpirtërore e në të njëjtën kohë, nuk shmangin një tipar tjetër: mospranimin e paditurisë.

Fillimi dhe fundi i kronikës, sikundër narratori e quan tekstin e tij në mbyllje të librit, aq sa duken të *fiksuar*, aq janë krejt të mjegullta. Ngase më së shumti historia përsëritet në trajtë komike, fillimi mund të jetë kudo, kurse fundi, askund.

<sup>13</sup> Po aty, fq. 130.

<sup>14</sup> Sinani, Sh., vep. cit., fq. 122.

Prej antologjisë së Gustav Majerit *Della lingua e della letteratura albanese* (Romë, 1885) e deri te vëllimi i Profesor Agim Vincës, *Antologji e lirikës shqipe të dashurisë* (Prishtinë, 2024), janë botuar shumë përzgjedhje qasjesh të ndryshme, sprovash të veçanta dhe panorama e përmbledhje me përmbajtje nga gjini e lloje letrare të caktuara. Prej Gustav Majerit, te Gaetano Petrotta, Dhimitër S. Shuteriqi, Rexhep Qosja, Nasho Jorgaqi, Rexhep Ismajli, Ali Aliu, Bashkim Kuçuku, Gazmend Krasniqi etj., janë botuar vëllime antologjish me poezi, proza, drama, kritika, ese, si dhe përmbledhje gjithëpërfshirëse për autorë, personalitete, tema kombëtare, politike, kulturore dhe madje përzgjedhje tekstesh për të huaj.

Prej mënyrës së përgatitjes së tyre, prej gjithëpërfshirjes së tyre, prej përzgjedhjes së teksteve dhe prej vlerave estetike të paraqitjes së tyre nuk është vështirë të shihet se rezultatet më të mira i kanë sjellë ligjëruesit e këtyre llojeve dhe gjinive, si dhe njohësit dhe studiuesit shumëvjeçar të tyre.

Profesor Agim Vinca është ligjëruesi dhe studiuesi më i mirë i poezisë shqipe prej më shumë se një gjysmë shekulli, prandaj nuk është e rastit që ai ka përgatitur disa vëllime/përzgjedhje me poezi, madje në gjuhën shqipe dhe boshnjake, ndërsa së fundi ka sjellë një nga antologjitë më të mira të poezisë shqipe të kohës sonë. Duke qenë ligjërues dhe studiues prej pesë dekadash, duke e njohur e parë atë në tërësinë e saj dhe duke e vlerësuar atë brenda vlerave estetike, ai nuk kishte se si të ankohej për mangësitë e saj, për shkak të mosnjohjes së letërsisë së një periudhe letrare a një tjetre, një hapësire gjeografike a një tjetre, duke përfshirë këtu edhe diasporën. Përkundrazi në antologjinë e tij ai nuk ka mbajtur qëndrim refuzues as ndaj përbërësve estetikë, dialektorë a ideologjikë, ndaj një krijuesi a një tjetri, sikur kanë mbajtur paraardhësit e tij dhe madje bashkëkohësit e tij viteve të fundit, prandaj antologjia e tij është një dhuratë, sikur është shprehur në përkushtim e tij në librin që na e dhuroi: “me dashuri, për dashurinë...”.

Kur në vitin 1970 Profesor Rexhep Qosja botoi *Antologjinë e lirikës shqipe*, një prej vërejtjeve që ju bë nga shtypi i kohës ishte se në atë vëllim poetik kishte “pak poezi patriotike”, ndërkohë që ai në pasthënien e saj kishte theksuar se “kjo poezi nuk qëndron në ndonjë nivel të lartë artistik...”. Atë kohë Profesor Qosja qe përgjigjur: “Është e vërtetë se pjesa më e madhe e poezisë sonë patriotike nuk qëndron në nivelin e, për shembull, poezisë meditative ose të poezisë së dashurisë. Krijimi i lirikës patriotike është sa i lehtë aq edhe i vështirë: mund ta shkruaj shumëkush, po edhe pak kush”. (Qosja, *Rilindja*, 1970/1971: 24)

Profesor Agim Vinca, i cili dekada më vonë ka botuar një antologji të poezisë atdhetare (*Muza e mëmëdheut*, 2012), në këtë vëllim, sikur do të donte Profesor Qosja, ka kapur majat e poezisë, poezinë e dashurisë në përmasa kohore, hapësinore dhe estetike, duke përfshirë këtu edhe atë të traditës popullore.

Vëllimi hapet nga një *Parathënie*, me qëllim dëshmie mbi karakterin historik të projektimit të saj, strukturën historiko-letrare të natyrës së një antologjie të tillë, shpjegimet teoriko-letrare mbi thelbin e vetë poezisë së dashurisë, strukturën përmbajtjesore të periudhave letrare dhe përfaqësuesve të saj (nga letërsia e vjetër deri te postmodernistët), si dhe kriteret e përpilimit të një vëllimi të këtillë.

Motivi, shtytja e një ndërmarrje të tillë ka një histori të veçantë. Ajo fillon diku nga fundi i viteve '60 kur një nga përkthyesit kroat dhe autor i një *Antologjie të lirikës botërore të dashurisë*, në veprën e tij shqiptarët i përfaqësonte me një shkrimtar epik të përmasave kombëtare e ballkanike,

Agim Vinca, *Antologji e lirikës shqipe të dashurisë*, Prishtinë, 2024, f. 280.

## ANTOLOGJIA E LIRIKËS SHQIPE TË DASHURISË

nga Myrvete & Begzad Baliu, Prishtinë

At Gjergj Fishtën dhe me një poet krejt të panjohur shkodran.

“Si ligjërues i poezisë bashkëkohore shqipe në fakultet, por edhe si poet, - shkruan Profesor Agim Vinca, - atëbotë isha thujse ditë e natë me libra poezie në dorë; i lexoja dhe rilexoja vazhdimisht; mbaja shënime e bëja komente; i analizoja me gojë e me shkrim; ua lexoja studentëve në orët e ligjëratave e ushtrimeve dhe kërkjo mendimin e tyre për to; mësoja përmendsh vargje e strofa, por edhe vjersha të tëra (natyrisht ato më të bukurat) dhe kërkjo edhe nga studentët e mi që të vepronin nësoj. Me një fjalë, isha shumë i lidhur me poezinë në përgjithësi dhe me poezinë shqipe në veçanti (siç jam, pak a shumë, edhe sot) dhe nuk mund të pajtohesha lehtë që të injorohej a anashkalohej ajo nga kushdoqoftë. Nuk mund të pajtohesha, prandaj, kurrësi me qëndrimin që kishte mbajtur ndaj poezisë shqipe - në rastin konkret ndaj poezisë erotike shqipe - autori i *Librit të artë të lirikës botërore të dashurisë*, pavarësisht në ishte ky qëndrim pasojë e mosnjohjes apo e paragjyqimeve eventuale për letërsinë dhe kulturën shqiptare” (15-16).

“Atëherë vendosa t'i hyja hartimit të një antologjie të lirikës shqipe të dashurisë, ku do të përfshiheshin perlat e lirikës shqipe me këtë temë, duke filluar nga letërsia

gojore e deri te vjershat e poetëve të kohës sonë. Dhe i hyra punës në këtë projekt ambicioz e afatgjatë. Në një fletore e dosje të veçantë shënoja ditë pas dite e vit pas viti titujt e vjershave dhe emrat e autorëve; bëja shënime e komente rreth tyre; i shtypja në makinë ose i përshkruaja me dorë (për t'i përjetuar më mirë) tekstet e vjershave, qofshin edhe të gjata; e plotësoja herë pas here “listën” me emra të rinj poetësh e titujt të rinj vjershash; e braktisja këtë punë për një kohë, herë më të gjatë e herë më të shkurtër, për t'iu rikthyer përsëri. Kjo punë zgjati, siç thashë më lart, me vite e dekada” (16).


Njohës i traditë dhe i prirë që ta respektoj atë, Profesor Agim Vinca, periudhat e zhvillimit të letërsisë shqipe i ka ndarë pak a shumë, e edhe emërtuar sipas një tradite historiko-letrare, që i ka njohur prej më shumë se një shekull shkolla shqiptare: I. Letërsia e vjetër, II. Rilindësit, III. Indipendencë, IV. Bashkëkohorët dhe V. Postmodernistët. Lexuesit e veprës shkencore të Profesor Agim Vincës, të cilët Profesorin e tyre e kanë njohur për prirjet shumë të rrepta të përdorimit të terminologjisë dhe nocioneve historiko-letrare, mbase edhe nuk e kuptojnë drejtë këtë ndarje. Por njohësit dhe kulturës dhe letërsisë universale të tij ndërkaq, e kuptojnë se nuk është aspak e rastit. Një *Antologji*

me synim një temë të caktuar - perlat e poezisë shqipe të dashurisë, nuk kishte pse ta përjashtonte poezinë e poetëve anonim dhe nuk e kishte të domosdoshme ndarjen e tyre me periudha, koncepte dhe nocione teoriko-shkencore: Letërsia e vjetër / letërsia biblike / letërsia e bejtexhinjëve; Letërsia e Rilindjes/letërsia e romantizmit; Letërsia e independencës/Letërsia ndërmjet dy luftërave/Letërsia moderne dhe brenda saj: letërsia romantike, realiste, neoklasiciste, parnasiste e simboliste/letërsia moderne; letërsia bashkëkohore / letërsia sociale / letërsia e realizimit socialist/ letërsia moderne / letërsia postmoderne etj. Përtej kësaj ndarjeje, në vëllimet antologjike si kjo e Profesor Vincës nuk do të ishte fare e rastit që të mungonin jo vetëm autorë të njohur për motive të tjera historiko-letrare po edhe ndonjë periudhë e tërë letrare. Për më tej, nuk është e rastit, që disa poetë, me veprën e tyre më të mirë hyjnë në një periudhë letrare, ndërsa në këtë vëllim kalojnë në një periudhë tjetër letrare. Vetëm një njohës i gjerë, studiues për një periudhë shumë të gjatë i poezisë, dhe për më tej, poetë i kërkimeve të thella stilistike, si Profesor Agim Vinca, ka mundur të sjellë një përzgjedhje kaq sistematike të saj, sipas periudhave, autorëve dhe madje poezive veç e veç.

Megjithëse ka disa dekada që poezia popullore është përjashtuar nga sintezat, panoramat dhe antologjitë historiko-letrare në letrat shqipe, profesor Agim Vinca e ka hapur antologjinë e poezisë së tij me një cikël të zgjedhur prej katërmëdhjetë poezish nga *poetët anonimë*, botuar nga studiues shqiptarë e të huaj gjatë tre shekujve të fundit, duke përfshirë këtu edhe motërzimet dhe variantet: *Bukuria e Tanushës*, *Në drrasë të vekut kush po kan...*, *Shumë u desh vasha me trimin*, *Mike me shami më nj'anë*, *Sojzeza*, *moj sojlarushe* etj. Cikli i tyre është përcjellë nga një koment përmblyllës, në të cilin janë theksuar veçoritë themelore të tyre: “përmbajtje të gjerë dhe një regjistër të pasur mjtesh shprehëse” (45); “sensualizmin” (45); “poetin liberal” (45); “larminë e madhe të mjeteve shprehëse” (45); “lakonizmin e paparë” (45). Po kështu mund të thuhet edhe për poetët pa emër, anonimë: “individë të talentuar” (45); “një a më shumë” (45); prandaj edhe këngë me shumë variante.

Periudhën e letërsisë së vjetër, të prezantuar në këtë Antologji, e përbëjnë dy kushërinjtë: Pjetër e Lukë Bogdani. I pari me tri vargje ndërsa i dytë ma tri strofa; një bejtexhi me dy poezi Sulejman Naibin, me përshkrime nga më të pasurat të vajzës, si dhe dy fragmente të poemës së Jul Varibobës, me të cilin hapet letërsia laike e arbëreshëve, shkruan Profesor Vinca. Mbetet për të hyrë në këtë kapitull edhe Hasan Zyko Kamberi dhe një poezi e pagjetur e tij për takimin e djalit me çupën.

Nëse poezia e letërsisë së vjetër është më modeste në raport me poezinë e dashurisë, sepse kjo letërsi ende nuk ishte shkëputur nga përbërësit biblikë të njësive estetike dhe tematike, letërsia e shkrimtarëve të periudhës së Rilindjes Kombëtare është më dorëlidur me motivet e dashurisë dhe më tej ndjenjat erotike, në raport me përmbajtjet iluministe, humaniste dhe atdhetar. Nga kjo periudhë historike, përkatësisht letrare, janë përfshirë shkrimtarët Jeronim de Rada, Zef Serembe, Naim Frashëri, Anton Zako Çajupi, Gjergj Fishta, Zef Skiroi, Aleksandër Stavre Drenova -Asdreni, Fan S. Noli dhe Hilë Mosi. Ndonëse Anton Zako Çajupi, me kryeveprën e tij “Baba Tomorri”, Gjergj Fishta me kryeveprën e tij “Lahuta e Malcis”, Aleksandër Stavre Drenova me vëllimin “Psallme Murgu”, Fan Noli me pothuajse të gjitha poezitë e tij të veprës “Albumi”, hyjnë në periudhën e letërsisë së independencës, në *Antologjinë* e Profesor Agim Vincës, përkatësisht me poezitë e zgjedhura me



temë lirikën e dashurisë, ata hyjnë në periudhën e letërsisë së romantizmit.

Nëse e pranojmë mendimin e historianëve të letërsisë se romantikët pa përjashtim kanë shkruar me sukses jo vetëm poezinë e patriotike/atdhetare po edhe poezinë e dashurisë, mbështetur edhe në këtë vëllim mund të thuhet se prej letërsisë së shkrimtarëve të periudhës së romantizmit (po e theksoj romantizmin si drejtim letrar dhe jo Rilindjen si periudhë e zgjimit kombëtar, sepse disa prej shkrimtarëve këto poezi i kanë shkruar dhe botuar në Periudhën e Indipendencës), mund të përgatitet një antologji shumë e pasur e lirikës së dashurisë.

Pse të mos thuhet kështu?

Motivi atdhetar dhe motivi i dashurisë, në veprën *Këngët e Milosaos*, të themeluesit të letërsisë së romantizmit Jeronim De Radës, brenda veprës zhvillohen në mënyrë komplementare; poezia e Zef Serembes atdhetarizmin e zhvillon brenda motivit të dashurisë; vlerat estetike të poezisë së dashurisë në krijimtarinë letrare të Naim Frashërit, kulmojnë në majat e vlerave estetike të poezisë atdhetare; motivet e lirikës popullore të dashurisë në poezinë e Çajupit janë po kaq të pasura sa edhe në poezinë sociale; poemthi i Gjergj Fishtës *Një lule vjeshtet* konsiderohet një nga lirikët më të bukura të tij dhe e vetmja e këtij motivi; poezia e Zef Skiroit është një himn i rrallë i mallit dhe dashurisë njëkohësisht; poezia e Asdrenit me gjithë atdhetarinë e tij dhe përmasën më moderne të bashkëkohësve të tij, nuk mund të perceptohet pa poezinë e dashurisë. Poezia e tij me motive dashurie mund të konsiderohet si krijimtaria më me ndikim në kulturën shqiptare edhe për faktin se tekstet e tij shumë herë janë bërë këngë artistike të komponuara, jo vetëm në kohën e tij, sikur thuhet për Hil Mosin, po edhe në kohën tonë. Më i veçantë në këtë *Antologji* shfaqet Fan S. Noli. Autori që, sipas Profesor Qosjes mund të përfshihej me të gjitha poezitë në një vëllim të *Antologjisë historike të letërsisë shqipe* me përjashtim të poezisë *Plak, topall dhe ashik*, pikërisht me këtë poezi shfaqet në *Antologjinë e lirikës së dashurisë*, të Profesor Agim Vincës.

Më në fund, Noli i plotë, antologjist!

Po kështu mund të thuhet edhe për Hil Mosin, atdhetarin e publicistin e madh, por poetin modest të poezisë atdhetare, që nuk i ka përmbushur kërkesat për të qenë kapitull i veçantë i periudhës së letërsisë së romantizmit në sintezën e Profesor Qosjes, por tani i përmbush kërkesat për të qenë poeti i lirikës së dashurisë në *Antologjinë* e Profesor Agim Vincës.

Me poezinë lirike të dashurisë të Periudhës së Indipendencës hyjnë tetë autorë: shkrimtari më i popullarizuar i ligjërimit popullor, Omer Khajami i shqiptarëve do të thotë Profesor Agim Vinca, poeti i popullarizuar Ali Asllani, me shtatë poezi; intelektual, atdhetari, kryepublicisti e bibliofili më i madh i gjysmës së parë të shekullit XX, por poeti modest, Mid'hat Frashëri, me poezinë *Asaj...;* poeti e përkthyesi i veçantë, po jo shumë i njohur deri më tash Lazër Shantoja me poezinë *Për një puthje të vetme*; shkrimtari më i popullarizuar i lirikës shqipe, sigurisht jo vetëm i dashurisë, nositi i poezisë sonë Lasgush Poradeci, me dymbëdhjetë poezi; poeti i asaj vazhdimësie të artë të traditës shqiptare Ernest Koliqi; prozatori, më parë se sa poeti, i satirës shqiptare, "rrëmbyesi" i një vaje franceze sipas "traditës shqiptare", Nonda Bulka; poeti dhe më tej prozatori e kritik i brilant Mitrush Kuteli; poeti i mjerimit Millosh Gjergj Nikolla - Migjeni, poezia e të cilit në lirikën e dashurisë shfaqet me elemente, të cilat i tejkalojnë përbërësit e lirikës së dashurisë nga tradita në letërsinë bashkëkohore; dhe së fundi Nexhat Haku, poeti që e ka krijuar simbolin e parajsës së ëndrrës së të dashuruarve.



Le të thuhet këtu se kjo është periudha e poetëve që si me numrin e poezive ashtu edhe me numrin e vargjeve dhe përbërësve stilistikë të realizimit të saj, e ka tejkalar letërsinë e periudhës pararendëse dhe është bërë pothuajse e paarrirë në periudhën prapavajtëse.

Kapitulli i pestë, përkatësisht lirika bashkëkohore e dashurisë mund të quhet periudha më karakteristike dhe më gjithëpërfshirëse (gjeografike, historike dhe stilistike) e antologjisë së lirikës së dashurisë. Brenda këtij kapitulli janë përfshirë jo vetëm "shkrimtarët nacionalë", sikur thuhet përgjithësisht për shkrimtarët e Rilindjes apo vetëm "shkrimtarët e Shqipërisë", sikur thuhet ndonjëherë për shkrimtarët e periudhës mes dy luftërave botërore, po shkrimtarët e gjithë hapësirës etnike dhe madje diasporës, në ato përmasa që nuk shfaqen në periudha të tjera para saj dhe madje pas saj, kur shkrimtarët e postmodernes nuk shkruajnë vetëm në gjuhën shqipe (si kriter i përfshirjes së tyre brenda *Antologjisë*), po edhe në gjuhën e shteteve ku jetojnë.

Në kapitullin për letërsinë bashkëkohore të poezisë së dashurisë janë përfshirë shkrimtarë nga Shqipëria shtetërore, Kosova dhe shkrimtarët në ish-Jugosllavi, e kjo do të thotë edhe shkrimtarët në Maqedoninë Veriut; shkrimtarët e diasporës historike dhe shkrimtarët që kanë shkruar dhe shkruajnë sot në diasporën e re në Europë dhe Amerikë.

Kapitulli i poezisë së lirikës së dashurisë hapet pothuajse në mënyrë të pazakonshme, me një krijues nga diaspora, bardin e poezisë arbëreshe Vorea Ujkon dhe me poetin e kryqëzimit tradicional të strukturës së poezisë shqipe e sintezës tematike moderne evropiane Arshi Pipën; për të vazhduar me shkrimtarin mbamendës të letërsisë së Luftës së Dytë Botërore L Lazar Siliqin, shkrimtarin e përtëritjes së sonetit në letrat shqipe dhe gjuhës së pasurë të togfjalëshit të tij, Enver Gjerqekun; lirikun dhe poetin e dehjes dhe së bukurës bodleriane, Vehbi Skënderin; poetin dhe lirikun e këngës tradicionale për "zogëzën" e Dukagjinit, Din Mehmetin; kryemjeshtrin e poezisë erotike shqiptare, poetin bohem, poetin që e "zhveshi gruan e eposit" Pano Taçin etj:

*E ndezur prush,*

*Te bregu i lumit hapin e shtriu;*

*Kur pa që s'e shikonte kush,*

*u zhvesh... e pyelli psherëtiu. (Tanusha, f. 218).*

Më tej Profesor Agim Vinca ka sjellë Fatos Arapin, shkrimtarin e fatjetës dhe dashurisë, poetin që gjatë gjithë jetës krijuese e përcolli poezia antologjike e dashurisë *Ti do të vish...* ndërsa me rastin e vdekjes, si asnjë poet tjetër i dha lamtumirën pikërisht një lirikë dashurie *Si s'të desha pak*

*më shumë*; poetin e dashurisë së heshtur, lasgushianin që krijonte në qetësi dhe pa ndikimin e lexuesit bashkëkohës të tij, madje edhe pas rënies së komunizmit, Mihail Hanxharin; Dritëro Agollin, poetin që si as edhe një lirik tjetër ka ndërldhur traditën popullore të poezisë së dashurisë me traditën e lirikës më të bukur të Rilindjes dhe Indipendencës e bashkëkohësve të tij, traditën e krijuesve më të mirë të letërsisë bashkëkohore shqipe dhe botërore, duke i parë ato, shqipëruar dhe përshtatur si një mjeshtër po i të njëjtit format; Dhori Qiriazin poetin e baladave intime, shkruar atëherë kur poezia shqipe ishte letërsi para se gjithash lirikë e *linjave të largëta*; Bilal Xhaferi, poeti i dhimbjeve të mëdha etnike dhe trishtimit personal, si vetë titulli i poezisë: *Vetëm ti lulëzon në peizazhet e trishtat*; Adem Gajtanin, poetin e kopshtit të të gjithë përbërësve të dashurisë dhe madje xhelozisë; Ismail Kadarenë, poetin e poezisë lirike të dashurisë përgjithësisht dhe poetin e lirikës erotike në kuptimin e parë të saj, poetin e "lirikës elitare dhe elegante", komenton në tekstin e tij përmbyllës Profesor Vinca; Qerim Ujkanin, poetin e krijimit klasik të portretit të gruas; Azem Shkreli, poetin e mendimit dhe fjalës së thellë e të kulluar, poetin e ndjeshmërisë së mendimit të motshëm dhe trajtës moderne të të thënit; Jorgo Bllacin, poetin e jetës së errët prej burgu dhe poetin e përkthyesin e lirikave të bukura të dashurisë; Adelina Mamaçin, poeten e erosit të vashërisë; Frederik Reshpjen, Koçi Petritin, Musa Vyskhën, Ndoc Gjetjen, Xhevahir Spahiun, "poetin më autentik në letërsinë shqipe", "poetin me dhunti të rrallë krijuese në letërsinë bashkëkohore", thotë Profesor Vinca; Natasha Lakon, Bardhyl London, dhe poetët që dy dekadat e fundit me përkushtimin e tyre ndaj kujtesës, poezisë dhe përkthimit hynë në shumë antologji, ku nuk kanë mundur të hyjnë poetët e brezit dhe fateve të tyre: Iljaz Bobajn, Skënder Rusin dhe sidomos Visar Zhitin.

Poezia e kësaj periudhe, si asnjë tjetër, e ka zgjeruar horizontin gjeografik të krijuesve, i ka përplotësuar temat universale dhe personale të dashurisë, e ka ridimensionuar strukturën përmbajtësore të teksteve të poetëve anonim, poezisë pararendëse dhe poezisë botërore. Nuk mund të thuhet ndërkaq për përpunimin e strukturës së vargut e të rimës, një përvojë kjo me të cilën identifikohet poezia e shkrimtarëve të periudhës së indipendencës.

Vëllimi i *Antologjisë së lirikës së dashurisë* përmbillet me kapitullin e shkrimtarëve përfaqësues të cilët Profesor Agim Vinca e ka përfshirë brenda kapitullit *Postmodernistët*: Abdulla Tafa, Teodor Keko, Petrit Qejvani, Adem Gashi, Petrit Ruka, Mimoza Ahmeti, Rita Petro, Gjokë Marinaj, Lulzim Tafa, Alket

Çani, Donika Dabishevcu, Ag Apolloni dhe Vjollcë Berisha.

Janë shumë karakteristika historike, kulturore, biografike e estetike që e përshkruajnë këtë kapitull postmodernistësh: numri i vogël i tyre (trembëdhjetë), në krahasim me numrin e madh që shfaqen dy dekadat e fundit, ndonëse tre përfaqësuesit më të ri (Dabishevcu, Apolloni dhe Berisha) kanë lindur në vitet 1980-1983; numri dukshëm i madh i shkrimtareve femra (Mimoza, Rita, Donika, Vjollca, jo rastësisht i shënova pazakonshëm emrat e tyre e jo mbiemrat); përbërësit intelektualë të biografisë së tyre (Abdullah Tafa, e Rita Petro - botues, Petrit Qejvani - profesor, Gjokë Marinaj, - ligjërues, Lulzim Tafa - ligjërues, Donika Dabishevcu - studiuese, Ag Apolloni - ligjërues, Vjollcë Berishsha - studiuese). Shumë prej tyre jetojnë jashtë hapësirës shqiptare. Një numër dukshëm i madh i tyre janë jo vetëm autorë poezish po edhe njohës e ligjërues të saj si dhe përkthyes e madje botues të letërsisë së vendeve ku jetojnë. Poezia e tyre nuk është poezi e vargjeve të çastit, por realizime të temave të mëdha nga miti i trashëgimisë të tema e incestit. Ato janë poezi të një posthumanizmi hapur erotik, ardhur në letërsinë europiane kryesisht pas vitit 1968 dhe letërsinë shqipe kryesisht pas vitit 2000 dhe teknikisht, poemtha me struktura të gjera krijuese, një dëshmi kjo se ato nuk janë poezi të rastit po tekste të shkruara me dhunti krijuese, njohje të teknikave të vargut dhe kërkim të temës së dashurisë nga qiellorja deri te tokësorja e më tej. Skajet e këtij kërkimi madje nga "puritanizmi te voluptanizmi" (Profesor Vinca), i ka realizuar vetëm ky brez i krijuesve postmodernistë.

Vëllimi *Antologji e lirikës shqipe* të dashurisë e Profesor Agim Vincës është një nga antologjitë sigurisht më të plota dhe më të mira, të përgatitura tri dekadat e fundit.

"Kanë kaluar vite e dekada nga koha kur më lindi ideja fillestare për këtë antologji e deri më sot kur po i jap fund asaj për t'ua bërë dhuratë lexuesve - besnikë të fjalës së bukur shqipe, - shkruan Profesor Agim Vinca, - kudo që janë, në tërë hapësirën shqiptare apo edhe në botën e madhe. Edhe të huajve që interesohen për vlerat shpirtërore të shqiptarëve si komb, sigurisht" (32).

Në këtë vëllim janë përfshirë sigurisht poetët dhe poezitë më të mira të lirikës së dashurisë. I kam vendosur emrat e të gjithë poetëve të përfshirë në këtë vlerësim i vetëdijshëm se pas botimit të saj reagimi i shkrimtarëve të cilët nuk janë përfshirë në këtë *Antologji*, nuk do të jetë i vogël. Sigurisht do të reagojnë për shkak se në këtë vëllim nuk janë përfshirë disa nga poetët që janë përfshirë në *Antologjinë* historike të letërsisë shqipe, po jo edhe këtu; janë përfshirë në *Antologjinë* e lirikës shqipe por jo edhe në këtë vëllim lirik; janë përfshirë në *Antologjinë* e poezisë së letërsisë shqipe për të huaj, po jo edhe këtu. Do të thonë madje se në këtë vëllim nuk është përfshirë edhe një nga poetet më të mira të lirikës arbëreshe, recensuesja e këtij vëllim Kate Xukaro, si dhe poetët pa të cilët janë përfshirë dekada më parë në antologjitë e letërsisë shqipe, si dhe do të shkojnë më tej duke u "shqetësuar" se si Profesor Agim Vinca, njëri prej lirikëve më të mirë të poezisë bashkëkohore shqipe dhe madje njëri prej poetëve më të mirë të lirikës së dashurisë, e paska "përfshijtur" edhe vetën!

Le të jetë prandaj kjo një nga dëshmitë e parimësisë së tij etike dhe antologjike, që në *Antologji* (cila do qoftë ajo) nuk mund të përfshihesh pa poezi antologjike dhe nuk mund të vetëpërfshihesh. Në këtë rrjedhë, besoj, të gjithë mund të vinë në një përfundim unik: nga kjo *Antologji* nuk mund të nxirret asnjëri prej tyre dhe asnjë prej poezive të tyre.

## HYRJJE

nga Prof. Dr. Diana  
Alqi Kristo

Me gjithë se në ditët e sotme Shekspiri nderohet më tepër si dramaturg, në kohën e vet ai nderohej po aq edhe si poet. *Afërdita dhe Adonisi*, një poemë narrative kjo, u botua për herë të parë më 1593. Ajo nuk ishte vetëm e para vepër e dalë nga pena e Shekspirit që pa dritën e botimit, por me sa duket, edhe puna e parë e tij, në qoftë se marrim për bazë fjalët që shkruan në kushtimin e saj, “trashëgimtari i parë i krijimtarisë sime”. Megjithëse një epikë minore, poema pati aq shumë sukses sa konsiderohej si vepër më e popullarizuar e asaj kohe dhe u ribotua të paktën 12 herë, më shumë se çdo poezi tjetër e kohës, gjatë kohës sa qe gjallë autori. Qysh prej asaj kohe, poema është përfshirë në përmbledhje, antologji, botime të veçanta, koleksione moderne të veprës së plotë të Shekspirit sa, për të gjetur sa herë është botuar, do të duhej të shfletonim bibliografitë e specializuara për Shekspirin, Bibliotekën Folxhër të Shekspirit (Folger Shakespeare Library) ose Katalogun e Titujve të Botimeve në Anglisht (English Short Title Catalogue) (ESTC, 1473-1800).

Burimi klasik i legjendës, si baza e poemës, është ndoshta *Metamorfoza* e Ovidit, e cila përmendej në të gjitha punimet e kësaj fushe nga poetët elizabetianë. Tomas Loxh (Thomas Lodge), në veprën *Glaukusi dhe Shila* (1589), trajtonte një temë shumë të përafërt me atë të Shekspirit dhe është me siguri autori më i rëndësishëm që i ka dhënë shtysë kësaj poeme edhe në formën e ngjashme poetike.

Në *Metamorfozën* e Ovidit, djaloshi gjuetar është dashnori i dëshirueshëm i Aftërditës (Venusit), perëndeshës së dashurisë, i cili vdes aksidentalisht. Tek Shekspiri, Adonisi kërkon ta mbajë larg Afërditën, e cila i lutet gjithë zjarr dhe nuk ua vë veshin fjalëve idhnake të tij. Shekspiri luan me nocionin se çfarë mund të ndodhë nëse refuzohet dashuria e perëndeshës, një temë që rimerret në forma të ndryshme në komeditë e tij.

Megjithëse ka kaluar shumë kohë qysh se epika minore nuk është më në modë, kjo poemë, që vjen nga periferia e mitit dhe legjendës, ende vlerësohet për veshjen verbale mahnitëse, për sofistikimin, mprehtësinë, lojën e fjalëve, si një pjesë e pashlyeshme e artit barok në format e tij më delikate, një qëndismë plot ngjyra e pushtetit magnetik të dashurisë së qashtër që ngrihet mbi epshet tokësore.

Kjo poemë, e përkthyer me aq pasion nga shkrimtari e përkthyesi i talentuar Alqi Kristo, botohet për herë të parë.

## Për herë të parë në gjuhën shqipe

## SHAKESPEARE

## Afërdita dhe Adonisi

## Shqipëroi: Alqi Kristo

1

Kur dielli faqe purpur u harlis,  
Me lejen e mëngjesit ditën shpallte,  
Adonis faqekuq për gjah u nis;  
Gjahun donte, dashurinë e tallte.  
Dashnorja Ditë me paturpësi<sup>1</sup>  
E ndoqi pas t'i shfaqte dashuri.

2

“Tri herë, - tha, - m'i bukur je se unë,  
M'i ëmbël nga çdo lul' e karafil,  
Nga zana dhe njeriu m'i bukur shumë,  
I bardhë borë, i kuq si trëndafil.  
Natyra që të dha gjithë ato nota,  
Ka thënë se me ty merr fund dhe bota.

<sup>1</sup> Afërdita, shkurt Dita ose Venusi, është perëndia e bukurisë dhe dashurisë. Adonis është djaloshi i dashuruar nga Afërdita që vritet nga një derr i egër.

3

“Denjo o mrekulli t'i zbresësh atit,  
Kokën krenare ulja gjer në baltë;  
Po më dëgjove, merr shpërblim prej fatit,  
Me mijëra fshehtësi të ëmbla mjaltë.  
Ulu këtu, ku gjarpri nuk na cyt  
Se me të puthura do të të mbyt.

4

Por buzët nuk t'i vel me neveri,  
Ato, duke t'i ngopur, do t'i et,  
Do të t'i skuq t'i zbeh me plot larmi;  
Një puthje do ta zgjat sa për njëzet.  
Një orë do të duket ditë vere  
Se do humbasë në dëfrim pranverë”.

5

Kështu e kap në dorën e djersirë,  
Tregues fortësie e gjallërie,  
Dhe duke fërgëlluar plotë dëshirë,  
Balsam, e thërret, për kurë perëndie.  
Azdisja dhe dëshira për ta mposhtë,  
I dha guxim e forcë, e zbriti poshtë.

6

Me njëren dorë kalin mbajti në frenim,  
Me tjetrën e pushtoi djalit plot uri,  
Q'u skuq e drodhi buzët me përçmim,  
Se s'njilte epsh e lojna gizili.  
Ajo e nxehtë, e kuqe si një zjarr,  
Ai i kuq me turp, i ftohtë acar.

7

Frerin me lajle e lidhi në shegë  
Me shpejtësi. – Se dashuria s'pret! –  
Dhe u përpoq, si kalin natë degë,  
Ta lidhte dhe kalorësin e vet.  
I dha një shtytje fort që ta rrëzonte,  
Me forcë e munda, me epsh nuk e zgjonte.

8

Ajo u shtri më parë se ai;  
Mbështetur n'ijë, ajo fillon lojën;  
E prek në faqe, ai ndjen bezdi,  
Fillon ta shajë, ajo i mbyll gojën;  
E duke e puthur flet me gjysma fjalë:  
“Për sharje, s'ta lë zërin të të dalë”.

9

Ai me turp digjet, ajo me lot e shfrime,  
I shuan faqet zjarr, të qashtër e pafaj,  
Me flokët ar, me frymë e rënkime,  
I bën veri e rreket t'ia thajë.  
Ai e quan pa cipë, e qorton,  
Ajo me puthje, gojën ia shtupon.

10


Si shqipe e egërsuar nga uria  
Që qok me sqep mbi pendë, mish e eshtra,  
Që llup a përkund krahët nga lakmia,  
Gjer sa sos prenë e velet nëpër kreshta,  
Kështu i puth ajo faqe, sy e ballë  
E prapë e puth se s'ia nxjerr dot mallë.

11

Nuk bindet, por s'ka ç'bën, e le të shfrehet,  
Dihat e i hedh frymën në fytyrë,  
Ajo me frymë si me pre, ushqehet,  
E quan ajër hijeshie, hyjnore myrë;  
Do desh që faqet t'ishin kopsht i lulëzuar  
T'i vesonte me atë myrë të kulluar.

12

Tamam si zog të kapur në një rrjetë,  
E mban Adonin në krahë shtrënguar;  
Nga frika, turpi, ai rri i zbehtë;  
Duket m'i bukur me sy t'egërsuar.  
Lumi që fryhet nga shiu i shkel ligjet,  
Se rrym' e shtuar vërshon nga brigjet.





13

Ajo i lutet, ëmbëlsisht i lutet,  
Dhe veshit të tij t'ëmbël i drejtohet;  
Ai qëndron i zymtë e nuk zbutet,  
I kuq me turp, i zbehtë zemërohet.  
Të kuq' e tij ajo e do pa masë,  
Por zbehje e shtuar e bën të pëlçasë.

14

Ai nuk mund, ajo e dashuron!  
Për duart e pavdekshme i betohet,  
Nga gjoksi nuk i shkulet, nuk pranon,  
Gjersa t'i rreshtë lotët, të pajtohet,  
Dhe mos ia njomë faqet me shi pa  
pushim;  
E borxhi lahet veç me puthje e  
përqafim.

15

Fill pas premtimit ngre mjekrën ai  
Si shytra që ngre kokën pak mbi valë  
Dhe sa e shohin, zhytet përsëri,  
Kaq merr ajo nga i turpshmi djalë.  
Kur për shpërbletën ajo bën buzët  
gati,  
Ai ul sytë, kthen kokën prapa nga  
inati.

16

Kurrë udhëtari vapës ndonjë mot,  
S'ka pasur etje si kjo që po vuan,  
Ajo sheh ndihmë e ndihmën s'e merr  
dot,  
Zhytet në ujë e zjarrin nuk e shuan.  
"Mëshirë - thërret - o djalë  
zemërgur!  
Një puthje të kërkoj, pse më sëmur?"

17

"Në dashuri s'më ka munguar preja;  
Më desh dhe zoti i luftës që kall tmerr<sup>2</sup>,  
Që s'e përkul krenaren kokë në beteja  
Sepse fiton çdo luftë që ndërmerr.  
Por rob e sklavi im u bë ai kampion,  
Më lutej për atë që ti përçmon.

18

"N' altarim tim e varte shtizën mbrojtë,  
Dhe shqytin, përkrenaren e cunguar,  
Për hatrin tim mësoi të qeshë e  
vallëzojë,  
Të lozë, ngacmojë e dëfrejë pa  
pushuar;  
Të tallet me daulle lufte e me  
flamurë,  
Të shtrihet në shtrat' tim i çartur  
burrë.

19

"Kështu e mposhta unë sundimtarin,  
E lidha me zinxhirë të kuq trëndafili;  
Çelik fort i kalitur e shemb të parin,  
Përbuzjes time iu nënshtrua si servili.  
Oh, mos u mburr që paske aq  
pushtet,  
Se mposht një grua që mposhti një  
mbret.

20

"Bashkoje buzën e ëmbël me buzën time, -



S'është' aq e bukur, por është e kuqe; -  
Nj' e puthur imja, t'jep dhe ty ndijime;  
Ç'shikon përdhe? Ngri kokën; pse  
skuqe?  
Më shih në ninëz ku sheh bukurinë;  
Kur puqen sytë, pse buzët të rrinë?"

21

"Ke turp të puthësh? Atëherë pulit sytë  
Siç i pulit unë; që dita të duket natë;  
Dashuria gëzohet kur je vet' i dytë,  
Pra ki guxim të luash, lodrën e zjarrtë;  
Se këto vjollca damar-blu ku ne  
rrimë,  
S'bëzajnë asgjë, seç bëjmë ne nuk  
dinë.

22

"Burbuq' e pranverës në buzët e tua  
Nuk tregon pjekje; por s'të mungon  
shija;  
Përdore rastin dhe mos më humb  
mua;  
Nuk bën të rrënojë veten bukuria.  
Lulja qysh gonxhe duhet të këputet  
Përndryshe fishket shpejt e kalbet,  
zbruhet.

23

"Të isha e zhubrosur, e ndyrë, e  
shëmtuar,  
E pasjellë, e uritur, e ngjirur, gërmuqe,  
E ftohtë, e përbuzur, pa gjak, e  
dërmuar,  
E dobët, e shterpë, e thatë, pa burbuqe,  
Mund të nguroje, të thoje se s'vlen,  
Por pa asnjë të metë, pse m'urren?"

24

"Ti asnjë rrudhë nuk më sheh në ballë  
Çdo vit ma shton freskinë në pranverë;  
Sytë i kam blu, të ndritshëm e të gjallë,  
Mishin të hajthëm, të zjarrtë përherë.  
Në dorën tënde, dora ime e mekur,  
Do shkrihej në pëllëmbën tënde me  
t'u prekur!"

25

"Më bëj të flas, të ysht duke dëgjuar  
A të baras mbi bar si shtojzovalle,  
A si një nimfë me flokë lëshuar,  
Mbi kurm, pa lënë gjurmë, të hedh valle.  
Një shpirt prej zjarri është dashuria  
Që s'zhytet, po shkon lart nga  
lehtësia.

26

"Vështroi aguliçet ku jam shtrirë,  
Lule të brishta, si pendë më ngrajnë,  
Me dy pëllumba ngjitem qiellit të  
dëlirë  
Që nat' e ditë kudo më dëfrejnë.  
E lehtë dashuria, djal' i mirë  
Përse të duket ty kaq e vështirë?"

27

"Mos zemra jote dashuron fytyrën?  
Dor'e djathtë së majtës i merr  
dashurinë?  
Atëherë gënjen veten, shkel detyrën,  
Se vetë e vjedh e vetë e qan lirinë.  
Narcisi që e donte veten shumë<sup>3</sup>  
Të puthte hijen, ra u mbyl në lumë.

<sup>3</sup> Narcisi - sipas legjendës ra në dashuri me hijen e tij dhe u mbyl duke dashur ta puthte atë.

28

"Pishtarin e përdorim për ndriçim,  
Lulet për erë, frytet për të ngrënë,  
Gjellët për shije, nurin për dëfrim;  
Kush rron për vete, tall natyrën nënë:  
Fara pjell farën, nuri bukurinë;  
Siç linde ti, do lindësh brezërinë.

29

"Përse t'ushqen ty toka me prodhime  
Kur ti me pjellë atë nuk e ushqen?  
Ligji i natyrës kërkon riprodhime,  
Të rrojnë ata kur vdekja ty të bren;  
Pra, për inat të vdekjes ti do të  
rrosh,  
Ndër ta, ngjasimin tënd të  
përjetosh."

30

Këtu djersiti mbretëresh' e hazdisur,  
Se dielli pushtoi hijen ku qëndronin,  
Dhe Titani në vapë i harlisur,  
I shihte me sy zjarr tek bisedonin,  
Desh me Adonin vendet të  
këmbenin  
Të shtrihej vetë, si ai, me Afërditën.

31

Tani Adonis me shpirt të rënduar,  
Fytyrë vrenjtur, plot neveri,  
Vetulla ngrysur, sy errësuar,  
Si re të zeza që sjellin stuhi;  
Fytyrë zymtë, tha: "Mos më bezdis!  
Më dogji dielli, dua të lëviz."

32

"Ajme! - tha Afërdita, - i ri zemër gur!  
Sa shkak të dobët gjen të m'ikësh dore!  
Do psherëtitij një frymë me ogur,  
Që të freskoj të nxehtën diellore;  
Do të t'bëj hije me flokë, o zot,  
Dhe po të digjen, i shuaj me lot.

33

"Dielli nga lart, na çon ndriçim të  
nxehtë,  
E ja, vështro, unë rri mes tij dhe teje:  
Se e duroj të nxehtin fare lehtë;  
Por sytë e tu më ndezin brenda meje;  
Mua dy diej më shpojnë në mes,  
I tokës dhe i qiellit, ndaj do vdes!"

34

"Çelik, a kokëfortë, a gur je ti?  
Më fort se gur, se gurin e ha pika;  
A je bir nënë që s'ndjen dashuri,  
Kur të mungon ajo, a s'të merr frika?  
Ta dinte ç'kokë lindi ajo zonjë  
Më mirë të kish vdekur si beronjë.

35

"Ç' jam unë që përçmohem kësisoj?  
Ç' rrezik të madh të sjell me lutjen  
time?  
Ç' dëm do pësojnë buzët që kërkoj?  
Oh, fol e fol drejt me përdëllime!  
Më jep një puthje se ta kthej aty,  
Dhe një kamatë, e po deshe, dy.

Së shpejti do të botohet e plotë nga Onufri

**Abstrakt:** Romani i Ylljet Alicaës *Rrëfenjë me ndërkombehtarë* nën sfondin e periudhës fillestare të tranzicionit të Shqipërisë, tregon jetën e përditshme dhe më konkretisht raportet midis punonjësve ndërkombehtarë dhe atyre vendas në një përfaqësi të huaj në Tiranë. Duke përshkruar këndvështrimin e punonjësve të huaj ndaj vendasve, shkrimtari paraqit strukturimin dhe disiplinimin e vështrimit të Tjetrit ndaj Vetes; ndërkohë, nëpërmjet kundërvështrimit të vendasve ndaj punonjësve të huaj, thyhet logjika e strukturimit të identitetit të Vetes me anë të identifikimit të Tjetrit.

Ngjarja në romanin *Rrëfenjë me ndërkombehtarë* ndodh në Shqipëri në tranzicionin e viteve të 90-të të shekullit të kaluar, ku një përfaqësi ndërkombehtarë, është hapësira kryesore e rrëfimit, dhe karakteret mund të ndahen në dy lloje, vendasit dhe ndërkombehtarët. Në Përfaqësi të gjithë punonjësit ndërkombehtarë, përfshi ambasadorin, vijnë nga Perëndimi i zhvilluar. Vendasit nuk strukturohen në të vetmin imazh krejt të kundërt me ndërkombehtarin, por në disa imazhe, që janë herë kokëulur, të bindur, dhe vazhdimisht dorëzohen dhe ndryshojnë veten për të përmbushur kërkesat e diplomatëve ndërkombehtarë, e herë të tjera janë skeptikë dhe satirikë dhe tregojnë njëfarë ksenofobie të mbështetur nga dinjiteti, krenaria kombëtare dhe nacionalizmi.

Po të shqyrtonim strukturën e romanit, mund ta konsideronim përvojën personale të rritjes së Roshit si linjën kryesore, qysh nga fillimi i punës në Përfaqësi e deri te shkarkimi nga puna. Roshi ka jo pak raste për të këqyrur vendasit dhe ndërkombehtarët, Vetën dhe Tjetrin, kështu që këndvështrimi i tij përkon pjesërisht me këndvështrimin e narratorit në vetën e tretë. Në bazë të teorisë së Vështrimit, ky artikull analizon vështrimin e diplomatëve të huaj ndaj shqiptarëve, reagimin e shqiptarëve përballë vështrimit, si dhe kundërvështrimin e Roshit.

### I. Vështrimi nga diplomatët e huaj

Punonjësit ndërkombehtarë në *Rrëfenjë me ndërkombehtarë* vijnë nga vende të ndryshme, me jetën dhe përvojën e ndryshme në karrierë, mirëpo ata kanë një pikë të përbashkët: që të gjithë vijnë nga kampi kapitalist para Luftës së Ftohtë dhe "Perëndimi", në kuptimin politik, ekonomik dhe kulturor. Vendi i punës së diplomatëve ndodhet në Tiranë, dhe ata krijojnë kontakte me gjithfarë vendasish. Gjatë ndërveprimit të vazhdueshëm, formohet marrëdhënia "vështrimi-kundërvështrimi" midis diplomatëve ndërkombehtarë dhe vendasve.

"Vështrimi" është një koncept i rëndësishëm në teorinë e letërsisë perëndimore, lidhur me shikimin, pushtetin, përfytyrimin, veten dhe tjetrin. Sartri mendon se vështrimi nga tjetri dëshmon se vetvetja fiton vetëdijen e trupit duke iu bërë objekt tjetrit. (Sartri, 1993) Kjo ndërjegje ekziston vetëm për hir të tjetrit. Vetvetja dhe tjetri mund të veçohen për shkak të vështrimit, tjetri e vështron vetveten, ndërkohë vetvetja e vështron tjetrin. Ndryshe nga Sartri, Foucault-i e trajton vështrimin si simbol të pushtetit, i cili është disiplina dhe rimodelimi i subjektit me diskurs ndaj objektit. Prandaj, sa i përket marrëdhënies midis vështrimit dhe kundërvështrimit, të dyja palët me siguri qëndrojnë në pozicionin që tregon asimetrimin e pushtetit. Në këtë mënyrë, vështrimi shndërrohet në një marrëdhënie konkrete, të prekshme dhe simbolike të pushtetit dhe dhunës së butë. Forca shoqërore e organizuar dhe e sistemuar nga shoqëria është një forcë e padukshme që ekziston kudo. (Urry, 2009)

Duke iu referuar vështrimit, Lakani

## Vështrimi dhe kundërvështrimi në romanin "Rrëfenjë me ndërkombehtarë" të shkrimtarit Ylljet Alica - një studim mbi identitetin shqiptar

MA Sai (Bora), Ph.D.,

Pedagoge e gjuhës shqipe në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit, përkthyes e romanit "Rrëfenjë me ndërkombehtarë"



propozon teorinë e famshme, teoria e pasqyrës (ose faza e pasqyrës), i cili është term që bazohet në mbikëqyrjen e veprimeve të fëmijëve midis moshës 6 dhe 18 muajsh, kur fëmija e njeh veten në pasqyrë, duke e konsideruar si imazhin e vetvetes. Mirëpo, ky imazh pasqyre nuk është imazhi i vërtetë i "Uni-t / Vetes", por një "Unë" i krijuar nëpërmjet njohjes për emërtimin e Tjetrit, i cili rrjedhimisht shkakton iluzion dhe tjetërsim. Duke u identifikuar me ndonjë imazh, "Uni" ndryshon në vazhdimësi nën vështrimin e Tjetrit, dhe ka qëllim t'i afrohet atij imazhi. Në këtë qasje, Tjetri e transformon Uni-n.

Në romanin *Rrëfenjë me ndërkombehtarë*, objekti i vështrimit të diplomatëve janë punonjësit vendas dhe e gjithë shoqëria shqiptare. Shkaku i vështrimit të tillë ka qëllim të diferencojë vendasit me vetveten, duke shfaqur qytetërimin, kulturën dhe privilegjin e diplomatëve ndërkombehtarë. Sapo evropianët vënë këmbë në Shqipëri, "ata ndihen shumë më të rëndësishëm aty sesa në atdheun e tyre. Kjo është e shpjegueshme po të pranohet se më parë ata nuk kanë pasur shumë hapësirë ose rast që të shpallnin aftësitë e tyre në dobi të njerëzimit." (Alica, 2009: 24) Nga këndvështrimi i narratorit, është bash kjo prapësi e Shqipërisë që ua ofron diplomatëve rastin për të realizuar dhe konfirmuar vetëvlerësimin. Ndërkohë, duke u përballuar me popullin vendas, diplomatët mbajnë në mënyrë të vazhdueshme të njëjtin qëndrim për asimilimin e shqiptarëve.

Një herë, protagonistin i romanit, Roshi, takon rastësisht diplomatin britanik. Gjatë bisedës mes të dyve, britaniku e pyet Roshin për besimin e tij fetar, duke thënë se shpesh has vështrësi në identifikimin e fesë suaj, domethënë të ju vendasve, pasi kam përshtypjen se, sado që kujtesa juaj fetare është dëmtuar rëndë nga regjimi diktatorial, mbeteni një popull me shpirt dhe zakone orientale. ... Pasi, unë, ne, ndërkombehtarët, kemi veçorinë, d.m.th. nuhatjen, që do të thosha se na dallon ndjeshëm nga ju... më falni, pra nga vendasit... ne kemi aftësinë që t'i pikasim shenjat e prapambetjes aty ku syri juaj nuk i vë re, pasi ju jeni ambientuar me të keqen, kuptohet për shkak të prapambetjes nga regjimi diktatorial. .... Më pas, britaniku, me po atë ton të shpenguar, tregoi se ai dhe kolegët e tij, përveç të tjerash, revoltoheshin

në këtë vend edhe me bunkerët e shumtë, me rrezikun e tërmeteve, me orientimin e çuditshëm fetar, me mungesën e kujdesit për kafshët, pra gati-gati me gjithçka. (Alica, 2009: 41-43)

Ky qëndrim soditës i "perëndimorit" ndaj "orientalit" shfaqet nëpërmjet vështrimit, i cili demonstroi vështrimin orientalist dhe pushtetin e të parit ndaj të fundit. Gjatë kësaj bisede, Roshi nuk arrin të japë shpjegime ose të kundërshtojë, por rri në heshtje si shumica e vendasve, duke u ndodhur në pozitën ku vështrohet dhe gjykohet.

### II. Vazhdimësia e vështrimit në shoqërinë shqiptare

Në veprën *Disiplinë dhe ndëshkim, lindja e burgut*, Foucault-i mendon se vështrimi që simbolizon pushtet vjen nga "burgu panoptik", ku i burgosuri ose i vëzhguari është nën mbikëqyrje dhe kontroll absolut. Rrjedhimisht, shfaqet një gjendje e dukshme me vetëdije dhe vazhdimësi tek i vëzhguari, e cila është për të siguruar funksionimin automatik të pushtetit. (Foucault, 1999: 226) Vëzhguesi arrin të disiplinojë dhe kontrollojë të vëzhguarin, ndërkohë ky i fundit bën vetë-mbikëqyrje nga këndvështrimi i brendësuar nga pushteti, dhe priret të kënaqë dhe kujdeset për vështrimin e Tjetrit. Si rezultat, kur i vëzhguari e vështron vetveten nëpërmjet këndvështrimit të Tjetrit, ai vazhdon këtë vështrim të Tjetrit, dhe me siguri është e pashmangshme të mohojë veten, madje të mund të urrejë veten.

Ndonjëherë, kur punonjësit vendas në Përfaqësi përballen me vështrimin e diplomatëve, disa veprimet e tyre duken anormale, por të arsyeshme në njëfarë mënyre.

Diplomati spanjoll Pablito përpiqet me të gjitha mënyrat që të pengojë aplikimin e vendasve, duke nxjerrë justifikime të shumëllojshme, dhe më pas u shpërndan projekte vendase kompanive të huaja. Mënyra të tilla kaq të tmerrshme nxisin me pahir respektin e nëpunësve, të cilët kur i paraqesin Pablitos dosjet mbi tryezë, s'u mbetet veçse të nënshtrihen plotësisht dhe të mos humbin tjetër rast pa demonstruar servilizmin e tyre, me shpresën se kjo gjë do ta zbusë paksa qëndrimin e rreptë të spanjollit. (Alica, 2009: 54)

Për pasojë shumica e punonjësve vendas provojnë ta arsyetojnë këtë qëndrim; ata jo vetëm identifikohen me vlerësimin e Tjetrit ndaj vetvetes, por edhe vepronë të nënshtruar, duke shpresuar që ta kënaqin atë me profil të ulët, me qëllim që të marrin ndonjë përfitim. Në marrëdhëniet midis ndërkombehtarëve që vështrojnë dhe vendasve që vështrohen, me ose pa dashje, vendasit tregojnë më shumë respekt për Pabliton, gjë që nënkupton se ata janë të pavetëdijshëm se ndodhen nën vëzhgimin dhe disiplinimin e Tjetrit. Meqenëse ndërjegjja subjektive mungon, është e vështirë të thyhet gjendja e tanishme, ose të ndërtohet identiteti objektiv dhe i vërtetë.

Në Përfaqësi ka një punonjëse vendase që ndryshon zërin e saj për të përballuar punë dhe gjendje të ndryshme. Kur ishte para diplomatëve ndërkombehtarë, nëpunësja vendase flet si një fëmijë njomëzak, i jep zërit nuanca nazike duke i zgatur pafundësisht zanoret, gjë që ua përkëdhel sedrën diplomatëve në fjalë. Kur takohet me ambasadorin, nëpunësja sforcohet mundimshëm, teksa qesh me pahir, dhe i merret aq shumë fryma nga ngazëllimi. (Alica, 2009: 45-46)

Ky është përshkrim plot satirë. Të gjitha këto ndryshime të shumëllojshme ndodhin për të forcuar pozicionin e punonjësve në Përfaqësi, për t'i strukturuar vetvetes një imazh perëndimor, për të kënaqur pritjen e ndërkombehtarëve ndaj vendasve, asimilimin e atyre. Në vëzhgimin e diplomatëve, punonjësja shndërrohet gradualisht në Uni-n e shtrembëruar dhe të tjetërsuar, si dhe trajton identitetin e Tjetrit si identitetin e vet. Për t'u bërë Tjetër, ajo e humb subjektivitetin. Më tepër se kaq: qëndrimi i saj arrogant ndaj bashkatdhetarëve është pikërisht i njëjti qëndrim i punonjësve ndërkombehtarë ndaj të gjithë vendasve, i cili është vazhdimësia e vështrimit të Tjetrit ndaj Uni-t.

Në rrëfimin e mëparshëm, autori i romanit e shfaq zbulimin e protagonistit rreth vështrimit dhe vazhdimësisë së vështrimit nëpërmjet zërit të Roshit. Duke zbuluar dhe menduar se punonjësja vendase ndryshon zërin me qëllim që të përfitojë dhe të pranojë asimilimin e ndërkombehtarëve si një qasje që t'i kënaqë ata, Roshi nuk mund të quhet një i vëzhguar i thjeshtë, meqenëse ai zbulon etjen dhe vëzhgimin e Tjetrit, brenda të cilit përfshihen aftësia dhe synimi për të riformuar e disiplinuar Uni-n.

Krahas punonjësve vendas, një tjetër grup vendas përbëhet nga politikanë dhe intelektualë, të cilët janë përgjegjës për të mbrojtur interesat dhe dinjitetin e shtetit dhe të kombatit, për të drejtuar në mënyrë të pavarur strukturimin e identitetit kombëtar, por, në fakt, janë të paafte të mos identifikohen me Tjetrin dhe të luftojnë me njëri-tjetrin.

Zonja K., për shembull, është diplomate e lartë nga Qendra dhe jep këshilla për progresin e reformës së Shqipërisë. Me nga një gotë verë të vjetruar në dorë, fare spontalisht, aintelektualët e pavarur i tregojnë zonjës K. për abuzimet ose veset e iks politikani a force politike, e cila përkon rëndom të jetë partia ku nuk ia del të varet intelektualë i pavarur ose familjarët e tij. ... si zakonisht, në këtë garë spontane triumfojnë ata opinionbërës që e konsiderojnë veten si intelektualë më të pavarur se të tjerët. (Alica, 2009: 124-125)

Kjo gjë që shpjegon pse elita shqiptare lufton të luajë rolin e intelektualit të pavarur me mendësi perëndimore. Zonja K. preferon të vëzhgojë një intelektual të pavarur, prandaj intelektualit mund të vëzhgohet dhe të njihet nga Tjetri vetëm pasi i mëparshmi e rivendos veten në pozicion të duhur. Etja e politikanëve vendas për njohjen nga Tjetri i detyron ata të shfaqin maksimalisht veten në mënyrë joreale. Në

vështrimin e të njëjtit Tjetër, politikanët vendas nuk përpigën t'i thonë "jo" fatit të dominuar, madje ata luftojnë për të fituar sa më shumë vështrim nga Tjetri perëndimor. Kësisoj, ata i japin të drejtën Tjetrit që të transformojë Uni-n dhe të strukturojë identitetin e vet, duke humbur plotësisht mundësinë e njohjes dhe strukturimit të identitetit shqiptar.

### III. Rritja e personazhit kryesor: nga i vëzhguari në kundërvështrim

Foucault-i tregon se strukturimi i shoqërisë disiplinore në panoptizëm kryhet nga Ne, për shkak se ne jemi një pjesë e këtij sistemi. Si pasojë, objekti i vështrimit nuk vendoset krejtësisht nën vështrim, por e pranon dhe identifikohet me rregullat e vështrimit. Vetë vështrimi është një aktivitet pamor, i cili nënkupton që i vëzhguari mund të kundërshtojë vështrimin e Tjetrit nëpërmjet kundërvështrimit, që të dobësojë dhe ndryshojë mbizotërimin e Tjetrit, si dhe të forcojë subjektivitetin e vet. Në vështrim dhe kundërvështrim mes subjektit dhe objektit të vështrimit, subjekti i vështrimit mund të ketë identitetin më real mbi Uni-n. Me zgjimin e ndërgjegjes subjektive të të vëzhguarit dhe pakënaqësinë e tij ndaj ideologjisë së tashme, marrëdhënia vështrim-kundërvështrim pëson ndryshim fshehurazi. Po të vazhdojë rritja e subjektivitetit të të vëzhguarit, atëherë i vëzhguari do të mund të mbajë qëndrim të ri kundërshtues përballë vështrimit të autoritetit, nëpërmjet të cilit formohet një lloj vështrimi kundërshtues, kundërvështrimi.

Si protagonist i romanit, Roshi rritet vazhdimisht në procesin e vështrimit. Me kalimin e kohës, Roshi nis të shohë qartë pamjen e vërtetë të ndërkombëtarëve. Kundërvështrimi i tij thyen gjendjen e kontrollit dhe disiplinën e të vëzhguarit nga vëzhguesi, gjë që frikëson Tjetrin dhe vëzhguesi shënon rritjen e rëndësishme të Roshit.

### Disa përfundime

Lidhur me imazhin e shqiptarit, në një intervistë dhënë Gazetës Mapo, Aliçka u shpreh se "Çdo vend e institucion ndërkombëtar apo popull, kërkon të njihet me fizionominë e një vendi tjetër, në rastin tonë të Shqipërisë, sipas interesave apo shtytave të veta politike, ekonomike, morale e shpirtërore. ... Por ka një diferencë të madhe se si e shohim ne veten, si na shohin të huajt në përgjithësi dhe si jemi realisht, mospërputhje që shpesh bëhet burim keqkuptimesh e zhgënjimesh. ... Fatkeqësisht, ne po e kuptojmë me shumë vonesë se nuk jemi as më të mirë, as më të këqij se popujt e tjerë, se glorifikimi pa kushte i gjithë asaj që vjen nga jashtë dhe nënshtrimi servil ndaj saj nxit përshtirjen dhe të fundos më keq në pozitat e nënshtrimit." (2016)

Mund të shohim qartë se Aliçka shtron një pyetje të ashpër sa u përket marrëdhënieve mes Perëndimit dhe Shqipërisë dhe identitetit shqiptar. Vendasit në romanin *Rrëfenjë me ndërkombëtarë*, që nga kopshtari, punonjësja që ndryshon zërin, kryetari i sindikatës, e deri te politikanët, elita, intelektualët, pavarësisht nga shtresa e tyre shoqërore dhe puna që bëjnë, duket se të gjithë janë të mësuar me arrogancën e Perëndimit dhe përligjin vazhdimisht strukturën e pushtetit me një qëndrim të nënshtruar. Kur Roshi del përpara për të mbrojtur interesat e veta dhe të bashkatdhetarëve, pakënaqësia dhe kundërshtimi i tij ndaj të huajve vlerësohet nga vendasit si veprim i papjekur, i pamatur dhe i pasaktë.

Si pasojë, një tjetër kërkesë shtrohet përpara lexuesve, që në sistemin e diskursit të tanishëm, duke u përballuar me palën e fortë, duhet të mendojnë për qëndrimin dhe mendimin e duhur për strukturimin e identitetit individual dhe kombëtar.

Permbledhje nga revista letrare "Haemus"

## NË ROLIN E KRONIKANES

Nga Ina Kosturi

Nën ndriçimin magjik të ngjyrave që kombinoheshin në pjesën ballore me rrezet që mbulonin dyshemenë e skenës, diku midis lejlase e portokallisë, skena e Universitetit të Arteve krahas akustikës përherë të admirueshme, duke se shkëlqente pas konstruksionit. Sa herë ngjiteshe të interpretoje në të, provoje të njëjtën ndjesi lirie, hapësire, që ofronte padyshim salla më e mirë. Çdo shfaqje ka specifikat e saj, sa të ngjashme dhe njëkohësisht të ndryshme njëra prej tjetrës, ndikuar nga përjetimet, veprat, bashkëpunimet, emocionet, publiku. Më kish pëlqyer gjithmonë ajo ndjesi madhështie që ofronte skena e hapur, segmenti i udhës nga pas kuintave dhe mungesa e asaj perdeje ndarëse që edhe pse të afronte me publikun duke se merrte një pjesë të sipërfaqes së skenës. Për këtë arsye ishin lënë të dukshme podiumet e koncertit simfonik që pritej të realizoheshin pas disa ditësh. Pothuaj gjithë instrumentat e perkusionit gjendeshin në skenë mbi ato podiume, a ndoshta rastësisht shfaqeshin si një dekor i paramenduar që i përshtatej koncertit të asaj mbrëmjeje. Në heshtje dukej sikur trumbetonin diçka të veçantë. Veprat që do interpretoheshin ishin të gjitha të krijuara në kohën që jetonim, ndoshta pak vite më parë, madje disa nga pjesët vinin premiera enkas për koncertin. Zakonisht ai termi "premierë botërore" që përdorej shpesh më dukej si i ekzagjeruar, ndërsa fjala premierë ngjan më e përshtatshme. E veçantë ishte ideja se në disa pjesë pianistja me të cilën interpretoje ish dhe kompozitore, krijuese e veprës. Një raport ndryshe ky krijues-interpretues krahasuar me koncertet e tjera ku instrumentisti është performues, e mundohet ti japë shpirt veprës, brenda kornizës së krijuesit. Këtë herë në skenë luaje dy role dhe këto ndryshonin gjatë koncertit. Fillimisht interpretoje me një pianiste duon e krijuar disa muaj më parë, më pas pianistja tjetër ishte krijuese e veprave. Koncerti ish ndërtuar nga kjo veçanti, ku herë violinisti e herë pianisti shfaqeshin në dy role njëkohësisht, të krijuesit dhe interpretuesit. Ish një traditë e bukur e kohëve të vjetra të mjeshtërive të mëdhenj, ndërsa ideja se në skenë interpreton bashkë me krijuesin e veprës, apo ti vetë je krijuesja të emocionon fort. Gjithsesi janë dy role të vështira për një sërë arsyes, disa të përbotshme e disa shqiptare.

E ftuara speciale ish pianiste, kompozitore dhe midis roleve të skenës luante dhe një rol tjetër të rëndësishëm, atë të themelimit dhe udhëheqjes së "Swiss Female Composer", festivalit dinjitoz që promovon me koncerte, botime, krijimtarinë e femrave kompozitore në Zvicër. Kohë më parë kisha dëgjuar disa herë tingujt e mrekullueshëm të veprave të Katharina Nohl, e sidomos "Rapsodinë për piano" të shpallur fituese të "Global Music Award 2022", apo veprën "By the Baltic Sea" me orkestër, ndërsa videon e pjesës së saj më popullore që interpretohet me instrumenta të ndryshëm e kisha shijuar tekta admiroja tingullin e ëmbël të violinistit dhe artistit të famshëm Aleksey Igudesman në një duo me Katharinën. E prita me padurim ardhjen e saj në Tiranë, si një eksperiencë unike jo vetëm e lojës në skenë me kompozitoren, aq më tepër kur do interpretonim për herë të parë pjesën e saj të saposhkruar për violinë e piano, po gjithë atë atmosferë provash, bisedash që do i pagëzoja me termin "aromë zvicerane". I mbështjellë me një copë me lule, instrumenti i veçantë i quajtur "rainmaker", imitues i shiut, u bë pjesë e veprës së fundit të koncertit, u shndërrua në një instrument komunikimi me publikun madje me një brez fare të vogël që talentin për muzikën dhe skenën e shfaqti rastësisht në koncert. Kjo pjesë e fundit e shkëputur nga vepra e saj "Piano Brodgar" për piano, violinë, rainmaker dhe triangolo improvizoi këtë përfshirje të publikut në skenë.

Bashkë me pianisten kish ardhur pa kuptuar, pa menduar një krijim i ri të cilin e quajta "Sonatë për violinë e piano", një vepër e plotë prej tre kohësh. Dashuria për pianon më kish mbetur nga fëmijëria e largët, që atëherë kur mundohesha të shndërroja një fizarmonikë në një të tillë, ndërsa ndër vite ato tingujt të magjishëm që vinin nga ai instrument bardhë e zi, ishin orkestra e fëmijërisë, e çdo kohe, që i visheshin gjithë veprave dhe të bënin të besojë se muzika e ndërthurur e dy instrumentave është magjike. E nëse dikur pianoja kish veshur me petk unik koncertet më të bukura të repertorit violinistik, nëse dikur çdo vepër apo koncert kish magjinë dhe të bashkëpunimeve, veçantinë e dy duarve, tingujt e të cilave ja ndryshonin rrjedhën, intensitetin, ekspresivitetin, vibraton interpretimit, këtë herë më çuan shumë

larg. Ideja e ardhjes dhe bashkëpunimit me pianisten e kompozitoren zvicerane me emrin Katharina më frymëzoi të shkruaja këtë sonatë për violinë ku parti i pianos fillimisht kish kaq shumë solo, sa ngjante me ato sonatat e vështira të shkruara për piano e violinë! Pianistët frymëzonin të luaje bukur, me Elvinën pianisten shqiptare interpretuam së bashku këtë duo të sapo shkruar. Koncerti filloi me këtë sonatë për të vazhduar me krijimtarinë e Katharina Nohl për piano solo, instrumentit të saj të dashur ku si performer composer në katër pjesët solo shfaqej herë medituese plot ndjeshmëri e herë plot temperament siç ishte "Germanentanz". Shkollimi në vende të ndryshme nga Gjermania në Angli, përvojat në Itali, jeta në Zvicër, kontaktet dhe udhëtimet në shtete të largëta nga Skocia në Afrikën e Jugut, njohja e muzikës së shumë vendeve, frymëzimi nga kulturat e bën muzikën e saj shumë dimensionale, si një muzikë filmi ku shfaqet gjithë kjo lidhje me botën. Premierat dhe interpretimi i muzikës ndërkombëtarisht në koncerte dhe festivale si në Gjermani, Zvicër, Britaninë e Madhe, Rusi, Turqi, Çmimi i vitit 2022 për kompozimin "Spices" një rapsodi për piano dhe orkestër, Premiera e vitit 2023 e "Rave" vepër e porositur për orkestër simfonike, janë disa nga sukseset e saj të fundit. Si themeluese dhe drejtuese e festivalit "Swiss Female Composers" në vitin 2023 botoi vëllimin e parë "Piano Collection" me muzikë nga kompozitorët e sotme femra të Zvicrës në bashkëpunim me "Universal Edition"

Është e rrallë të ndash skenën me të, e rrallë të luash me kompozitoren, e më tepër me një artiste që krijon, interpreton dhe i përkushtohet një kauze të rëndësishme, asaj të krijimtarisë së femrave kompozitore, e shfaqet me organizimin e festivaleve, siç është dhe festivali të cilin e drejton me pasion e përkushtim. Koncerti kish mbështjellë ndjesi, emocione, pjesë por dhe kauza, për të cilat ai timpani aty në fund të skenës në podium dukej se nuk ish dëgjuar asnjëherë. Krijueset femra në muzikën shqiptare ishin e janë të rralla, mund ti numëroje, ndërsa veprat e vëna nga institucionet kombëtare thajse mungonin që në kohë të vjetra. Fakti se prej 23 vitesh Festivali i Hardfordit në Connecticut trumbetonte, përgjigjdhite këtë krijimtari, se në Amerikë realizoheshin disa festivale të tilla në shtete të ndryshme, ndoshta më pak të njohura se Hartfordi, se e njëjta gjë ndodhte në Zvicër, Kanada dhe mjaft vende të tjera tregonte qartë se kudo edhe sot krijimtaria e femrave kompozitore përballet me situata më të vështira, dëshmi e të cilave është historia e muzikës në të shkuarën gjatë gjithë historisë, ku emra talentesh femërore të rralla kanë qënë e janë akoma të panjohura, ndërsa veprat më pak ose aspak të interpretuara. Tingëllon çuditshëm në këtë epokë që jetojmë, në këtë kohë të përparimit, teknologjisë. E nëse në vendet e zhvilluara organizimi i festivaleve, gjithë përpjekjet janë intensive për ta përkrahur, interpretuar këtë muzikë, në Shqipërinë tonë kjo është një kauzë gati e panjohur.

E nëse timpani në podiumet në fund të skenës qëndronte si simbol i kauzave, "rainmaker" një instrument muzikor që imitonte shiun tërhoqi vëmendjen e publikut. Rainmaker, triangolo, violina dhe piano mbyllën koncertin me dy pjesëmarrës nga publiku në skenë, për të dhënë në fund të eventit mesazhin e madh se muzika është për publikun, se raporti i publikut me artistin është një marrëdhënie dashurie, se rrugët për të shkuar drejt tij e për të edukuar me muzikë janë të shumta. Katharina dhe instrumenti interesant imitues i shiut udhëtuan drejt Zvicrës, për të vazhduar itinerarin e koncerteve në shtete të tjera duke lënë "aromë zvicerane" në sallën e Universitetit të Arteve.



**Vepra letrare e Ridvan Dibrës** është krijuar dhe botuar pas vitit 1990, ku ai na sjellë forma dhe mjete të reja të shprehjes artistike, të cilat sipas kritikës letrare, elementet që e përbëjnë në tërësi veprën i përkasin postmodernizmit. Është ndër shkrimtarët më prodhimtarë i cili e ka pasuruar letërsinë shqipe, jo vetëm në aspektin sasior (pasi tashmë numëron një sërë veprash, ku llojet që ka lëvruar janë romani, tregimi, eseistika, drama, poema, poezia), por edhe në aspektin ideotematik, formal, ku përmes kësaj të fundit ka bërë dallimin nga autorë të tjerë bashkohës, duke u vlerësuar kështu edhe me disa çmime si brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**Shprehja gjuhësore-artistike** e bën karakteristike veprën e tij. Kemi një prirje për thyerje sintaksore, fjalitë janë shpesh telegrafike, konçize, gjejmë dendur fjali njëkryegjymtyrëshe **emërore** (*Amanete gjysmash, Klithmë e pambarimtë, Shekulli me profil gjysme, Një gjumë i rëndë si vdekja etj.*) dhe **foljore** (*Ëndrrën për t'u bërë i tillë, Siç më kanë thënë, I puthin gratë e tyre etj.*), **fraza** që përsëriten, kjo me qëllim për të rimbajtur ndezur kujtesën e lexuesit mbi ngjarjet e mëparshme të rrëfyera. Gjuha e prozës, shpesh, duket se vjen në shkrimje me atë të prozës poetike, kjo përmes figuracionit letrar që përdor p.sh. "Hëna është e plotë dhe gjaku mbi gjoksën e atit duket si argjend i shkrirë". (Legjenda e Vetmisë)

Gjuha rrjedhë me një thjeshtësi duke e bërë tekstin të ngrihet në nivelin e të bukurës estetike, ku lexuesi e lexon atë me një frymë.

**Personazhet** e Dibrës janë të paktë në numër. Në tërësi ky personazh që shpesh bëhet një me autorin, përfaqëson botën e individit si qenie shpirtërore me ndjenjat, dyshimet, mendimet, paradokset dhe komplekset e veta, i cili si pjesëtar i

## PËR PROFESOR RIDVAN DIBRËN

Nga Klevisa Bardeli

një shoqërie shpesh ndihet i pafuqishëm duke u përballur me një ndjenjë izolimi, nga realiteti që e rrethon, e nga kjo duket se lind më pas reflektimi e filozofimi mbi botën. Me të drejtë shprehet Ag Apolloni se "Dibra i përmbahet parimit të ajsbergut, në sipërfaqe nxjerrë pak, por leximi i vertikales semantike mundëson të shihet edhe pjesa nënujore, që është e madhe dhe frikësuese". Në vepra na del edhe figura e Tjetrit, si **tjetërsim i personazhit** në vetvete apo i dyzimit të tij kundrejt asaj çfarë e rrethon, por edhe si **prania e dikujt tjetër** përballë nesh pa të cilin ekzistenca është e pamundur. Dibra na i sjellë personazhet ndryshe nga autorët e huaj, qoftë klasikë apo modern, kryesisht atë të gruas. Ku kjo Grua, pikëmbërritjen duket se e ka te vepra "Gruaja që deshe". Thjeshtësia, e Bukura e Mira, veshin kryepersonazhin Grua, duke na lënë një shije estetike të bukur në sytë e ndjeshmërinë e lexuesit. Siç shprehet edhe autori "Virtyti qëndron tek normaliteti dhe jo tek ekstremet". **Mininarracionet**, ngjarjet e vogla, përkundrejt ngjarjeve të mëdha, janë pjesë e stilit të Dibrës. Në dukje aq të thjeshta, këto vepra godasin në skutat e fshehta të qenies, duke nxjerrë në sipërfaqe shqetësimet e brendshme që e mendojnë njeriun, ndryshe nga autorët modernë që siç thotë Dibra shkruajnë në zgrip të ekzistencës së tyre, duke shmangur qenien normale. Sepse ndonëse nuk ka


beteja, karaktere të kundërta, intriga (që zgjojnë interes te lexuesi) beteja më e madhe ndodhet brenda vetes. Vetë qenia që sulmon vetveten dhe mbrohet prej vetvetes. Në rrekje për t'i ruajtur normalitetet. E ashpër kjo beteje, sipas teje, sidomos te gratë. Edhe e bukur. Ngjarje e denjë për një vepër letrare...

Tek veprat e Dibrës dallojmë **shkrimjen mes gjinive letrare**, konkretisht nëse ndalemi te romani "Stina e ujkut", gjejmë të gërshetuar **tekstin rrëfyës** (fragmentet jepen në trajtën e tregimit), **tekstin poetik** (figuracioni letrar në nivel poetik), **tekstin eseistik** (përmes reflektimeve filozofike të personazhit), **tekstin dramatik** (dialogu mes Njeriut dhe Ujkut, si dhe monologu). Veprat e Dibrës shpesh përbajnë referenca ndaj teksteve të tjera, qoftë ato të letërsisë shqiptare apo ato ndërkombëtare. Ai përdor **intertekstualitetin** për të krijuar një lidhje mes kohëve të ndryshme por edhe kulturave, ku çdo tekst është pjesë e një rrjeti më të gjërë referencash tekstuale dhe ndikimesh. E tillë është p.sh vepra "Franc Kafka i shkruan të birit" ku ai mbështet tek **modeli i letrës** që Franc Kafka i shkruan të atit, duke vënë në dukje problematikën e përditshme që ekzistojnë mes brezave. **Ironia intertekstuale** është një element që autori e përdor për të goditur kontradiktat shoqërore dhe ideologjitë e rrënjosura. Ai merr

elemente tradicionale, si p.sh: mitet apo personazhet historike të cilat i çmitizon duke i bërë personazhet të jenë aktuale në një botë moderne. **Çmitizimi i mitit** me realitetin, i lashtësisë me aktualitetin është një tjetër veçori e prozës. Këtë e gjejmë p.sh: te vepra "Triumfi i Gjergj Elez Alisë" ku tashmë nuk kemi më heroin popullor por një njeri të ditëve të sotme, që mbart në vetvete plagë të pashërueshme shpirtërore. Një veçori tjetër e rrëfimeve artistike të Dibrës është **ndërthurja e trillit letrar me elementet autobiografike**. Rrëfimi në vetën e parë, detajet nga jeta biografike e autorit, aq sa e bëjnë interesante veprën, ku autori eksperimenton me mënyrat e të rrëfyerit, aq edhe e bëjnë sfiduese atë në qasje me lexuesin, pasi përvoja artistike në shumicën e kohës shkrihet me atë jetësore. Këtu mund të përmendim kryesisht romanin "Gjumi mbi borë". Ajo çfarë vëmë re te vepra e Dibrës është se Narratori pasi bën rrëfimin i lë vendin Autorit për të komentuar metafiksionin e veprës së tij. Ai komenton **fragmentaritetin** e tekstit, i cili ndërtohet sipas **teknikës së kolazhit**. "E di se ky rrëfim ka dalë i thyer, copa-copa. Si një pasqyrë e madhe hedhur nga një lartësi drejt e në tokën e ashpër. Ashtu siç e di se kjo pasqyrë, me gjithë mundin e rrekjet e mia, përveçse e thyer, është edhe e paplotë". (Gjumi mbi borë)

Me anë të artit të tij Dibra duket se na fton të largohemi nga realiteti i rëndomtë, format e robërimit, dogmat e mykura, e kjo arrihet përmes artit të fjalës dhe materies së saj, gjuhës. "Kishte zbuluar befasisht misterin e artit, por edhe të jetës. Pa korniza. Në djall kornizat dhe mesazhet. Ishte artist dhe asgjë më shumë". (Prostituta e Virgjër)

Shkodër, 2024



# SHPIRTI LIRIK I NJË POETESHE

Nga Agim Vinca

Pas librit të saj të parë, *Do vij me hijen e erës* (2020), Ajne Ibërhysaj del para lexuesve me vëllimin e saj të dytë poetik *Gravurë me ngjyrat e kohës*. Sikurse edhe në librin e parë, edhe këtu Anja vazhdon të shpalosë në vargje botën e saj intime, dashurinë për jetën dhe dhimbjen për humbjen e njerëzve të saj të dashur, pa lënë mbas dore as përkushtimin për atdheun.

Poezia e Ajne Ibërhysajt nuk është poezi e mjeshtërisë a zanatit, por e ndjesisë dhe përjetimit të çastit. Fjalë kyçe e poezisë së saj është fjala shpirt, ndërsa togfjalëshat: “dridhjet e shpirtit”, “britmë shpirti”, “psherëtimë shpirti” e të tjerë të ngjashëm, shfaqen shpesh në vargje edhe si tituj vjershesh, që, herë-herë, ngjajnë si variacione të njëra-tjetrës.

E tërë poezia e Ajnes është një vërshim ndjenjash, mbresash, kujtimesh, të cilat poetja i shpreh natyrshëm, ashtu si i vijnë. Po qe se bëjmë një krahasim me fenomenet e natyrës, do të thoshim se rrëfimi poetik rrjedh lirshëm, ashtu siç ndërrohen stinët e motit, siç bien gjethet në vjeshtë dhe siç rrjedhin ujërat e lumenjve. Edhe pikat e shiut që lëshojnë retë dhe lotët që rrjedhin nga sytë janë pjesë e kësaj “gravure”.

(Të themi në parantezë se titulli i librit: *Gravurë me ngjyrat e kohës* i përgjigjet përmbajtjes së veprës: frymës së përgjithshme dhe në mënyrë të veçantë përbërësve të saj ideotematikë dhe gjuhësorë-stilistikë).

Ndoshta bukuria e kësaj poezie qëndron pikërisht këtu, te kjo natyrshmëri, që është shprehje e botës së pasur shpirtërore të poetes dhe e përvojës së saj jetësore. Në harmoni me këtë përcaktim është edhe fjalori i kësaj poezie, si dhe motivet e saj, që, edhe kur duket se largohen në mitologji (Troja, Prometeu, Sizifi, Itaka), i qëndrojnë besnikë kohës dhe mjedisit që i ka lindur.

Edhe kur ndeshet me ftohtësinë e rrethit, poetesha jonë përpiqet ta zbusë atë me ngrohtësinë e ndjenjës, të tingujve e ngjyrave, që nuk e lënë indiferent për asnjë çast lexuesin. Duke i lejuar vetes ta mbyllim këtë të shkurtër në mënyrë pak a shumë të figurshme, metaforike, do të thoshim se lirika e Ajne Ibërhysajt ka shpirt dhe kolorit: ajo i ngjan një kopshti shumëngjyrësh, ku secili gjen diçka pas shijes së vet.

Prishtinë, 25 qershor 2024

## AJNE IBËRHYSAJ

### Gravurë me ngjyrat e kohës



Onufri



## DOLI NGA SHTYPI LIBRI I AKADEMIK VASIL S. TOLE “DHORA LEKA, KOMPOZITORJA E PARË”

Dhora Leka është kompozitorja e parë në hapësirën mbarëshqiptare, e në një lloj kuptimi kompozitore që e bëri historia. Në mënyrë të veçantë, këngët e krijuara prej saj, gjatë viteve të pushtimit fashist e nazist, konsiderohen si një kulminacion i krijimtarisë së saj e po ashtu etapa e fundit e repertorit muzikor patriotik shqiptar, ku përfshihen këngët për liri dhe pavarësi (1878 – 1912), ato të luftërave çlirimtare si të Vlorës më 1920-n dhe, më së fundi, këngët e Luftës Antifashiste (1939 – 1944).

Këto “këngët të luftës për liri”, si vazhdim i muzikës sonë patriotike, mbajnë në notat dhe pentagramet e tyre frymën liridashëse të shqiptarëve dhe aspiratat legjitime për të qenë si të gjitha kombet e tjera të Europës. Këngët e kësaj periudhe (dhe vetë Dhora si Këngëtare e zjarrtë e Luftës për Liri), çmohen dhe janë tashmë një nga format unikalë të trashëgimisë sonë artistike, bartëse të këtij shpirti të lirë shqiptar, të denja për të qenë në fondin më të mirë të kësaj muzike në nivel ndërkombëtar.

Krijimtaria e Dhora Lekës nuk kufizohet vetëm te këngët, pasi ajo, pas përfundimit të studimeve në Konservatorin “Çajkovski” në Moskë, në vitet 1948 – 1953, u perfeksionua muzikalisht dhe u shumua në lloje. Vepra të tjera muzikore, vokale dhe instrumentale ajo shkroi pas viteve 1990, edhe pse jo të shumta. Por asgjë nuk është e ngjashme me atë periudhë krijuese, kur kompozitorja e parë e muzikës shqiptare nuk e dinte që arma e saj e vërtetë në luftën për çlirim nuk ishte pushka, por kënga.

Dhora Leka do të mbetet në muzikën e gjysmës së parë të shek. XX si kompozitorja më e njohur e këngëve patriotike, që me fuqinë e artit të saj do të pohonte vlerat që mbart lufta e drejtë e një populli për liri dhe dinjitet. Për këtë arsye, në 100-vjetorin e lindjes së kompozitores dhe në prag të 80-vjetorit të çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë, po i përcjellim ato përmes këtij botimi në nderim dhe vlerësim të kësaj trashëgimie muzikore unikalë.

Me Dhora Lekën dhe krijimtarinë e saj në fushën e muzikës, posaçërisht atë të këngës, ka ndodhur diçka e pangjashme në krejt historinë e muzikës botërore: këngët dhe meloditë e kompozuar prej saj këndoheshin tej e mbanë Shqipërisë e më gjerë, ndërsa autorja e tyre, për gati 40 vjet, gjatë diktaturës komuniste nuk u përmend fare, thuhet nuk ekzistonte. Me sa duket, ky fat i trishtë i jetës së saj njerëzore, për fat të mirë nuk ndikoi në përhapjen dhe transmetimin e muzikës së saj në popull, muzikë e cila, në fakt, mbart shpirtin e vërtetë të Dhora Lekës. Ndoshta për këtë arsye, ende sot, kjo muzikë patetike dhe patriotike, e mbështetur në traditën më të mirë të muzikës kombëtare dhe asaj botërore, e krijuar prej idealizmit të saj dhe të rinisë shqiptare të atyre viteve, bash mu në zemër të popullit, rreth vatrës familjare dhe majave të maleve, mes shiut, borës dhe ngricave, do të mbetet një rast i jashtëzakonshëm i trashëgimisë sonë shpirtërore në fushën e këngës, për rrethanat si u krijua dhe rolin e jashtëzakonshëm që luajti.

Ende është e pashpjegueshme se si Dhora Leka, një partizane e re, pa përvojë muzikore krijuese dhe profesionale, në vitet 1942 – 1944 ia doli të krijojë, përmes këngëve antifashiste, jo vetëm pjesën më të ndritur të krijimtarisë së saj muzikore, por njëkohësisht, të ndikonte me peshën e kësaj krijimtari në popull, duke përndezur dhe frymëzuar përsëri (ashtu si dikur këngët patriotike të Rilindjes Kombëtare), ndjenjat e një populli të tërë për liri, gjatë Luftës II Botërore.

Këngët e saj, që në çastin që u krijuan, u bënë shumë shpejt zëdhënese të frymës së rilindjes dhe aksionit popullor ndaj pushtuesve fashistë e nazistë. Në këtë vështrim, muzika e Dhora Lekës është vazhdimi i natyrshëm i muzikës dhe i këngëve patriotike shqiptare të Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë, të cilat formësuan në muzikë jo vetëm reagimin popullor për liri dhe pavarësi, por kulmuan duke krijuar njërin prej simboleve tona kombëtare, Himnin Kombëtar, me njërin prej atyre krijimeve, pikërisht me këngën Rreth flamurit të përbashkuar.

Ajo vetë besonte se ishte vetëm një përcjellëse në melodi e asaj fryme popullore për liri, pasi këngët, në një lloj kuptimi, gati-gati u krijuan vetë, por ama ajo diti t’i “lindte” ato siç duhej. Në këtë kuptim, këngët e Dhora Lekës janë fëmijët e saj. Jeta e privoi që të kishte familje dhe fëmijë, por a nuk janë krijimet e saj edhe një arsye më shumë për të kuptuar dashurinë dhe vlerat artistike që ajo mbartte?

Para disa verash, po kalonim me një anije të vogël turistike mes ishujsh shkamborë dhe ujëna të kaltra e bashi i anijes përplasej dhunshëm me kreshta valësh të dukshme e të padukshme. Nodheshim me pushime diku në Greqinë e njelmët prej pranisë së krypës në ujë dhe prej salsedines në ajër. Motoskafite vrullshëm dhe piklat e valëve që thyeshin me goditje tek trupi ballor i motoskafit na i lagnin sytë dhe me gjuhë shijonim mbi buzë krypën e sapondame prej morisë së pamasë të deteve të botës.

Ma në fund mbërritëm përballë një plazhi të madh plot me njerëz dhe anija jonë e vogël u ndaloi. Ai plazh nuk kishte mol ku të lidheshin anijet, pra mjetet lundruese hidhnin spirancat disa dhjeta metër larg bregut. Na thanë se kush kishte dëshirë me shkue te plazhi, duhet të hidhej me not deri te bregu. Madje dhe na u caktue edhe një orë se kur duhet të ishim përsëri në bordon e atij motoskafit.

Unë e ti vendosëm me ndejtë në motoskaf dhe me pritë orën, sepse dukshëm ishim të interesuem me pa vende, peizazhe, gjij deti, shkambij dhe, mundësisht, ndonji specimen të rrallë prej faunës së detit.

Një numër turistësh si na, por kryesisht të rij, u hodhën pa një, pa dy në ujë dhe ngadalë notuen drejt bregut. Drejtuesi i atij motoskafit e zhvendosi barkën e tij pak majtas, në drejtim të një shkambi që binte thik mbi det. Shkambi ishte relativisht i naltë dhe në majë të tij kishte disa pemë të holla që era e të gjitha stinëve i mundonte tue i përkulë dhe kamxhikosë me furinë e saj të papushueshme, por ma pak ose ma shumë të vrullshme, simbas stinëve. Dielli i mesditës ishte nisë me hy mbas shkambit e mbi ne me lëshue hijen, këtë dhoratë po aq të çmueshme sa drita dhe nxehtësia e tij.

Unë e ti po rrinim pa folë dhe të takuem sup me sup. Herë mbas here sillja ose sillje kryet kah unë, shikimet tona kryqëzoheshin dhe ftyrat tona tendoseshin si para fillimit të një buqëqeshje. Mandej na drejtonin krenat dhe shifnim si zgjatej hija e shkambit mbi det, si murrtohej deti në pjesën e goditun prej hijes dhe si ajo ngadalë apo tinëzisht na afrohej, si me dashtë me na përpi bashkë me motoskaf.

I zanë prej hijes, u jii detit dukej i thellë, madje shumë i thellë deri në i pafund. Asgja nuk shndriste në fundin e tij, as rana, as ndonji shpinë peshku që feks papritmas kur merr një kthesë të beftë.

Mbas mpimjes që sjell pritja dhe tultatjes që sjell flladi detar e mija e mija feksje lëbrëse të detit kur bahet pasqyrë e diellit, na nuk e kishim kuptue se hija e shkambit na kishte pështjellë me gjithë motoskaf e se na kishim në atë plazh një çadër të gurtë që na mbronte prej diellit e rrezeve të tij mbasditore.

Atëherë para nesh u shfaq e plotë dhe e kjartë faqja e shkambit dhe në atë tundulatjen e lehtë të valëve të gjiut, na u duk se po i afrohem shumë ngadalë atij shkambi që tashti na rrinte mbi krye.

Në pjesën që na kishim përballë, shkambi u shfaq si një masë e gurtë e përbame prej shtresash të dukshme materiali të fortë, por me ngjyra lehtësisht të ndryshme. Masa e gurtë (dhe sot e ngurtë) e atij shkambi sajonte pala e palosje të çuditshme, të cilat mendes m'i thonin se ajo masë guri duhet të kishte qenë e langët ose lang i trashë, kur ishin sajue ato pala, ato pala të trasha e të randa që dikur kishin qenë lavë e langët dhe e lëvizshme, shty së poshtmi prej forcash vigane sa me çue drejt qiellit Gjalicën e Lumës, Korabin tonë oe edhe Himalajat. Pak sipër mesit të naltësisë së shkambit, një palë guri, e palosun bukur e me rumbullakësi të gjanë kishte pothuajse ngjyrën e lëkurës njerëzore. Një lëkurë e re, ngjyrë buzë që mbështillej ambël rreth vetes dhe ngjitej sipër të poshtmes tue krijue një gropë të lehtë dhe prap aty palosej dhe fillonte rreshtin e tretë.

Më mbetën sytë tek pala e gjanë dhe e

## PRIMO SHLLAKU

### Se si vizita në një ishull të Jonit më mësoi me e pa trupin e zhveshun të një grueje...

#### Fragment

ambël, ku guri ngjyrë buzë sajonte gati-gati një gjymtyrë njerëzore që paloset mbi tjetrën, kur këto të fundit bajnë pushim...

\*\*\*

Atë natë erdhëm vonë në hotel. Unë kisha gjumë dhe ti hyne me ba një dush. Ndigoja prej aty ku isha shtri, zhurmën e ujit që binte mbi lëkurën tande dhe krismën e tij kur binte për tokë.

Kur u fik drita e banjoes, e kuptova se po vije edhe ti me u shtri. Ishte goxha terr në dhomë dhe nuk të shifja mirë. Vendosa me përdorë shqisën e të prekunit me kompensue atë që s'e merrja me sy. Supi yt ishte i lagët e, me siguri, me pikla uji të rralla mbi të.

- Pse nuk u fshive? - të thashë.

- A më pate thanë se uji mbi lëkurën e njeriut asht gati monument?


U kujtova se, po, ashtu të kisha thanë dhe lëvizja prej vendit, u solla krejt kah ti e të qëndrova kundruell. Njëpër gjysmerrësinën e dhomës m'u duk se e deshifrova disi formën e trupit tand që më rrinte pranë. Dallova ijen

tande të ngritun dhe kthesën që merrte mishi yt për me u ba kofshë. Aty qenia jote krijonte një palosje, një palosje të gjallë e të lëvizshme. Të lëvizshme, sepse qenia jote nuk e ofronte ashtu atë pjesë gjatë gjithë kohës. Ti duhet të ishe ashtu, e lagët, gati si një monument, mbi siprinën e tendosun të një çarçafi borë, përndryshe palosja e jote tek ija që merrte një kthesë në teposhte dhe bahej masë e kofshës tande e që mandej shkonte s'di se ku, si do të ma ndezte mendjen mue?...

\*\*\*

Ora po kalonte dhe na të dy po rrinim në motoskaf dhe po e shifnim me ngulm atë faqe shkambi. Ti më këqyre disa herë dhe po mundohesh me marrë vesh se pse isha kaq i ngulitun mbi atë faqe shkambi. E kuptova se të duhej një mendim i imi dhe të thashë:

- A je tue e pa atë palën e gurtë si kthehet dhe imiton diçka që unë shpesh e kam pa tek ti. Por jo kaq gjatë, sepse ti lëviz, ndërton formë dhe ma shkëput fillin e mendimit. Kurse kjo këtu...



PRIMO  
SHLLAKU

Nata e qejve

Onufri Tregime

- Kjo, - u hodhe ti me atë hovin e ngutun, kur kujton se ke zbulue diçka dhe po më tejkalon, - kjo pala këtu sa për fillim më duket se ka ngjyrë mishi të njomë, asi mishi që gjindet vetëm në zonat e rreptësisë së trupit njerëzor...

- Ku e din ti? - të thashë me za të ulët, - ti nuk e shef veten...

- E shof, si nuk e shifkam? - protestove me buzën në gaz.

- Për ty kanë randësi vetëm flokët e dhambët...

Për çudi edhe ti më dukej se po përqendrohesh mbi atë pamje që po po kundroja me aq vemendje edhe unë. Çove gishtin dhe shoqnove me një lakore diçka mbi faqen e shkambit. Më the:

- Që të paloset kështu ky gur që, mesa shof prej këtu, nuk ka as plasa e as thyemje, ajo landë duhet të ketë qenë e butë si...

- Si ti, - ta prita unë.

- Dhe e nxehtë, - mbaj mend se the dhe e ule zanin.

- Po edhe ti e nxehtë je, - të thashë po me za të ulët.

\*\*\*

Drita makinash e qëndisnin herë mbas here tavanin e dhomës tonë me trekandësha e trapeza të lëvizshëm që përshkonin tavanin, ndaleshin një hop e mandej zvogëloheshin papritmas dhe zhdukeshin në një cep sikur t'i kishte përpi korniza prej allçie e tavanit.

Kjo dritë e pakët nuk ishte edhe aq e pakët. Më dukej se ajo dritë e përthymë makinash te tavanin i bardhë i shtohet mjaftueshëm dritës që lëshonte trupi yt plot lakore dhe i nxehtë sa ti me ndejtë ashtu "vetëm në lëkurë". Dhe unë shifja, ashtu siç shofim njikohësisht në ekranin e kompiuterit dy foto ose dy tekste të ndryshme përbri njëri tjetrit për një "studim ma preciz", kishte me thanë Migjeni.

Shkambi i ishullit jonian ma kishte shtue kureshtjen për trupin tand, me të cilin ndoshta edhe isha mësue prej vitesh ku na kishim bashkënda çdo rrethanë jete.

Një makinë, diku, lëshoi dritat e saj mbi tavanin e dhomës ku na rrinim të shtrimë përballë njëri tjetrit. Trupi yt u ndez. Ai po vizatohej para syve të mi me një shpejtësi të hatashme. Unë e kisha të vështirë me dallue nëse ajo gjysmëdritë ikanake që ma kronometronte kohën dhe më kërcënonte me terr, ishte drita që buronte prej mishit tand, apo nëse, tue ardhë prej jashtë, ajo mund të ma ndërpriste seancën time të studimit në një orë normale gjumi.

Ija jote ishte një teposhte thejqa fëse. Lëshohej poshtë dhe binte në lugun e vithes tande të ndritun që ma frenonte me rropamë shikimin tim që prehej një çast aty, në atë lug të njomë e të butë prej kah shikimi im mund të rrezohej në të dyja anët vetëm në një det mishi të bardhë me forma të buta e lëmim lakoresh si ndonji peizazh me ranë shkretine, punue prej erënash në zhvillim.

- Ah, - thashë.

- Ça ke? - më pyete.

- Nuk mundem me të prekë, - thashë e dorën e ndjeva të pafuqishme me u zgjatë drejt teje.

- Më ke shumë afër, - më the.

- Nuk ban me të prekë... - rënkova unë.

Ti bane një lëvizje nevrrike dhe lëvizje. Trupi t'u shtri dhe lakoret u drejtuen.

- Të lutem... - fola unë me za të pakët.

Më pe drejt e në sy. Syni yt kishte zjarr pyetës.

- Të lutem rri edhe një herë ashtu si ishe. Rregullou ashtu sikurse ishe para pak.

- Më rregullo ti, - fole dhe u solle në shpinë tue vue parakrahun mbi ballë.

- Jo, - fola unë që kisha humbë njezin imazh prej të dnye, me të cilët po merrej mendja ime në atë lojë dritash dhe shpërndërrimesh të trupit tand.

- Pse? - protestove ti.

Është shndërruar gati në prirje, Ëvitet e fundit, që figura të njohura të medias të shpalosen dhe të promovohen, jo pa sukses, edhe në disiplina të tjera, duke filluar nga botimet historike, letërsi artistike dhe përkthim letrar, studime, kritikë, show, fotografi, e deri te librat e kuzhinës. Falë familjarizimit të tyre me publikun, këto vepra nuk kalojnë pa u vënë re, madje në disa raste kanë qenë sensacione në treg.

Kjo lloj alter-ego, më shumë se nevojë për audiencë, vjen si thirrje e brendshme për të përmbushur atë pjesë të personalitetit që ua kufizon puna në media, që gjithsesi mbetet ajo e një ndërmjetësi, që është hapësira subjektive. I tillë vjen edhe ky libër i shkruar nga Alfred Lela, gazetar me një personalitet të spikatur për stilin e tij, racional, të shtruar dhe ironik. Prandaj pritet që ky libër të ngjall shumë kërshtëri, siç ngjall kërshtëri edhe fakti që ai zgjedh të komunikojë intimisht me lexuesin, përmes poezisë, veçanërisht në një kohë kur poezia, siç shprehet autori në një nga vargjet e këtij libri, është si “ajo pela gërdallë/ për të cilën askush nuk vë më bast”.

Libri shtrihet në një hark të gjatë kohor, me poezi të shkruara që nga vitet studentore e deri në ditët e sotme dhe si i tillë, reflekton në një farë mënyre historinë e tij personale, e zbrëthyer si udhëtim në vende dhe kohë. Por duke qenë të preservuara në përjetimin e tyre origjinal, ato ndihmojnë më së shumti për të kuptuar atë rrugëtim të brendshëm të individit në raport me elementet që krijojnë identitetin e tij, si: vendlindja, historia, dashuria, familja, natyra, politika, arti, dhe jeta në përgjithësi.

Libri e merr titullin nga poezia “Solo”, duket një autoportret, apo një lloj “shfajësimi” para vetvetes për brishtësinë e tij si karakter, për pamundësinë e përshtatjes në një botë që lufton për “lirinë për t’u çmendur”. Kjo poezi shërben si një postludë, një konstatim në procesin e njohjes së vetvetes, pas një përvoje të gjatë dhe të shumëllojshme, që vjen e strukturuar në kapituj: *Jam i prerë hollë. Si brisk rroje që kërcënon qafën e një burri kur rruhet për herë të parë.* Dhe kjo, natyrisht, shpjegon shumë gjëra, që në poezi shfaqen si shkak dhe pasojë.

Në kapitullin e parë, që mund të quhet i dashurisë, ne si lexues e kemi të vështirë të krijojmë një ide konkrete mbi episode, skena apo karaktere, sepse, pavarësisht detajeve, ata ngjajnë si të mbivendosur mbi njëri-tjetrin, sikur kemi të bëjmë me një dashuri të vetme që i përgjithëson të gjitha. Duket se kjo është një zgjidhje e qëllimshme stilistike e autorit, e cila shoqërohet edhe nga ironia dhe vetë-ironia, dhe vendoset mbi një shtrat mitologjik. Në poezinë “Sa të gjitha netët” shkruhet: *Më mungon*

Mbi vëllimin poetik “Solo” të Alfred Lelës

## NJË LIBËR QË NGJALL KËRSHTËRI TE LEXUESI

Nga Luljeta Lleshanaku

*si një brinjë/ Dhe pyes veten: e humba kur dilja në mal si Abrahama, apo u linda pa të?* Përmes një narracioni të tillë, autori e zhvesh rrëfimin nga sentimentalizmi, duke krijuar një lloj demistifikimi. Dhe kur ky element përsëritet vazhdimisht nga njëra poezi te tjetra semantika përforcohet, duke lënë të nënkuptohet që vetë dashuria mund të shndërrohet në një klishe pas një farë kohe: *Është brinja ime, e rënë në ijën e një burri tjetër, si një sondë në Mars, apo: Çfarë është dashuria./ Veçse një grua që di të jetë/ E dashura, bija dhe gruaja.* Ky përjetim, analitik më tepër se emocional, bën që poezitë e tij të tingëllojnë disi të ftohta, hera-herës dhe cerebrale, duke i mëshuar më tepër kontekstit se sa vetë ngjarjes.

Cikli “Poezi të Amerikës” është ndoshta më interesante në libër. E veçanta e këtij cikli, si edhe e poezive të tjera që janë shkruar jashtë Shqipërisë, është se nuk shprehin atë kureshtje apo habi eksploruese të vendeve të panjohura më parë, siç e hasim zakonisht në poezinë e këtij lloji, por vetëm një pikë-vështrimi, distancë fizike dhe emocionale të domosdoshme për të reflektuar mbi atë që bartim, mbi atë që jemi dhe mbi realitetin shqiptar që lëmë pas,

përsiatje që përcillen më tepër me nota satirike se sa nostalgjike: *Ç’bën e dashura dhe qyteti./kur pa drita krahu lindor viziton krahu jugor të pa ujë,/dhe Kryeministri pi hënën në një gotë qeveritare?* Në poezinë “Ditë Falënderimesh”, që mendoj se është një nga më të bukurat e librit, autori përmes detajesh arrin të krijojë gjendjen e vetmisë fizike dhe kulturore të emigrantit në një vend të huaj, përmes vargjes të tilla: *Zezakja që troket në portë në orën gjashtë/Hapja nervoze e grilës,/ Ditë Falënderimesh/Vanden Plas, ujk i vetmuar që fle jashtë.* Por edhe këtu poezia zhvillohet si një lloj “inventari” i asaj që mbartim dhe përfaqësojmë si popull, të “Homo Albanicus”, që na kujton formulën tonë të mbijetesës me pak bukë, një kandil, një copë qiell, dhe ca libra (“Ich bin ein albaner!”).

Pavarësisht vendndodhjes, objekti mbartet brenda autorit, dhe kjo është vendlindja dhe çdo gjë tjetër që e lidh me të.


Poezitë e këtij libri dallohen për erudicionin e tyre, me një leksik të gjerë letrar, historik, politik, e deri teknologjik, që dëshmon jo vetëm një kulturë të gjithanshme, por edhe inteligjencën për t’u orientuar dhe abstraguat mbi këtë informacion.



Në poezinë “Nënshttrimi” autori shprehet: *Kështu shkojmë, varavingo, viadolorozës teknologjike, subjekte të një perandorie të paanë, ku Cezarin, Ajzenhauerin dhe De Golin, i kanë zëvendësuar burra të zbehtë, burragra.*

Përveç groteskut, sarkazmës, që na kujtojnë edhe gazetarinë e tij, poezi të kësaj natyre, me këtë lloj peshe kritike, theksojnë një nga tiparet më rëndësishme të poezisë së tij, që është aftësia për të kuptuar përtej përditshmërisë dhe përtej perceptimit lokal, me një vizion shumë më të gjerë human, duke krijuar kështu tablonë e madhe të gjërave.

Referuar kohës kur ka filluar të shkruajë, duke se poezia dhe gazetaria për Fredin kanë ndodhur njëkohësisht, por ndërsa e dyta ka qenë e prekshme, publike, poezia ka ndjekur rrugën e saj të fshehtë, latente, njëlloj si ujërat nëntokësore që shkojnë paralelisht me autostradën dhe që presin momentin e tyre për të shpërthyer jashtë. Dhe nuk ka rëndësi se kur vjen ky moment, sepse, ndryshe nga lajmi gazetaresk, letërsia nuk vjetrohet, nuk e humb aktualitetin, por “mbetet gjithmonë lajm”, siç thotë edhe Ezra Pound në “ABC-ja e leximit”.



**1 - Nuk e dija se kur pëshpërisin muzgjet ...**

I mërzhitur isha, grindur me çdo thërmijë të botës,  
e heshtja rënkonte përballë murit të thinjur,  
kur zogjtë shtegtarë erdhën e më thanë:  
të pret Vasilika tek qiparizat në kodër!

Qiparizat janë djegur, Vasilika ka vdekur,  
o zogj - lajmëtarë të rrjedhur ...

Ikja trishtueshëm i vetëm ndanë lumit,  
vëngoja, brufulloja tek vështroja:  
si vjeshta po këpuste gjethet e pemëve  
ende pa u tharë, dhe ikte revan e hazdisur.

Të pret Vasilika tek shelgjet e Vahut,  
shelgjet e reja lotojnë, si dikur,  
dhe trupin tënd lakuriq duan të lagin...

Po trupi im drobitur e plakur,  
gjurmë e kokalla që s'lëshojnë më çika,  
moj Vasilika!

Nga ç'kontinent paske ardhur, kaq papritur,  
Vasilikë moj, tridhjetë vjet e ikur ...

Hi i hedhur maleve me borë, deteve të kripur,  
lëndinave ku shpërthen blerimi pas rrëkezave?

... si nuk e dija se kur pëshpërisin muzgjet,  
afrojnë dhe Krishtlindjet ...?

**2 - Bajame e egër ...**

Bariu sypërskuqur prej katundi mjeran,  
kullot kopenë, këmborë dhensh, zile dhish,  
Veç ai kthen kryet nga bajame egër,  
mbirë në majë, mes shkëmbinjsh.

Ditë për ditë ulet atje përkundruall,  
fërshëllen, ç'ti bëjë asaj ndjenje të mirë,  
Se çfarë i kujtojnë heshtja dhe aromat e saj?  
ndërsa kopeja kullot polenin dhe vesën.

Po ja ku fryn një erë e hollë,  
e hollë brisk,  
bariu sqimatar kacaviret ndër shkëmbinj,  
i hedh përsipër bajames pelerinë,  
sepse borërat, akujt e pengjet,  
ende nuk kanë shkrirë.

Çdo pemë ka brinjët e veta zbuluar,  
që janë shenjat e origjinës...

**3 - E humbëm ...**

E humbëm atë ëndjen harlie brishtake,  
ndoshta ish shkruar prej fatit të humbte.  
U gremisëm honesh të thellë, monopate,  
pa marrë e pa dhënë asnjë puthje.

Ramë si dy botë, me vijë hollake midis,  
dreqin, ty të zgjonin dhe gjethet kur binin.  
Qielli si sfidove dëshpërimin tim,  
kur midis dramës e romancës, bridhnim?

Ti lëshoje nur e aroma prej vere të bardhë,  
ishim më të lumtur se ç'duhej, të mërzhitshem.  
Gjërat e pathëna, premtimet gjer në varr,  
si fletë budallaçka i grisëm ...

E virgjër, egërshane, shkretuese si mosbindja,  
një ditë të tregoj patjetër ç'është dhimbja ...

**4 - Kur të më shikosh ...**

Kur të më shikosh që çdo ditë zvogëlohem,  
mos u trishito, jam duke ikur.  
Po ndjen që me zogjtë e agimit zgjohem,  
gëzo, shenjë që festa ka nisur.

Mos u zemëro që rropatem burimin të gjej  
atje ku mëllenja e çafka fshihen nga vapa.  
Dashuria nuk sjell siguri, është një vjegë  
që punë të bekuara të lësh mbrapa.

A të kam thënë që do mbetesh lule?  
Ashtu do të të kujtoj, mbi re,  
qiejve diku në fluturim ...

Nëse më shikon që çdo ditë zvogëlohem  
sa një grimcë kozmosi,  
mos u tishito, bëhu miturake si dikur,  
jam duke ikur ...

**ODISE KOTE****Kjo verë e thatë,  
e padurueshme****Poezi****5 - Je gabimi më i bukur ...**

Pasqyra e mëkatit dërgon  
hieroglifin e fytyrës tënde,  
ku trupat se si  
bëhen të ujshëm, ndërallur në vrap  
të marrëzisë që po i merret fryma.

Në botën kaq shpejt të ndryshueshme,  
ti e dashur je gabimi më i bukur,  
ndaj kodet, nuk i harroj dot kurrë.

Të lutem ruaj dhe ti  
të fshehtat e ekstazës,  
kur vijnë dhe ikin dallgët,  
kur çahen, kërleshën, pahiten plagët.

Je grua egoiste  
e përshtatshme për në ferr,  
më sillesh ndërmend  
veç në ditët me diell.

Nëse do që të ikësh,  
të çoj në një vend të shenjtë,  
që e ruan lumi!

Dita jonë digjet në eth',  
pastaj bëhet natë,  
gjumi ecën dhe flet,  
ndërsa gjymtyrët tona udhëtojnë ...

**7 - Shkruaj kronikën e njeriut që lëngon ...**

Ende shkruaj kronika për njerëz që më prekin,  
ndërsa nxënësit të klasës së dytë a të tretë,  
shpërndajnë në eter me I - pad e celular,  
lajmet e botës.

Më ndihmon të kapercej portën e ferrit,  
fytyra e ngjeshur e vajzës në xham,  
që babanë ia vranë në mes të rrugës,  
dhe fshesarja e natës fshehtas më rrëfen,  
një tjetër version krimi.

Sherri me grushta, para pallatit të vjetër,  
ku rrobat si gjithnjë rrinë varur në telin e përbashkët,  
e motakut nuk i pëlqejnë brekët e tij,  
po sytjenat e një gjimnazisteje.

Vetmia sfilite e një plake që s'lëviz nga dritarja,  
si të ishte monument i gjallë trishtimi.

Shkruaj ende kronikën e brengës së njeriut,  
E ti më quan të vjetër e dashur,  
aspak enigmatik, të çuditshem, brilant si dikur ...  
Nuk jam plakur, po ngjaj i ngecur në trafik të ngjeshur,  
ti e di ç'është trafiku kryeqytetas, shkollë - riedukimi,  
ku vdes çdo klithmë, përgjumet fjala, kalitet durimi,  
të jem i sjellshëm këtu është e pavend.

Shkruaj kronikën e njeriut që lëngon,  
sepse portat janë mbyllur...

**8 - Humbën gurët ...**

Humbën gurët në qytetin tim  
dhe pengjet struktur thellë, brenda tyre.  
Triumfoi figura gjeometrike,  
betoni dhe qiellgërvishësit.

Jeton secili në kohën e tij individuale.  
kohe e ndarë feta - feta, si me thikë.  
A mund të jetojë shpirti kaq i qetë  
në këtë uniformitet të tejsjellshëm ...?

Humbën gurët në qytetin tim  
vijat e lakuara, aromat, rrëkezat e ujit,  
dhe cicërimat e zogjve ...

**9 - Gjithnjë është një poezi ...**

Hera herës gruaja dhe fëmijët friken,  
dikush hyn nënë në studion e vogël:  
Është një nga poezitë e fundit,  
gjej përgjigje, si një lloj dredhie

për të kapërcyer çastin.

Gjithnjë është një poezi  
që vjen e merr me vete diçka  
nga dita e parë e krijimit,  
le ta quajmë hyjnoren,  
që del nga brinja.  
prej aty liria nuk është më iluzion...

Sikur kërkon të kapërcejë gjithë kundërshtitë, për të mbër-  
ritur  
nga një habi shkëlqimtare në tjetrën,  
sepse loja e fatit të njeriut paska shtigje,  
aq sa mundësi i jepen.

Pastaj hapim dritaren dhe një yll  
ngjan se lëshon dritën  
pas poezisë bredharake ...

**10 - Vegimi**

Vjen kështu: Sikur plas cipa e blirit,  
mbushur vezulli e kundërmime mali.  
Shpërthim - shpuzarak, rindezur prej hirit,  
Gurguj, rrëkeza ujra e mugullime bari.

Shkëndijëza shojzash - mall e shpuzë flake,  
lëkurënxira nga diejt e deteve të egër,  
Re bardhoshe, krahë ëndrrash bredharake,  
Që qiejve sjellin nga larg lejkët.

Kur e putha dhuratën e ajërt të vegimit,  
gjersa kënduan gjelat herët në mëngjes.  
Më mbeti në gojë ajo shija e jamballit.  
A se bën dashuria shiun që të bjerë...?

**11 - Shpesh e më shpesh ...**

Shpesh e shpesh,  
vetja më ngjan me një përrua ujëshumë,  
që e bën melodinë e vet  
me heshtje, në heshtje ...  
gjatë gjithë natës,  
gremisur honeve, shkrepave,  
në gurë e iluzione.

Nuk e di nëse i ngjaj  
një kali të egër  
që do t'ia kalojë dhe lumit.

Mbase një ditë duhet provuar ...

12 - Kjo verë e thatë, e padurueshme ...

Kjo verë e thatë, e padurueshme,  
Ky zjarr korriku, bëh, krrak, krrak.  
Si jeh, mallkim, a djegë marrie,  
Rrafshinat i shtiu n'flakë.

Kjo verë e thatë, e padurueshme,  
Pluhur pengjesh, krejt e bardhë.  
Nuk gjen ndjellë, nuk gjen as prehje,  
Si Sahara e varrë.

Kjo verë e thatë, e padurueshme,  
Zvarritet natës ik e ik.  
E shtrirë, e djegur, ulëritëse,  
Si një skelet prehistorik ...

**13 - Poeti**

- Petrit Rukës.

Poeti blen duhan rruge, të lirë, të hapur,  
dhe pi cigarë të dredhur e kollitet rëndë.  
Miq të dikurshëm, me cabrioleta të pastër,  
Hyjnë në ministri, dikastere e kuvend.

Poeti gjithë ditën pi veç një kafe të zezë,  
për seanca me rreze kobalti s'ka lekë.  
Miq të dikurshëm, që i vjedhin idetë,  
vargjet e tij recitojnë në parlament.

Poeti thur baladat, si në balada tretet,  
nuk ka kura speciale, s'blen dot as ilaçë.  
Miq të dikurshëm, që e lanë të papunë,  
ngrejnë grataçela dhe kulla binjake.

Poeti hyn në tekste librash, medieme,  
vetmitar, si një shenjti po vdes pak e pak.  
Miq të dikurshëm, kanë gati fjalimet,  
Për mëshirë një titull dhe një dekoratë.

Poeti blen duhan rruge, të lirë e të hapur,  
dhe pi cigarë të dredhur e kollitet rëndë.  
Miq të dikurshëm, me cabrioleta të pastër,  
Hyjnë në ministri, dikastere e kuvend.



Tek lexon krijimtarinë letrare dhe publicistike të Besnik Mustafajt, herë të duket se bashkëbisedon me të, herë se e bashkëjeton ngjarjen me të dhe herë sikur je personazh në veprën e tij. Përmes origjinalitetit ideor dhe artistik të shkrimit të veprave të tij, përmes thjeshtësisë dhe sinqeritetit që ndien në intervistat e tij, përmes arsyetimit profesional që e lexon në analizat dhe komentet e tij, përfshihesh plotësisht dhe zhvillon në mënyrë koherente një ballafaqim idesh, mendimesh dhe ngjarjesh.

Ky libër paraqet shtjellime të thelluara të koncepteve të shpjeguara më parë nga Mustafaj si shkrimtar, politikan, diplomat, publicist apo prind me përvojë. Ndaj, ndryshe nga gjithçka që është shkruar më parë nga Besnik Mustafaj apo për Besnik Mustafajn, libri rreket ta pasqyrojë autorin e 1001 sintagmave në të gjithë dimensionet e tij të plotë jetësor, në 360°.

Ky libër synon të japë edhe këndvështrime të mprehta intelektuale për çështje të ndryshme e të rëndësishme që i ka shprehur vetë Mustafaj, si emblema mes Principatës apo Mbretërisë në Shqipërinë e vitit 1914, botimi apo jo i "Mein Kampf" apo analiza si ballafaqim idesh e përkthimit të "Rubairave" të Omar Khajamit nga dy personalitete sa të mëdha aq edhe të ndryshme të kulturës dhe historisë sonë shqiptare, dy klerikët e shquar, Fan Noli dhe Hafëz Ali Korça.

Sipas tematikës, të gjitha citimet janë organizuar në shtatë kapituj: "Dashuria", "Jeta", "Shkrimtari, letërsia dhe lexuesi", "Diktatura kundrejt demokracisë", "Shoqëria, politika, Europa dhe Ballkani", "Shqipëria dhe shqiptarët", për ta mbyllur me kapitullin e fundit si prezantim i vetvetes "Unë, Besnik Mustafaj". Në brendësi të secilit kapitull, paraqitja e tyre është bërë në dy kriterë: koha e shkrimit dhe renditja alfabetike e fjalëve kyçe të secilit citim. Në këtë mënyrë, për të njëjtën fjalë mund të gjejmë përshkrime apo përkufizime të ndryshme që nuk plotësojnë njëri-tjetrin, por formojnë mozaikun e konceptit/ përkufizimit në fjalë, sepse na vijnë nga kohë e kontekste krejt të ndryshme dhe të bërët bashkë në të njëjtën hapësirë i kthen në sinteza pa kohë dhe për çdo kohë njëkohësisht.

Krahas vlerave që bartin në vetvete të gjitha veprat e Besnik Mustafajt, të cilat për mua kanë qenë nxitëset e para për t'i qëmtuar e për t'u nxjerrë tharmin, një tjetër arsye që përbashkon është edhe Tropoja. Ky libër është realizuar nga unë si dedikim special dhe në nderim të thellë ndaj vjehrrit tim, Dush Kortoçit, malësorit fisnik nga Tropoja, shpirti i të cilit tashmë u bë pandashmërisht pjesë e brendshme e përditshmërisë sime jetësore

## LIBRI I BLETËS

1001 aforizma et cetera

Nga Dr. Teuta Nunaj-Kortoçi

Ky libër është krejt i veçantë brenda suazës së veprës sime letrare dhe më vjen si dhuratë e çmuar nga Teuta Nunaj-Kortoçi, profesoreshë universiteti, të cilën e falënderoj përzemërsisht. Ajo pati idenë për të gjurmuar në fjalën time publike shqiptime, të cilat premtinin të paraqiteshin më vete si aforizma dhe më kërkoi miratim. Duke njohur dashamirësinë e saj për shkrimet e mia, pranova menjëherë, por pa e përfytyruar punën e jashtëzakonshme që kjo zonjë e ditur po ndërmerre. Ajo do të lexonte "me laps në dorë" mijëra faqe letërsi artistike, prozë e poezi, dhe po aq faqe, në mos më shumë, publicistikë, që unë kam botuar si libra apo në gazeta e revista të ndryshme gjatë dyzet viteve. Dhe jo vetëm kaq. Ajo do të gjente, me ndihmën e internetit, me qindra orë intervista në televizione e radio, që unë kam dhënë si shkrimtar e si politikan. Si doktore e vërtetë shkencash që është, zonja Nunaj-Kortoçi ka sjellë në fund të librit një listë shumë të gjatë me burimet ku i ka gjetur shprehjet apo vlerësimet e paraqitura këtu si aforizma. Si autor, kam pasur një fat të rrallë që vepra ime ra në duart e një studiueseje të tillë.

Kur profesoresha Nunaj-Kortoçi ma dërgoi lëndën, të organizuar edhe në kapituj tematikë, siç po i paraqitet lexuesit tashmë, i pari për t'u befasuar do të isha unë vetë. Kurrë nuk do ta kisha marrë me mend se në shkrimet e mia kishte aq shumë shprehje aforistike. Në vazhdim, mua më mbetej një ndërhyrje shumë specifike, të cilën e kreu me kënaqësi gjatë kësaj vere. Në zanafillë, shprehjet aforistike lidheshin me kontekste të caktuara, ku ishin thënë nga personazhet e mia apo edhe nga unë vetë si autor. Në shumë raste, ato kishin nevojë të rishkruheshin, për të fituar një autonomi nga kontekstet prej nga ishin shkëputur. Kjo punë do të kryhej doemos pa e cenuar përmbajtjen fillestare prej nga ishte nisur përzgjedhësja kur i kishte nxjerrë në pah. Në përfundim, ishte radha ime të merrja miratimin e profesoreshës Nunaj-Kortoçi.

Besnik Mustafaj

BESNIK  
MUSTAJ

libri i bletës

1001 aforizma et cetera



Zgjodhi dhe paraqiti  
Dr. Teuta Nunaj Kortoçi

Onufri

si mendim e ndjenjë dhe që më mungon fizikisht.

Ideja për realizimin e librit lindi një dekadë më parë, për t'u shtjelluar e për t'u finalizuar në tri vitet e fundit. Ka qenë gjithnjë pjesë e punës sime hulumtuese dhe e të studiuarit tim identifikimi dhe nxjerrja mënjane e fjalëve kyçe, koncepteve dhe përkufizimeve, që kishin dhe sillnin një domethënie të rëndësishme, gjë e cila tejkalonte hapësirën e një individi apo të një numri të kufizuar individësh. Pas dakordësisë së propozimit të dytë, në dhjetor 2021 puna mori udhë.

Mendimi i lindur dhe fillimi i punës ishte për studimin e plotë të veprave letrare e publicistike të shkruara nga Mustafaj, më tej përgjatë angazhimit u ndie nevoja për të përfshirë edhe intervistat e ndryshme e të shumta që Mustafaj ka dhënë ndër vite, si dhe analizat e komentet publicistike të tij, pa të cilat ky punim do të ishte gjithsesi i mangët. Leximi i veprave, punimeve, shkrimeve, analizave, komenteve apo intervistave është bërë në një plan shumë-dimensional: të lexoje, të ndieje bukurinë që të fal leximi, të dialogoje intelektualisht, të abstragoje në mendim, të mbusheshe shpirtërisht, të gjeje e të mblidhje fjalën ose togfjalëshin e duhur dhe të ruaje gjithnjë kontekstin e domethënien e tyre në fjali e paragrafë. Të qëmtoje fjalë pas fjale, togfjalësh pas togfjalëshi, fjali pas fjalie, paragraf pas paragrafi, faqe pas faqeje e minutë pas minute për t'i veçuar për një vlerë të dyfishtë që përmbanin dhe për t'u ridhënë jetë, ishte një punë e bukur, e gjatë në kohë, e thellë në analizë, e kujdesshme në ruajtjen e kontekstit të pjesës së tekstit të zgjedhur dhe e mbushur me kënaqësi profesionale.

Përgjatë tri viteve u studiua e gjithë vepra letrare e botuar e Mustafajt prej 5378 faqesh, u dëgjua mbi 50 orë intervista në media e medime, u lexuan mbi 389 fjalime, analiza e intervista në shtypin e shkruar, ose mbi 276 faqe A4, e gjitha kjo me një synim të saktë e të qartë, nxjerrjen e tharmit së krijimtarisë së Mustafajt.

Lexuesi tashmë ka në dorë një libër me kuintesencë për ngjarje, fenomene apo aktualitetin, me koncepte për çështje themelore e të rëndësishme në jetën dhe përditshmërinë tonë si qytetarë, me shpërfaqjen dhe shpjegimin e dashurisë si ndjenjë universale, por edhe për ngjarje madhore të kombit tonë si në diktaturë e në liri. Mendimi i shprehur nga Mustafaj është konciz, i drejtpërdrejtë e i qartë, duke ofruar kështu origjinalitet, qartësi dhe emancipim ideor. Është një punë që unë e kam shijuar intelektualisht e shpirtërisht përgjatë të gjithë periudhës e në të gjitha dimensionet dhe uroj që secili prej lexuesve ta shijojë e të gjejë veten në rreshtat e këtij libri, ashtu siç e gjeta unë.

**AH-U IM I BARDHË**

Ah-u im i bardhë, atje përmbi fusha  
Formohet, c'formohet, bënë jetën e vet,  
Herë si fjalë rrebele mbi cipën e kaltër të  
qiellit  
Here si lutje, në udhën e shkretë.

Ndoshta do të zgjojë, dikë nga gjumi i  
thellë  
Para se të shkoj, më saktë prej nga zbriti...  
...Eh, ah-u im i bardhë, atje përmbi fusha  
Që askush s'të pa  
e askush se diti....

**ARDENICË**

Ngrysëm dhe gdhihem  
Me Ty në sy.

Një ditë mos të shoh  
Të nesërmen verbohem.

Zogu i diellit  
Këndon në kryq.

**ËNDRRA E PYLLIT**

Thonë se do të kaloj perëndia e zjarrit,  
Dhe mos - na o Zot  
Të na gjej në gjumë!

Kam kohë që ndjej fishkëllima të zeza  
dhe gjindja e pyllit është e parehat.

Shoh iriqët që mblidhen rreth stroullave  
të dhelpërave.  
Ndërsa breshkat që bënin gjumin e tyre  
prej kishe  
kanë kohë që natën  
më vijnë rrotull shtëpisë.

Vonë, shkoj në ëndërra.

Tufa zogjsh fluturojnë si thëngjinj nepër  
qiej  
dhe humbasin si teminëza mbi barin e  
thatë;  
Kopetë e ujqërve rendin nëpër pyll  
mbështjellë me flakët e zeza të lumit.  
Teksa drurët (eh, drurët!.)  
kjo popullatë fisnikësh si murgj të plakur  
presin meshën e radhës  
në Kishën e Muzgut.

Thonë se do kaloj perëndia e zjarrit,  
Mos - na o Zot  
Të na gjej në gjumë.

**BANORJA E FUNDIT**

Errësira, errësira  
është banorja e fundit e qytetit.

Shkon e vjen rrugicave të ngushta  
nga Kodra e Heronjëve  
te Busti i Poetit.

Zvarritet e mbledh dritën e mbetur  
si thërrime,  
nga buka e zogjëve të vdekur.

**ZOTAT**

Engjëjt këndonin  
hojeve të dritës,  
Si zilka argjëndi  
për Rilindje të mëdha;  
Po ora e diellit  
kish ngecur në kryq,  
Ne nuk mbërritëm  
Nuk erdhën as ata.

Tokë e zezë.  
Golgotha. Golgotha.

Ishte e djelë.  
Ciganet nëpër rrugë,  
Tundnin gjinjtë  
dhe vithet e mëdha.

**FQINJI I MARRË**

Askush se pa  
heroin tim  
Në sheshin me zjarre  
për bukë dhe dinjitet.

E lanë aty



## XIXËLLONJAT FLENË MBI GURËT E GJAKUT

*Cikël poetik nga Aleksandër Bardhi*

të klithte, të çirrej,  
Të ndizej, të digjej,  
gjersa të shuhej vetë.

Askush se njeh  
heroin tim,  
Fqinjin e marrë  
me statusin e të verbërit.

Të gjithë flenë.

Ai digjet nëpër zjarre  
E hap një nga një  
gjithë çezmat e qytetit!..

**GURI NË RADHË**

Eshtë një kohë  
Për delirantë si ju,  
Që venë gurin në radhë  
Në derë të muzeut;

Sic është një kohë  
edhe për fqinjin tim,  
Që numëron medaljet  
e tre luftime dhe qan.

**TATUAZHE**

Se si ngjajnë  
këto njollat e diellit,  
se si ngjajnë!..

Herë si ato gërvishtjet e befta  
nga sulmet e luanëve,  
Herë me ca kryqe të vegjël argjëndi  
mbi koren e djegur  
të bukës së bardhë...

Se si janë  
këto njollat e diellit,  
se si janë!..

Edhe unë e kam  
një blanë prej diellit;

.....Si ajo lulëkuqja e fushave  
netëve të majit,  
Që bubrron në heshtje  
nëpër zjarret e qiellit!..

**BIE SHI NË ARDENICË**

Mikut tim poet, Nuri Plaku

Bie shi në Ardenicë  
Sikur shkund krahët bilbili,  
Më mer malli për ty mik  
Plot me hire manastiri.

Miku im që cdo ditë  
Njeri tjetrit i bëjmë gjyq,  
Kur del tymi mbi çati  
Nga një kafe pimë në kryq.

Në një kryq, ku s'kohet dot  
E çdo kujt s'i hapet dera,  
Ku të shtron bukë e shpirt  
Bukuroshe Shën e Djela.

Bie shi në Ardenicë  
Sikur shkund krahët bibili,  
Më mer malli për ty mik  
Plot me hire manastiri.

**XIXËLLONJAT FLENË  
MBI GURËT E GJAKUT**

Një grusht xixëllonjash  
nga zëmra e gurit,  
M'u bënë udhë,  
një natë me shi.  
Ne jemi - thane - shandani i fatit  
Që të fle te koka, e ti se di.

Një grusht xixëllonjash,  
nga guri i gjakut,  
Diku në mal  
një natë me shi.

**MASAKËR E SHËNDRITSHME**

Qeshën në kor  
gjithë hajnitë e maleve  
Kur kokën vura  
mbi gurin e parë:  
-Këtu ujrë dhe pyjet ka kohë që i helmon  
Hija e zezë  
e dragoit të bardhë!..

Heshtën malet.  
Heshta dhe unë.  
Shkrepi rrufeja  
dhe Fati ndjeu:  
-Ti do të jesh  
një masakër e shëndritshme -  
më tha -  
Dhe iku, e u bë  
pikëllim Mesdheu.

**ZJARRET E LUMIT TË THATË**

Shiu rrudha - rrudha  
Në të fikur ylli.  
Ujku përtyng ngeshëm  
Thëngjinj, kocka pylli.

Bëj t'i afrohem  
Shkon në bregun tjetër,  
Sikur ta ketë zënë  
Një mallkim vjetër.

Ujk ti, e unë ujk  
Të dy një lëngatë,  
Kafshuar nga zjarret  
E një lumi të thatë.

**BULKTHA TË PËRGJAKUR**

Te kjo rrugicë  
e vjetër, pa drita,  
Ndodhte të përgjakeshe  
nga ndonjë guricë e verbër;  
Sidomos kur kaloje  
pranë kësaj shtëpie  
Që të gjithëve na kish bërë  
me vrimë në zemër.

Po askush se pati  
atë fat ndër ne  
Të ish kavalieri  
i zgjedhur syresh;  
Atje mbi portë  
ndriçonte errët  
Një hënë e vogël  
me grerëza yjesh.

Tani në moshë  
i tëri argjënd  
Shpesh vij, ndaloj,  
e dua të rri!..  
...Ata gurinjë e dikurshëm  
si bulktha të përgjakur,  
Lozin nëpër hënë  
e këndojnë mbi cati.

**MENDIM NË FUND VJESHTË**

Ngrirje moti.  
Ujrat heshtën, u mblodhën

Dhe butet e verës  
zunë të bien në gjumë.

M'u kujtuan fjalët e burrave të qëmotit:

Zjarret e vjeshtës  
I kanë varret ne lumë!..

**HËNË E KUQE**

Është një varr i vogël  
Diku buzë përroi,  
Me një hënë në skaj  
Si plagë dragoi.  
.....  
I thanë, bien këmbanat.  
Po ai s'dëgjoj.  
Hëna në të kuqe  
Në të zezë përroi.

I thanë, bëhet luftë  
Po ai s'besoj.  
Hëna në të zezë  
Në të kuq përroi.

I thanë, t'u vra djali.  
Gjaku e verboi.  
Dita më nuk zbardhi  
As nata nuk shkoi.  
.....

Është një varr i vogël  
Atje, buzë përroi,  
Me një hënë të kuqe  
Si plagë dragoi.

**BALADË**

Haber nuk vinte  
Këmbana nuk ra.

Thëllëza këndonte  
Më tre, në sabah.

Rriteshin djem  
Plakeshin burra.

Plakej dhe vdekja  
Bashkë me mua!

**TEMPULL**

Me një ashkël perëndimi  
ndeaur në duar,  
Kam kohë që udhëtoj  
Për në Tempullin e Harresës.

Jam thjeshtë një udhëtar i natës së vonë  
Që shkoj të le ndezur dritën time.

**FLUTURA E ZEZË**

Kjo hënë që netëve  
lan gurët e lumit,

Një ditë do të digjet  
mbi gurin tim;

E do të bëhet,  
një flutur e zezë.

Që të mos mjaftonin hallet e jetës së përpëlitjet e përditshme për të siguruar ushqimin, oraret e gjatë në punë, deri te streha dhe frika nga të panjohurat, pandemitë, që vinin rrallë, por të shkallmonin, si ajo e Covid-it, që plandosi zyrtësi pa fund në tokë, luftërat, rritja e çmimeve, Martin Gashi thoshte se ai ishte i dënuar të jetonte edhe me një barrë tjetër, shumë të rëndë: duhej të tregonte vazhdimisht kush ishte. Dhe kjo, ta quajmë detyrë, ndonëse nuk ishte te përshkrimi i punëve të tija, ishte një rutinë njerëzore, që atij i ngjallte dallgë tronditëse, e bënte me nerva, ngaqë i binte shpesh të ballafaqohej me këtë pyetje.

- Sa herë më pyesin, stepem si hut, thoshte dhe këqyrte horizontet përpara, duke bërë me gisht andej, përtej kufirit, ngaqë gjithmonë ekzistonte një vend tjetër, që ishte përtej kufirit, ku njeriu nuk ishte i njëjti nga ç'ishte aty ku ndodhej.

Martini e kishte përjetuar sa e sa herë këtë ndjesi, duke punuar në një institucion të rëndësishëm të emigracionit, ku i binte të udhëtonte shumë nëpër botë, në konferenca, ekspozita, debate e aktivitete.

Përgjatë jetës së tij, i kishte ndërruar disa herë dokumentet dhe njeriu sa herë ndërronte status politik, vishej me një identitet të ri. Ai kujtonte atëkohë, kur ishte pa asnjë dokumente, i kishte marrë flaka e luftës dhe atij i duhej të dëshmonte se ekzistonte, dhe për këtë, më shumë kishte rëndësi një letër se sa vetë prania e tij.

Sa shumë identitete kishte mbi një jetë njerëzore, të cilat kishin forcë ta lidhnin njeriun si prangat e robërisë apo edhe e kundërta, t'i jepnin krahët e lumturisë e ta bënin njeriun ai që nuk ishte vërtet?

Njeriu kishte sy, gojë, duar, fliste një gjuhë, mund t'i fliste dhe dy e më shumë, kishte një emër, një ditëlindje, i përkiste një familjeje, një gjuhe, një kombi, një shteti, e nëse shteti qëllonte i përcudnuar, ai, pa dëshirën e tij bëhej pjesë e asaj përcudnie, por nëse ishte e kundërta, i përkiste një shteti të modës, ai bëhej pjesë e modës.

Kjo nuk është e drejtë, mendonte Martini e përsiaste rreth identitetit të tij dhe lidhjeve që krijonte ai me të tjerët.

Po kush jam unë në këtë mishmash, pyeste Martini vetveten, teksa bluante në kokën e tij, udhët e jetës së tij, bënte një ekskursion në të shkuarën tragjike të popullit të tij dhe shtegtonte me imagjinatë nëpër vende të ndryshme, kujtonte momente dridhmuese, përpara policisë nëpër kufij, kur e shikonin me dyshimin e vizatuar në sy, çaste që atij i dukeshin muaj a vite.

Nga je ti?, e kishte pyetur njëherë një polic.

Jam shqiptar i Kosovës, ishte përgjigje ai.

Jo, ti je jugosllav, i kishte thënë ai.

Martini i tmerruar, kishte mbetur pa frymë dhe njëkohësisht edhe pa përgjigje.

Në të vërtetë, Martini ishte jurist me profesion, i regjur në tema të drejtësisë, nuk kishte bërë ndonjë gjë të keqe që të kishte frikë, por sa herë ballafaqohej me këtë çështje, ndjente se koka e tij kthehej në kaos të vërtetë.

Dhe ashtu, në një gjendje të paqëndrueshmërisë shpirtërore, Martini tkurrte barkun e dalë jashtë si daulle, për shembull, thoshte: sa tonelata histori e mori njerëzish vizatoheshin në fytyrën e një njeriu? - dhe përipiqej të endte një

Nga libri "Shtegu i të verbërve", Onufri

NDUE UKAJ

Kush je ti?

tregim

ekskursion të shpejtë nëpër ato fijet e identitetit që kishin formuar vendin e tij dhe fytyrën e tij, që ishte identiteti i tij.

Dhe mendonte se përpjekja për identitet nuk ishte një çështje koti, teksa kujtonte mësimet në shkollë, orët e dalldisë, puthjet e ëmbla në buzëmbremje, pastaj puthjet tradhtare, sepse, në jetë nuk mund të mos kishte puthje të ëmbla dhe tradhtare, puthje prej Jude.

Ai vetë nuk kishte shkaktuar ndonjë puthje prej Jude, por i shihte frakturat historike, që rëndonin mbi të.

Kush ishte Martini?

Sa herë mendohej të formonte një përgjigje, e kuptonte se diçka linte jashtë dhe kjo ia rriste kaosin në tru, ngaqë atij shpeshherë i duhej të përgjigjej edhe për ato zbrazëti që ishin tretur, harresën nëpër të cilën zgjaste duart, si në një humnerë, që të kapte diçka dhe të formonte përgjigjen e duhur ose atë të përafërtën, ngaqë e duhura, ishte larg natyrës njerëzore.

Kryeqyteti yt është i vjetër, por nuk ka asgjë të vjetër, i tha njëherë një zviceran, i cili e shikoi si një të gJORë, e Martini i stepur mbeti pa frymë, ashtu i hutuar, u end nëpër histori, mori nga ajo ca flluska, u mundua t'ia hedh përpara zviceranit, si gjahtarit një pré, por gjithçka kishte shkuar kot.

Atëherë, Martini i ishte dukur veshja e tij e shformësuar, si teshat që mban veshur njeriu, të cilit rrobaqepësi nuk ia ka marrë masat e trupit.

Janë të papërshtatshme për trupin tënd, kishte dëshirë t'i bërtiste gruaja, ajo që përditë e qortonte për barkun që i kishte dalë jashtë, si një daulle.

Janë të papërshtatshme për trupin tënd, i bëhej sikur e dëgjonte zërin e saj, duke ecë ngadalshëm me flokët e zezë, që i rrëshqisnin bukur në njërin anë dhe ia zbulonin kraharorin, ku ai dëshironte t'i lëshonte buzët e tij të djegura dhe të ndjente se si nën pantallonat e tij lëvizte haleti i tij, të cilin e lironin gishtërinjtë e butë të gruas, e pastaj, nën zjarrin e

etheve, ai hynte aty ku duhej dhe gjithçka kthente në një lumturi dehëse.

Njeriu ecte me këmbë të veta, por zor e kuptonte se nuk ecte vetë, ai ecte me këmbët e historisë, me prangat që ia kishin vënë të tjerët, me teshat identitare që ia kishin matë të tjerët, ai ecte me këmbët e budallallëkut që trashëgonte dhe ashtu i duhej të formonte kohën e tij.

Kush jam unë?, i tha një ditë gruaja, pasi ajo filloi të vishej e ai e kundronte trupin e saj të zhveshur nën dritën e një llambe.

Gruaja i tha: ti je burri im.

Martini, mes ndjesisë së pasigurisë e hutimit, e kuptonte se pas aktit të dashurisë, nuk fliten gjëra të marra. Doli në ballkon, ndezi një cigare puro, ndërkaq, dikur, ai organi që e çonte peshë, ra krejt në gjumë, si i vdekur.

Përtej, shihej një pjesë e madhe e qytetit, larushia e tij fshihte një shumësi identitetesh, ku secili pushtim kishte lënë gjurmë, vragë, pështjelli, në tempuj, në ngjyra e arkitekturë.

Po në zemrat e njerëzve çfarë ka ndodhë?, pyeste dhe thithte cigaren e vështronte rrethe përçark.

Unë nuk jam vetëm Martini, me sytë e zi të zhytur në një të gjelbër si bari, nuk jam vetëm Martini, burri që porsa bëri dashuri, ai juristi që zgjohet herët e vishet gjithnjë me seriozitet, ai Martini trupmadh, me barkun e dalë jashtë si daulle, jam edhe një përemër i tretur në një shumësi përemrash tjerë, përemra që krijojnë një lidhje arkitektonike me të tjerët - me tjetrin, më historinë, dhe kjo e vërtetë më duket si një humnerë përpara.

Gruaja i afrohet dhe i thotë: po flet me vete, e Martini trembet dhe mundohet të arsyetohet: kam një konferencë, i thotë, me temë: 'Historia e vërtetë e Martin Gashit, dhe duhet të tregoj se kush jam'.

Gruaja e shikoi habitshëm, - Mos harro se mes të vërtetës dhe perceptimit mbi të, ka një humnerë, i thotë, duke ia kujtuar filozofinë që e donte, e Martini mendja i tij iu duk si një lëshim, ndjeu një pështjellim në krye dhe filloi të shkruajë:

"Po, unë kam një emër, që nuk e kam zgjedhur vetë, në të vërtetë, nuk kam zgjedhur asgjë vetë. Emri më mbështjellë me petka, më jep një identitet, mbiemri një tjetër. Një Martin mund të jetë një gjerman, por një Gash nuk mund të jetë një gjerman. Një Gash është një shqiptar.

Kjo pyetje, ma ka kthyer kokën në një fushëbetëje. Shpeshherë më duket vetja se jam në një qytet të stërmadh, ku nuk ka asnjë tabelë e nuk di si të eci. Ne, njerëzit, gjithmonë kemi nevojë për udhëzime, për orientim, kemi nevojë për emra, mbiemra, përndryshe, do të ishim si tufë delesh. Dhe ne kemi nevojë për tabela orientuese, që të shpëtojmë nga kaosi.

Në fytyrën time janë gdhendur shumë histori. Në të vërehehen ata shekujt e dendur plot errësirë, ajo mjegull historike në të cilën nuk ka ndodhur asgjë, ato kohë kur kanë parakaluar fate njerëzish, kryqëzime në të cilat duhet të ndalem, të pres sinjale për të ecë përpara.

Martin, ti nuk je vetëm ti, i them vetvetes shpeshherë..."

Frynte një erë e ftohtë, aq sa i duhej se i acari kishte hyrë në shtëpi. Martini kishte zgurdulluar sytë në dritare dhe po shikonte përmes saj një qiell të errët, pa hënë e pa hyje. Ishte vonë. Përreth qafës ndjeu duart e gruas që i hodhi një rrobë krahëve dhe i trembur, ai i tërhoqi sytë nga ajo errësirë.



### Ti di si t'ia zhbësh konturet një gruaje

Ti di si t'ia zhbësh konturet një gruaje:

Fillimisht ravijëzon një siluetë  
heq prej saj lëndinën e mishtë  
nën lëkurë fut gurët e një  
dashurie të hershme  
me mure të arnuara  
e gozhdë të pashkulura lëngimi  
var në to portrete ekzotike  
e mbush me shkulle  
e zogj të plagosur mërie...

Gjithçka i ngjan procesit të fotoshopit  
ku ti krijon një tjetër grua  
që NUK jam unë.

### N'dallgët e prushta të kripës tande

N'mrizin mes velit të shikimit tand  
e zgripit të një puthjeje  
dehun ndëshirë  
m'u përvijue një rigë loti.  
E përshkova at'lot  
siç kalohet përmes nji prroi  
pa dashë me u lagë.  
Nuk di në asht pagzue kush pa ujë  
veç kujtoj se s'jam ma si ma parë  
jam shërue nga vetja  
duke ec zbathun n'dallgët e prushta  
të kripës tande  
kurrë pa ditun  
se t'jepesh pa u kursye-  
kjo asht dashnia.

### Porta e të dyzetave

Thonë se të dyzetat janë porta  
e një fillimi të ri.

Ajo portë është hapur  
dhe unë qëndroj në prag  
duke kundruar shtegun e parrahur.

Nuk shqetësohem më se si dukem  
në sytë e të tjerëve  
jetoj çdo ditë duke zhveshur  
komplekset e mia.

Di se sa vlej e nuk rend më  
pas lumturisë, pas zhgënjimeve,  
si pas aromës së një luleje  
që më ka djegur xhanin.

Destini e di se ku banoj  
dhe unë armiqtë në shtrat  
nuk kam për t'i pritur.

Lutem çdo mëngjes,  
sa hap sytë,  
për kurajo, forcë e një dozë humori.

Kam pranë njerëzit që dua  
e ca dhoma i kam boshatisur  
për bekime të reja.

Thonë se të dyzetat janë porta  
e një fillimi të ri:

Të jetosh për shpirtin, unë e quaj liri.

### Dashuria është e gjitha dashuri

Ajo po gdhend zemrën time  
ndërron një dërrasë të kalbur  
heq një gozhdë të ndryshkur  
mbulon një vrimë në murin e aortës  
zgjeron një kanal për anijet e bardha  
ujit një lule të zverdhur nën një palmë  
i lyen me qiej hidhërimet e mia  
ndez zjarre të strukura në hi.

Dashuria është e gjitha dashuri.  
Dashuria nuk lëndon.  
Janë njerëzit që lëndojnë njëri-tjetrin.

# ALKIMIA ENATËS

Cikël poetik nga Marsela Neni



### Language e asaj që s'thuhet

Tani s'flasim më aq shumë  
sa më parë,  
komunikojmë në gjuhën e Zotit\*.  
Ti më pyet në dëshiroj një kafe  
në tryezën e kuzhinës ulur pranë,  
por aq larg sa ta lejojmë detin  
të valojë mes brigjeve tona,  
erërat e qiejve të fryjnë  
e pulëbardhat të fluturojnë.

U ngajmë dy kolonave antike  
të së njëjtit tempull  
që mbajnë çatinë e botës.

Ti më ujëmbush një kupë  
e unë mbush kupën tënde  
por s'pimë nga kupat e njëri-tjetrit.

Jemi dy lumenj përbashkuar në një,  
pas uraganit të përshkimit  
rrijmë të qetë  
drejt deltës së të njëjtit oqean,  
secili duke ruajtur ngjyrat e veta  
si telat e lahutës që qëndrojnë  
më vete, por luajnë të njëjtën melodi.

Tani s'flasim më aq shumë  
sa më parë.  
Lexojmë në pasqyrën e syve  
çka s'themi.  
Kur emocioni gjen mendimin  
e mendimi fjalët,  
rindizet zjarri poetik i jetës  
e ne ngrohim damarët e përdredhur  
netëve të martesës.

### Alkimia e natës

U rrokullisën qiejt  
e na gjetën shpinë më shpinë  
njëri në gërrhimën e dreqit  
tjetri paqes ia kishte shkuar thikën  
përmes.

U rrokullisën qiejt  
si gurët kur bijnë nga mali  
me rropamë të tërbuar  
ramë e fjetëm me ujkun në bark.  
.....  
Si fshesare cigane errësirë e natës  
e paskësh fshirë zemërimin  
Në mëngjes puthëm petalet e syve  
larë nga vesa... pa thënë asgjë

...se falja s'ka zë...

### Zog mëngjesi

Gjithë jetën jam zgjuar herët.  
Ëndrrat e mia ishin më të mëdha se dita ime.  
Tani që kam fituar një farë moshe,  
më shijon të fle fill pas agut.  
Ndoshta sepse netëve vallëzoi me orët  
lugjeve të krijimit  
që ferri të mbetet i paprekur në madhësinë  
e tij.  
Nuk mund të ankojem.  
Më thonë se është çështje zgjedhjeje.  
Pa dyshim është çështje pranimi.  
Me bisht të syrit e ndjej gjumin  
tek arratiset nga shtrati i territ  
veshur me një pëlhurë sateni të bardhë.  
Unë ia di udhën, e ndjek pa bërë zë.  
Do të ishte vërtet marrëzi të rebelohesh:  
Gjumi është një qenie krejt e pafajshme,  
fajtori jam unë që zgjedh të ëndërroj.

### Mund ta thyesh një grua

Mund ta thyesh një grua,  
përkohësisht...  
zemra e saj si qelqi  
në një milion gastare  
do të zhbëhej.

Mund ta thyesh një grua,  
por kujdes, mos shkel  
mbi gastaret e zemrës së saj,  
do të vritesh...

Mund ta thyesh një grua,  
përkohësisht,  
por ki mendjen, mos e nënvlerëso  
forcën e saj,  
do të çmendesh...

### Është e lehtë të shkosh

Është e lehtë të shkosh,  
më e vështirë të rrih  
Në orën e gjuhës  
gjithçka na e paskan mësuar gabim:  
s'ka folje që tregojnë gjendje dhe lëvizje  
të gjendesh është e gjitha një proces  
Më kujton një rosë të egër  
që nuk zgjedh të migrojë,  
por thyen akullin duke rrahur krahët  
për të ndërtuar një fole.

'Të kalosh' përmes 'të rrih'  
edhe brenda një ndjenje të vdekur- të  
ëndërrosh  
-dashuri të vërtetë.

## BOTIME TË REJA NGA MINERVA



RALPH WALDO EMERSON

Vetëbesimi

dhe ec të zgjedhura

Minerva



EPICTETUS

Diskutime

Minerva

"Një zbulim mjekësor... Nuk kam asnjë dyshim  
se do të funksionojë për ju".  
MEHMET OZ, M.D.

HA PËR TË  
JETUAR

Programi i shkëlqyer dhe i pasur me vlera ushqyese,  
për humbje pashe të shpejtë dhe të qëndrueshme

JOEL FUHRMAN, M.D.

Minerva

HUMB 10 KG OSE  
MË SHUMË NË 6 JAVË



71 ZAKONE PREJ MILIONERI  
QË MUND T'I BËSH TË TUAT, TEKSA JE  
DUKE PRITUR TË FITOSH LOTARINË


SI TË BËHESH  
MAGNET  
PARASH

Udhëzues i një djali  
të zakonshëm  
për pasuri, mirëqenie  
dhe pavarësi financiare

MARC REKLAU

Minerva

## BOTIME TË REJA NGA MINERVA



## QYTETI SI PERSONAZH QENDROR NË ROMANIN "PËRMBYTJA" TË GRANIT ZELËS

Nga Agron Tufa



Brenda një rrëfimi romanesk të kompozuar prej tri pjesësh, si tri moshat e njeriut, shkrimtari Granit Zela (që vjen po aq edhe nga përvoja e poezisë) na ka dhënë agoninë e një qyteti që vdes dhe përpëlitjet e një qyteti të ri që lind, ndonëse në përcudnimin e vet duket më i vdekur nga i pari në ujëra. Bëhet fjalë për të njëjtin qytet, për të njëjtin organizëm me shpirtin e rimishëruar në një trup të ri. Granit Zela është bindës dhe sugjestionues jo vetëm me idenë e romanit, por edhe me cilësinë e tekstit, pëlhurën e materies rrëfimore – e gjitha një thurimë delikate, e zhdërvjellët dhe e kthjellët, herë në fjali lakonike, herë në periudha të gjata përpërëse, me frymëmarrje të gjata lirike.

Ajo çka përbën edhe të pazakonshmen e menjëhershme të romanit *Përmbytja* është se personazhin klasik tradicional e zëvendëson qyteti. Ndonëse ai që rrëfen është autori i lindur në këtë qytet, prapëseprapë fati dhe ekzistenca e qytetit eklipson çdo protagonizëm mbizotërues personazhi: kryepersonazh është vetë qyteti me emrin Atjelinda (njëfarë aludimi për Atlantidën e fundosur në ujëra). Është si historia e trupit dhe shpirtit të një organizmi që nuk mund të jetojnë dot ndaras. Kjo ndërmarrje në planin artistik dhe estetik e vështirëson shumë detyrën: të flasësh për fatin e një frymori kolektiv. Strukturimi i lëndës dhe thërrmimi me njësi rrëfimore të shkurtra, episodike, të orkestruara harmonikisht rreth një mbijetese itinerare ekzistenciale të shpirtit të qytetit, e bën tekstin e romanit, përpos kthjelltësisë së stilit, një festë leximi.

Zela ka rrokur që në fillim një të vërtetë universale: atmosfera e një qyteti përjetohet më së miri kur ai përshkruhet si një organizëm i gjallë, që merr frymë, që ekziston pavarësisht nga personazhet. Dhe që kjo të ndodhë, një sërë ngjarjesh të ndryshme duhet të ndodhin në tekst në çdo periudhë të caktuar kohe. Jeta e qytetit është në lidhje organike me jetën e natyrës. Ekzistenca varet sa nga lëngjet e marra nga toka e tij, aq edhe nga lëngjet jetësore të banorëve të tij. Kjo jetë e qytetit nuk varet nga ne, ajo është hedhur në peizazh psiko-politik, që nënkuptohet; ka aspekte publike-sociale dhe intime-personale. Ajo është e lidhur me tokësoren dhe qielloren. Por në çdo rast, ne duhet të shohim në të një organizëm të ngjashëm me njeriun, me ligjet e veta të jetës dhe rritjes, gjalljes dhe vdekjes.

Secili qytet ka fatin e tij, biografinë e tij. Çdo qytet meriton një libër të mirë për të. Pyetja është: Si ta shkruajmë? Pikërisht kësaj pyetjeje i përgjigjet romani *Përmbytja* i Granit Zelës me theksin e vet metafizik të legjendave, besëtytnive, krijesave fantastike e fantazmagorike, trillet e marrëzishme – elemente dikotomike të mitologjive urbane midis qytetit të shenjtë (Jerusalem) dhe qytetit të përdalë (Babilonit). Kuptohet që theksi vihet mbi unitetin e përshqyer trup-e-shpirt (ose kohë-hapësinor) të qytetit si Genie dhe se të gjitha llogaritë bëhen me të, si me të vetmin diell dhe pikë shkrirjeje drejt të cilit gjakojnë njerëzit e tij – gjymtyrët e tij


organike e fatidike.

Në shumicën e veprave të trillimit (*fiction*), qyteti shërben vetëm si një sfond kundrejt të cilit shpaloset veprimi. Por në letërsinë e erës moderniste e deri më sot, herë pas here shfaqen vepra letrare ku qyteti jo vetëm që del në pah, por e lë në hije subjektin dhe bëhet personazhi i vetëm vendimtar. Ky është rasti i veçantë i romanit *Përmbytja* të Granit Zelës, pa hyrë thellë në thurimën e ngjitur me nëntekste të miteve arkaike, aludime historiko-religjioze dhe kumtin (kultin) e mnemozinës në perspektivën kohore. Besoj se këtë përkushtim kanë pasur edhe shkrimtarë që kanë mitizuar në veprat e tyre qytetet-personazhe. Sa për kureshtje analogjish të ndërsjella, po përmend disa që m'u kujtuan ndërsa lexoja *Përmbytjen* e Granit Zelës.

Menjëherë pas botimit të *Uliksit*, James Joyce i tha mikut të tij Frank Budgen se ai e shkroi romanin për të "pikturuar një pamje aq të saktë të Dublinit saqë, nëse qyteti do të zhdukej një ditë nga faqja e dheut, ai mund të rindërtohej nga teksti

i romanit të tij". Alan Moore tha diçka të ngjashme 100 vjet më vonë për romanin e tij *Jerusalem*, i cili zhvillohet në qytetin e lindjes të shkrimtarit, Northampton. Për Moore-in, letërsia është mënyra më e mirë për të ruajtur kujtimet e qytetit, pasi ajo ruan përgjithmonë ngjarjet e së kaluarës. Studiuesit e veprës së shkrimtarit gjerman Alfred Döblin vërejnë se romani *Berlin Alexanderplatz* mund të imagjinohet pa personazhin kryesor, ish-kriminelin Franz Biberkopf, por kurrë pa Berlinin. Nju-Jorku është përshkruar në mënyrë të ngjashme në romanin e John Dos Passos-it *Manhattan*, i cili është quajtur "libri më i mirë i shkruar ndonjëherë për Nju-Jorkun" dhe "i vetmi libër që do t'u tregojë europianëve saktësisht Amerikën që do të shohin pas mbërritjes".

Romani i Zelës, përpos tekstit letrar verbal, gërsheton edhe një tip teksti vizual në ndihmë të të parit, siç janë vizatimi ose fotografitë, të cilat i ndajshohen për ta fuqizuar njemendësinë e tekstit si në teknikën e *hyperlink*-ut në estetikën e tekstit postmodernist.



Edashur Anë, meqenëse letra po shkruhen Egjithnjë e më rrallë këto kohë, unë po i bindem tiranisë së modës dhe po të dërgoj një SMS. Para disa ditësh mbarova së riletuar romanin që të kushtohet ty dhe ende jam nën trysinë e vazhdueshme të figurës tënde. Tolstoi ka krijuar tipa universalë. Edhe ti bën pjesë në këtë galeri madhështore. Nëse ato që shkruan ai për bardhësinë e shpirtit tënd janë të vërteta, ti atëherë nuk duhej të kishe tjetër përfundim. Sigurisht, mendimet e mia nuk mund ta ndryshojnë çfarë është shkruar për ty, por do të them diçka që u ka shpëtuar kritikëve, admiruesve, fanatikëve apo liberalëve. Madje, edhe atyre që përgjithësisht i kalojnë me mospërfillje pasqyrimet e kësaj bote dhe e përkufizojnë atë si një gërmadhë vetëdijesh dhe shumësi kujtimesh. Ti ike dhe ke marrë me vete një thesar të paçmuar, dashurinë. Pikërisht këtë gjë harrojnë ta pohojnë thuajse të gjithë.

Ç'është e drejta, autori rrefen për trazime të mëdha shpirtërore dhe për ca vegime të përzishme që të detyruan të kërkoje shpëtim. Kjo fantazi u ka shërbyer regjisorëve të ndërtojnë dramën e një dashurie. Burrat kanë gjykime që nuk pajtohen me realitetin, por djemtë e rinj e vërtetojnë me shembuj se Vronski të deshi gjithnjë, pavarësisht se këtë gjë nuk e shfaqte si duhet, i shtyrë nga rrethanat. Ndryshe ndodh me gratë e reja që janë romantike prej natyre dhe zhyten në pikëllim. Njëherë pashë në tren një nuse që ishte duke lexuar pjesë nga romani. Më tha se ishte hera e dytë dhe ndalej atje ku gjente të shkruar Ana. Mos harro, të reja të ëndërojnë shumë lumturinë, madje edhe aventurën. Nuk janë të pakta gratë që mendojnë për një dashuri të ndaluar ose *adultery*, sidomos ato që nuk e kanë gjetur dashurinë.

Kur ishe ti në këtë botë, realiteti ishte tjetër. Atje i shihje ndryshimet aq fort, sa të dukej se i prekje. E shijoj edhe gëzimin, edhe trishtimin. Unë nuk mund të jap gjykime të padiskutueshme, vetëm po citoj një frazë: "Nuri që lëshonte ajo kishte diçka të lemerishme dhe mizore." Kështu, që në fillim lexuesi gatitet për të zbuluar një lloj misteri: "Në këtë vështrim të shpejtë Vronski kish pasur kohë të vinte re atë gjallëri të papërmbajtur që dukej sikur lozte në fytyrën e saj [...] qenia e saj ishte mbushur kaq shumë me një gjallëri të tepruar sa që, pa vullnetin e saj, shprehej herë në shkëlqimin e syve dhe herë në nënqeshjen." Por, ama duke shkruar për ty, edhe Tolstoi e ndiente si tronditëshin vrulli dhe idealet e tij. Atë e pushtoi një krizë e madhe morale që e gjejmë disa vite më pas te libri *Rrëfimi*. Shkrimtari u përkiste atyre njerëzve të jashtëzakonshëm që luftojnë për të sjellë përparim, duke zhdukur në radhë të parë dhunën e mjerimin. Në ditët tona sikur nuk ka fare ideale. Sa për dijeni edhe fjala *ideal* është hequr nga përdorimi.

Të flas kështu, sepse ti ishe një grua që lexoje. Besoj se të kujtohet dita kur udhëtoje nga Petërburgu për në Moskë, pasi kishte ndodhur takimi fatal? Ti ishe si në ëndërr. Lexoje dhe doje të shndërrohesh në personazhin e romanit. Ishte një roman anglez. Jeta jote e brendshme kishte pësuar katastrofën që sjell dashuria. Dhe ti thoshe me vete: "Po ç'është kështu? Mos kam frikë ta vështrij drejt këtë kujtim? Po unë ç'jam këtu? Jam unë apo një tjetër?"

Këto pyetje ekzistenciale e bëjnë artin e Tolstois aq të madh, sa kohët e mëvonshme e kanë pagëzuar me emrin "baba i letërsisë së re". Natyrisht, unë i kam dëgjuar edhe vërejtjet që bëhen se ti u tregove e nxituar. Fanatikët duke u kapur pas faktit, se ti ishe grua e një funksionari të lartë, thonë që s'të mungonte gjë. Si nuk të mungonte gjë?! A e kuptojnë ata çfarë do të thotë të mungojë dashuria? Filozofët pohojnë se dashuria është jo vetëm ndjenja më e fuqishme, por edhe ndjenja më e vërtetë në jetë.

Ti, Anë, je heroinë e veçantë. Unë nuk them se ti je personazhi i vetëm i këtij lloji. Shumë gra dhe vajza kanë populluar dhe popullojnë edhe sot librat me drama dashurie. Megjithatë, drama jote është e tjetërsjotë. Dhe duhet ta dish se nuk je as e

Fragment nga novela e librit *Romancë para vdekjes*, botuar nga Agora

## FERIDE PAPPLEKA

### SMS Ana Kareninës

para dhe e as e fundit që të ndodhi ashtu. Duke nisur nga Psikeja që u braktis prej Erosit, te Ariana, vajzë e mbretit Minos, që e la Tezeu në mes të katër udhëve në ishullin Naksos, e deri te Didona, prej së cilës Eneu hoqi dorë, madje, kur kishte mbetur shtatzënë, e gjora, megjithëse ishte mbretëreshë...

Duhet ta dish se ti ke mbetur simbol për gratë që duan një dashuri të njëmendtë. Në kohën që dashuroje ti, bota kishte kuptim. Një shkrimtar romantik shkruan: "Atëherë pranverat ishin me lule e gjelbërim, dëgjohej kënga e ujërave që zbrisin nga malet poshtë dhe i mbushnin luginat gjithë freski...". Tani edhe moti është çmendur. Ka ditë vere në dimër dhe ditë dimri në verë. Mjedisorët thonë se shkaktari i vërtetë i kësaj katrahure jemi ne vetë...

Le të kthehemi te tema kryesore për të cilën po shkruaj këtë SMS. Kur është fjala për dashurinë e vërtetë, vetëmohimi shkon gjer në flijim. Shembulli i shembujve mbetet tragjedia *Romeo e Zhuljeta*. Edhe Ofelia e gjorë, një tjetër personazh i Shekspirit, prishet mendsh e mbytet, ngaqë nuk e duron dot harresën prej Hamletit. Ah! E mbytur ajo ngjason me një zambak uji! Edhe Desdemonëna e donte Otellon gjer

në marrëzi, madje edhe në xhelozinë e tij të kallur në shpirt nga intrigat e Jagos dhe që e shtynë të shkonte gjer në krim. Aq shumë u pendua ai, sa vrau veten, por sa para bën. Kush e ka lexuar apo ka parë në skenë tragjedinë, me siguri e kujton këngën e shelgut të zi, atë melodi aq vajtimtare, kënduar nga Dezdemonëna atë natë: "E varfëra rrëzë një mani po rri, qaj, shelk, o shelk i zi / me kokën mi gjunjë, me duart në gj, qaj shelk, o shelk i zi / dhe lumi buçiste me këng' e me vaj, qaj, shelk, o shelk o qaj. / Dhe shkrinin shkëmbinjtë nga lotët e saj, qaj, shelk, o shelk o qaj...". Është përkthim i Fan Nolit. *Encyclopaedia Universalis* e quan "përfundim ortodoks shqiptar, shkrimtar dhe krijues i qeverisë së parë demokratike në Shqipëri". Në ditët tona, forcat ekstremiste të vendit tim, e kanë cilësuar aventurier. Shih gjer ku kanë shkruar punët, moj Anë?!

Bota tjetër ku banon ti apo bota e përtejme, ndryshon krejtësisht nga jona. Mbase ajo është parajsja apo *paradisus* siç quhet në latinisht. Variantet greke dhe perse të kësaj fjale kanë edhe tingëllim muzikor: *paradeisos, paradizia...* Kuptimi është: vendi ku shkojnë shpirtat e të drejtëve. Thonë

se atje jetohej me frymën e shenjtë dhe gjendet lumturia e vërtetë. Dante Alighieri te *Komedia Hyjnore*, pikën më të lartë dhe më të ndritshme të qiellit e pagëzoi me emrin *Trëndafili Qiellor*. Atje ai ngjiti Beatriçen, të dashuruarën e tij të përjetshme, e cila këndon së bashku me engjëjt.

Bota tjetër mbase është edhe Edeni, kopshti ku sipas hebrenjve, lulëzonin të gjitha lulet dhe piqeshin gjithë frutat e që Zoti vendosi Adamin dhe Evën. Në të folurën shqiptarçe të ditëve tona do të thuhej: *u fali një pronë*. Sipas Biblës, kjo ishte parajsja tokësore e humbur, sepse Zoti i zboi përfundimisht kur ata, kuptohet, plotësisht të pafajshëm hëngrën mollën e ndaluar, mollën ku fshihej e vërteta, domethënë shkenca, dija. Ti patjetër e ke mësuar se qe Eva, e cila e nxiti Adamin në herezi. Me këtë rast ata njohën lakuriqësinë e vet. Gjer atëherë rrinin cullak dhe nuk e hetonin. Nuk është se duhet trembur nga lakuriqësia. Ajo na tregon trupin tonë. Dhe e di ti, Anë, e dashur? Në Amerikë që është kampione e demokracisë, ka edhe paradokse të mëdha. Bie fjala, për pjesën puritane të popullatës pikturat *nudo* quhen të turpshme. Madje para disa vjetësh është diskutuar të ndaloheshin me ligj. U bë debat i madh në shtyp. Mendo pak sikur botës t'i mungonin arti antik dhe pikturat e Rilindjes. Prandaj them se bota jonë ka një perspektivë të dyshimtë.

Shumëkush çuditet kur më dëgjon që flas kaq bindshëm për botën tjetër. Si ka mundësi, pyesin, që një pasardhëse e Shekullit të Dritës dhe e teorisë së Marksit, të mendojë se, përveç botës sonë ka edhe një botë tjetër? Këto gjëra që dikur më dukeshin sajesa të kohërave të errëta, sot më duken rrugë e lehtë për të pranuar vdekjen. Shën Sirani i një legjende të Golës thotë se pas botës mjegullore vjen bota e vërtetë, e kthjellët si kristali. Mbase kjo është *bota tjetër*. Ai tha kështu kur e nxorën nga burgu, në të cilin e futi një nga mbretërit e Francës. "Për të më çlodhur sytë", - ironizon shenjti.

Njihen edhe disa teori të përafërta me atë të përfytyrimit për botën tjetër. Më e rëndësishmja është ajo e *Rimishërimit* që shpallte Pitagora. Kemi edhe një teori tjetër që quhet *Bota e Ideve* e Platonit. Ka edhe shumë libra që rrëfejnë për kohën kur jeta udhëhiqej nga zotat paganë. Këtë e mësova kur lexova *Kritikë e arsyes së kulluar* të Kant-it. Në atë tekst të bëjnë përshtypje perceptimet *a priori* sipas estetikës transcendentale apo përtejshqisore. Uni, sipas këtij filozofi, është parim i veprimtarisë njohëse që njëson përvojën e brendshme me atë të jashtme. Kanti i ndritshëm! Është e rrallë historia e tij me bredhin që i dukej sikur e pengonte, por kur e prenë, e kishte vështirë të meditonte. Bredhi ishte si të thuash pema që zgjonte imagjinatën e tij. Edhe Leibnic-i e shpjegon botën në një mënyrë të veçantë, ai thotë se brenda natyrës që nuk vdes kurrë, ka vetëm realitete logjike dhe pika metafizike, të cilave u ka vënë një emër muzikor, *monada*. Mose të flasin më për këtë temë se arsyetimet filozofike në kohën tonë i mbajnë për diçka të vjetruar.

Në kohën e rinisë sime ndalohej të flitej për Zot edhe në jetën private. Tashti është shkruar në skajin tjetër. Edhe dinjitarët e lartë të shoqërisë e të shtetit flasin për Zotin, si të kenë qenë shokë shkollë me të. Ata bëjnë sikur nuk e dinë që *Zot* është thjesht një parim që shpjegon ekzistencën e botës për ata që nuk i besojnë përfundimeve shkencore. *Bibla* çifute e quan JAHVE, Jëhovah, Mbreti i mbretërve; *Bibla* e krishterë thotë se Krishti është Shpëtimtari i dërguar nga Zoti; *Kurani* e quan Muhametin, bir të Profetit... Zoti i Platonit është demiurgu, logosi, pra arsyeja. Dhe unë atij Zoti i besoj më shumë. U zgjata këtu për të mbërritur te shprehja që përdoret dendur nga ata burra që kanë dobësi për seksin e bukur: "Çfarë dëshiron gruaja, e dëshiron Zoti." Gënjeshtrë! Ti e provove vetë kur dashurove. Zoti nuk e dëshiroje atë që dëshiroje ti dhe pikë. Kjo është fytyra e tmerrshme e realitetit, sipas një shkrimtari të shquar.

Feride Pappleka

## Romancë para vdekjes

tregime dhe novela



BOTIMET AGORA

### Frymëzimi për romanin fitues Booker 2024

Doja të shkruaja për pushtimin njerëzor të orbitës së ulët të tokës gjatë çerek shekullit të fundit – jo si fantashkencë, por me realizëm. A do të mundesha të sillja bukurinë e asaj rruge që përshkohet në hapësirë me kujdesin e një shkrimtareje të natyrës? A mund do të mundesha të shkruaja për mahnitjen? A mund të bëhesha një lloj baritori hapësiror? Këto ishin sfidat që i caktova vetes.

### Libri që më bëri të dashurohesha me leximin

“Deni, kampioni i botës, i Roahl Dahl. Ajo marrëdhënie e ngjallur në mënyrë të habitshme midis një djali dhe të atit më ndihmoi të kuptoja (në mënyrën time fëmijërore) diçka të re për dashurinë midis prindërve dhe fëmijëve, dhe dashurinë për prindërit e mi.

### Libri që më nxiti të bëhesha shkrimtare

Është e vështirë ta përcaktosh. Po them “Waterland” i Graham Swift-it. Mendoj se forca dhe cilësia e krijimit të botës prej Swift-it, dhuntia e mrekullueshme, rrëfimit i shtresëzuar dhe plotësisht bindës i atij romani më nxiti të shkruaja. Më bëri të mendoj, jo se “edhe unë mund të shkruaja ashtu”, por “të pyesja veten nëse mund të shkruaja ndonjëherë edhe unë ashtu?” Nuk e kam rilexuar, nuk guxoj. Por që atëherë kam lexuar libra të tjerë tëtij dhe admirimi im është i njëjtë.

### Libri të cilit i rikthehem herë pas here

Ndoshta “Zonja Dalloway” i Virginia Woolf-it. Besoj e kam lexuar deri në fund vetëm dy herë, por e lexoj shpesh kur jam përgatitem për të folur me studentët e mi, sepse proza e saj buron nga faqja aq e freskët dhe zbuluese sa duhet të ketë qenë 99 vjet më parë kur u botua për herë të parë. Ende mrekullohem me stërhollimet e gjuhës, thurjen e e shkathët, delikate të vetëdijeve të shumëfishta, dhe ndoshta me kalimin e kohës dhe rileximit e shoh stilin e saj më të rafinuar, por edhe më të efektshëm.

### Libri që nuk mund të me hiqet nga mendja

Dimrin e kaluar lexova *Sezoni i Uraganeve* i Fernanda Melchor -it (përkthyer nga spanjishtja prej Sophie Hughes-it) dhe nuk mund ta heq nga mendja. Në shumë mënyra, dua ta heq. Është një sulm brutal i një romani që të lë shenjë – nuk e kam idenë se si Sophie Hughes e ka bërë këtë përkthim, por rezultati është i jashtëzakonshëm. Gjithçka e këtij librit është mjeshtërore dhe e pamohueshme. Dhe po, verbuese. E errët, e errët, e errët dhe verbuese.

### Libri që më ndryshoi mënyrën se si mendoj për botën

Edhe dhe kjo është e vështirë ta thuash. Le të themi “Mrekullitë” e C.S. Lewis-it. Bëhet fjalë për konceptin e mrekullisë në krishterim, por gjithashtu ka edhe një argument shpirtëror për

FITUESJA E BOOKER PRIZE 2024

**SAMANTHA HARVERY:**

**Doja të shkruaja për pushtimin njerëzor të orbitës së tokës**

Përktheu: Granit Zela

Autorja e romanit “Orbital”, fitues i Çmimit Booker 2024, rrëfen për të shkruarit për hapësirën me kujdesin e një shkrimtareje të natyrës dhe për librin që e nxiti të bëhej romanciere.

praninë e mrekullive në jetën tonë të përditshme. Si një jo i krishterë dhe pa besim zyrtar, më pëlqen se si letërsia e tij më jep mua dhe botës që unë e perceptoj, një ndjenjë drithëruese të hyjnore. Besimi i tij është joshës dhe drithërues.

### Libri që ndryshoi mënyrën se si unë mendoj për romanin

Nuk është një roman, por është trillim: “Intervista të shkurtra me njerëz të neveritshëm” i David Foster Wallace-it. E lexova, e lashë dhe mendova, “Nuk e kisha idenë se edhe kjo mund të bëhej me të shkruarit”. Që mund të më çonte në ato vende.

### Libri që më ka bërë më shumë përshtypje

Do të thosha ose “Silas Marner” i George Eliot-it ose “Turpi” i J. M. Coetzee-s ose “Shtëpia” e Marilynne Robinson-it ose “Vendi i borës” së Yasunari Kawabata -s. Nuk mund të zgjedh mes tyre, të lutem mos më bëj të zgjedh njërin. Për mua janë të përsosur në mënyra të ndryshme, por të gjitha janë rrëfenja të thjeshta të treguara me sipërani të fjalës.

### Libri që po lexoj për momentin

Sapo e kam mbaruar “Miku” të Sigrid Nunez-it (më pëlqeu shumë, më bëri të ulem pranë qenit tim me duart në kokë


dhe të qaja) dhe tani po lexoj “Zjarri i zbehtë” të Nabokovit. Nuk kam ecur shumë me leximin dhe shkronjat janë kaq të vogla për sytë e mi të moshës së mesme sa që më duhet ta lexoj nën shkëlqimin e fortë të dritës së biçikletës. Them se do të jetë një aventurë leximi.

### Libri i nominuar për Booker që të gjithë duhet ta lexojnë

O, Zot i madh! E pamundur t’i përgjigjem kësaj pyetjeje, por po e provo: “Restaurimi” i Rose Tremain-it (të lë pa frymë) dhe “Rrethimi i Krishnapur-it” i J.G. Farrell-it (një ndër librat më të mirë të shekullit të kaluar?).

\* \* \*

“Orbita” është një romani i shkrimtares angleze Samantha Harvey, fitues i çmimit Booker 2024. Romani, rrëfen për gjashtë astronautë nga Japonia, Rusia, Shtetet e Bashkuara, Britania dhe Italia (burra dhe gra) në bordin e Stacionit Ndërkombëtar të Hapësirës teksa sillen në orbitë për 24 orë rreth tokës. Përveç detajimit të përgjegjësive dhe detyrave zyrtare të astronautëve në bordin e anijes kozmike, romani paraqet edhe reflektimet e tyre për njerëzimin dhe vetë tokën duke prekur tema të tilla si ekzistenca ose natyra e Zotit, kuptimi i jetës dhe kërcënimet e reja ekzistenciale si p.sh. ndryshimi i klimës. Në disa raste, romani ndryshon shkurtimisht këndvështrimin për të përfshirë rrëfimin e një alieni, një roboti dhe një njeriu parahistorik që lundron në det. Çdo kapitull i romanit mbulon një fluturim 90 minutësh në orbitën rreth tokës, me 16 fluturime në 24 orë. Romani ishte finalist për çmimin Orwell për Shkrimin Politik dhe për çmimin Ursula K. Le Guin për letërsinë.



# Arben Meksi vlerësohet me medaljen e argjendtë në bienalen e karikaturës “Niko Nikolla”

Ceremonia u zhvillua të dielën, më 10 nëntor në  
sallën e TVSH-së si mbrëmje GALA ku Arben Meksi  
hapi dhe një ekspozitë me 15 karikatura

